

**RËNDËSIA E INTEGRIMIT NDËRLËNDOR E EDUKATËS  
MUZIKORE ME LËNDËT E TJERA NË ARSIMIN FILLOR  
(NË REGJIONIN E ANAMORAVËS)**

**DRITA KRYEZIU**

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkencat Sociale dhe Edukim, me profil Psikologji – Pedagogji, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ylljet Aliçka

Numri i fjalëve: 51 674

Tiranë, Shkurt 2020

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, përveç pjesëve të cituara dhe të referuara, sipas udhëzimeve të Universitetit European të Tiranës. Ky punim nuk është prezantuar asnjëherë më parë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tërë apo pjesë të veçanta të tij.

**Drita Kryeziu**

E drejta e autorit © 2018. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

## *Dedikim*

*Këtë punim ia dedikoj familjes sime, që më inkurajoi në këtë*

*rrugëtim të bukur drejt dije!*

**FALËNDERIME**

Ky punim nuk mund të arrinte të finalizohej pa mbështetjen e pakursyer të familjes sime, ndaj së cilës jam shumë mirënjohëse dhe falënderuese.

Mirënjohje dhe falënderim i veçantë për udhëheqësin tim shkencor, Prof. Asc. Ylljet Aliçka, i cili me përkushtim më ka ofruar gjithë konsulencën e tij pedagogjike dhe shkencore, duke qenë një mbështetje e sigurt profesionale drejt finalizimit të këtij punimi.

Mirënjohje dhe falënderime shkojnë dhe për stafin e profesorëve të nderuar të Universitetit European te Tiranës.

Dëshiroj të falënderoj përzemërsisht për bashkëpunimin drejtuesit e Drejtorive Komunale Arsimore, drejtuesit e institucioneve shkollore, mësuesit dhe nxënësit pjesëmarrës në studim, konkretisht në shkollat e komunave: Gjilan, Kamenicë dhe Viti.

Gjithashtu, falënderimi shkon dhe për shoqërinë time, për inkurajimin e tyre për ta çuar përpara këtë punim.

Faleminderit për mbështetjen, inkurajimin dhe sakrificat tuaja!

## **ABSTRAKTI**

Ky studim shtron çështjen e rëndësisë së integrimit ndërlëndor të edukatës muzikore me lëndët e tjera, duke aplikuar muzikë , si një teknikë nxitëse në orën e mësimit, në lëndë të ndryshme. Në studim shtrohet domosdoshmëria e këtij integrimi ndërlëndor, për të rritur produktivitetin e orës së mësimit.

Qëllimi i këtij punimi është të studiojë ndikimin që ka integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera mësimore, përmes aplikimit të elementeve muzikore në lëndë të ndryshme gjatë orës së mësimit.

Ky studim synon të vërtetojë hipotezën se aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme, rrit produktivitetin e orës mësimore. Për të vërtetuar këtë hipotezë , kemi ngritur pyetjet kërkimore të hulumtimit: Si ndikon në të nxënit e nxënësve integrimi ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore? A rritet produktiviteti i orës së mësimit në lëndë të ndryshme, duke aplikuar integrimin ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera?

Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura dhe për të vërtetuar hipotezën, është përdorur metoda sasiore, përmes anketimit. Janë anketuar mësues të Ciklit Fillor (konkretisht, mësues që japin mësim në klasat e pesta) dhe nxënës të klasave të pesta në regjionin e Anamoravës, në Kosovë .

Nga rezultatet e hulumtimit është arritur në përfundimin se është e domosdoshme që në orën e mësimit, në Ciklit Fillor, në lëndë të ndryshme, të aplikohen pjesë të ndryshme muzikore në varësi të temave mësimore, për të bërë jo vetëm ndërlidhjen ndërmjet

njohurive ndërlëdore, por edhe për të krijuar për nxënësit një mjedis çlodhës, nxitës dhe motivues për të nxënë t e tyre.

Fjalët kyçe: integrim ndërlëndor, edukim muzikor, të nxënit, produktivitet

ABSTRACT

This study raises the issue of the importance of the interlinked integration of music education with other subjects, applying music as a stimulating teaching technique in various subjects. The study suggests the necessity of this interlinked integration to increase the productivity of the classroom. The purpose of this paper is to study the impact of the interlinked integration of musical education with other subjects through the application of musical elements in different subjects during the class.

This study aims to validate the hypothesis that the application of musical elements in the classroom in different subjects increases the productivity of the classroom. To find out who the hypothesis is, we have raised the question: What is the impact of student learning on interlinked integration between musical education and other subjects? Does the productivity of the classroom increase in different subjects, by applying subtle integration between musical education and leaving others?

To answer the research questions raised and to validate the hypothesis, quantitative methods were used, through the survey. Primary Cycle teachers (specifically, classroom teachers) and fifth-grade students in the Anamarova religion in Kosovo, were interviewed.

From the results of the research, it was concluded that it is necessary to apply different parts of the music in different subjects depending on the subjects of the lesson, in order to do not only the interrelationship between the interrelated knowledge, but also to create a recreational, stimulating and motivating environment for students to learn about them.

Key words: inter-ethnic integration, music education, learning, productivity

**TABELA E PËRMBAJTJES**

|  |    |
|--|----|
| Deklarata e autorësisë                                       |    |
| Dedikimi   |    |
| Falënderime  |    |
| Abstrakt   |    |
| Tabela e përmbajtjes   |    |
| <b>KAPITULLI I:</b>  |    |
| 1.1.Hyrje  | 1  |
| 1.2.Shtrimi i problemit                                      | 3  |
| 1.3. Qëllimi dhe objektivat e studimit                       | 4  |
| 1.4. Pyetjet kërkimore                                       | 5  |
| 1.5. Hipotezat   | 6  |
| 1.6. Variablat   | 6  |
| 1.7. Rëndësia e studimit                                     | 7  |
| 1.8. Struktura e punimit                                     | 8  |
| <b>KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS</b>                 | 10 |
| 2.1. Hyrje   | 10 |
| 2.2. Teoritë shkencore mbështetëse të studimit               | 10 |
| 2.2.1. Teoritë e zhvillimit në fëmijërinë e mesme            | 11 |
| 2.2.Teoritë e të nxënit                                      | 15 |
| 2.3.Vështrim i përgjithshëm rreth muzikës dhe vlerave të saj | 17 |
| 2.3.1. Edukimi muzikor përmes shkollës                       | 21 |
| 2.3.2. Integrimi i muzikës me lëndë të tjera në shkollë      | 25 |
| 2.3.3..Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare        | 26 |



|  |     |
|--|-----|
| 2.3.4.Integrimi i muzikës me lëndë të fushave të tjera   | 28  |
| 2.4.Zhvillimi konjitiv, psikosocial i fëmijës gjatë fëmijërisë së mesme  | 70  |
| 2.4.1.Zhvillimi i të menduarit   | 72  |
| 2.4.2.Ndikimi i muzikës në zhvillimin konjitiv e psiko – social të fëmijëve  | 75  |
| 2.4.3.Përdorimi i muzikës në klasë për të rritur të nxënit   | 79  |
| 2.5.Mësimdhënia dhe të nxënit e nxënësve të Arsimit Fillor   | 82  |
| 2.5.1.Mësimdhënia produktive   | 82  |
| 2.5.2.Veçoritë e arsimit fillor (klasat I - V)   | 87  |
| 2.5.3. Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar dhe metodat me në qendër nxënësin   | 88  |
|  | 93  |
| 2.5.4.Planifikimi në planin ditor të mësuesit i integritit ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera, në orë mësimore të lëndëve të ndryshme. |     |
| 2.5.5.Faktorët që ndikojnë në të nxënit produktiv  | 98  |
| 2.5.6.Krijimi i mjedisit motivues  | 100 |
| 2.5.7.Strategjitë e të nxënit produktiv përmes mësimdhënies integruese   | 101 |
| <b>KAPITULLI III: METODOLOGJIA E STUDIMIT</b>  | 105 |
| 3.1. Përshkrimi i studimit   | 105 |
| 3.2. Burimet e referimit   | 106 |
| 3.3. Metodatat dhe instrumentet  | 106 |
| 3.4.Besueshmëria e instrumentit  | 107 |
| 3.5.Pilotimi i instrumentave   | 108 |
| 3.6.Procedura për mbledhjen e të dhënave sasiore të studimit   | 109 |
| 3.7.Përzgjedhja dhe përshkrimi i kampionimit   | 110 |

|   |           |
|---|-----------|
| 3.8.Hartimi i pyetësorit  | 114       |
| 3.9.Etika e përdorur në studim  | 115       |
| 3.10.Vështirësitë dhe kufizimet e hulumtimit  | 117       |
| <b>KAPITULLI IV : ANALIZA E TË REZULTATEVE</b>  | 119       |
| 4.1. Analizat statistikore  | 119       |
| 4.2. Analiza përshkruese e të dhënave   | 120       |
| 4.2.1.Të dhënat përshkruese për mësuesit sipas variablit zonë urbane- zonë rurale   | 120       |
| 4.2.2.Të dhënat përshkruese për mësuesit sipas variablit gjini (femërmashkull)  | 121       |
| 4.2.3.Të dhënat përshkruese përmbledhëse për mësuesit sipas variablit vjetërsi në punë  | 123       |
| 4.2.4. Të dhënat përshkruese për nxënësit sipas gjinisë   | 173       |
| 4.2.5.Të dhënat përshkruese për nxënësit sipas variablit zonë urbane- zonë rurale   | 179       |
| 4.3 Testimi i supozimeve statistikore   | 181       |
| 4.4 Analiza korrelacionale  | 192       |
| 4. 5.Analiza cilësore   | 194       |
| 4.6. Testimi i hipotezës dhe i pyetjeve kërkimore   | 199       |
| 4.7. Zbulimi i marrëdhënies midis elementeve muzikore në orën e mësimimit në të ndryshme dhe produktivitetit të orës mësimore | 210 lëndë |
| <b>5. DISKUTIMET E STUDIMIT</b>   | 218       |

|   |     |            |
|---|-----|------------|
| 5. 1 Përmbledhje  | 218 |            |
| 5.2. Diskutimi i të dhënave deskriptive                       | 218 |            |
| 5.2. Diskutimi i të dhënave deskriptive                       | 218 |            |
| 5.2. 1. <i>Diskutimi i të dhënave deskriptive të mësuesve</i> |     | 219        |
| 5.2.2. <i>Diskutimi i të dhënave deskriptive të nxënësve</i>  |     | 220        |
| 5.3. Diskutimi mbi vërtetësinë e hipotezës                    | 221 |            |
| 5.3.1. Diskutimi për pyetjet kërkimore të studimit            | 223 |            |
| <b>KAPITULLI VI : PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME</b>              |     | <b>227</b> |
| 6. 1 Përfundime   | 227 |            |
| 6.2. Rekomandime  | 235 |            |
| 6.3. Mundësi për studime të mëtejshme                         | 237 |            |
| LITERATURA  | 238 |            |
| SHTOJCA   | 248 |            |



## **KAPITULLI I: HYRJE DHE BAZIMI TEORIK**

### **1.1.Hyrja**

*“Arsimi pa kulturë muzikore është gjysmë arsimim”.*

#### **Dr. Pavlov**

Për të realizuar këtë kërkim shkencor, u mbështetëm te përqsja dhe krahasimi i literaturave të ndryshme. Duke lexuar, studiuar dhe hulumtuar literaturën për trajtimin sa më vizionar të këtij punimi shkencor, vërehet se çfarë rëndësie ka edukimi muzikor në jetën e njeriut. Gjithashtu, vend të rëndësishëm edukimi muzikor zë në të gjithë sistemin e arsimit bashkëkohor.

Gjithnjë, që nga fillimet e para të shoqërisë njerëzore, artet kanë luajtur rol të rëndësishëm në jetën e njeriut. Arti muzikor ka qenë dhe është prezent në shfaqjet e ndryshme jetësore. Që në lashtësi, muzika zinte vend të dukshëm. Sigurisht, në atë kohë nuk kishte institucione edukative, por përvoja e të rriturve transmetohej në gjeneratat e reja gjatë procesit të punës.

Muzika, rolin e saj të edukimit estetik në jetën e njeriut e fillon herët që në fëmijëri, në shkollë dhe në jetën e përditshme shoqërore. Arti muzikor ka fuqi të madhe shprehëse që të depërtojë thellë në vetëdijen tonë. Pikërisht këtu qëndron mundësia për ndikim edukativ – arsimor të muzikës.

Edukata dhe arsimimi muzikor nxit procese psikike e njëkohësisht ndikon në procese fizike, sepse ato janë të ndërlidhura dhe të kushtëzuara. Ndaj integrimi i lëndës së muzikës me

lëndët e tjera në shkollë, përmes integritit ndërlëndor krijon një mjedis mësimor të qetë e të këndshëm, nxit imagjinatën e nxënësve dhe kreativitetin e tyre dhe rrit produktivitetin e të nxënësve.

Muzika është një disiplinë artistike dhe gjuhë universale që ndihmon nxënësit të kuptojnë e të lidhin fenomenet dhe dukuritë muzikore, proceset dhe çështjet që i përkasin muzikës duke vërtetuar ligjshmërinë e tyre. Shpjegimi i mënyrave të interpretimit dhe të ndërtimit të tyre çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të mësimin të muzikës.

Muzika qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (artit në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit.

Zhvillimi i muzikës në shkollë është një vlerë e madhe për të mundësuar edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar dhe krijuar në mënyrë të pavarur, sistematike si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

Gjatë procesit të mësimdhënies mësuesit shfrytëzojnë përvojat e ndryshme metodologjike për të arritur produktivitetin e orës së mësimin. Nisur nga teoricienët e fushës së psikologjisë së zhvillimit dhe të fushës së pedagogjisë se mosha e hershme është ideale për të filluar ushtrimin me muzikë, janë bërë përpjekje të vazhdueshme që me përmbajtjet, metodat dhe me veprimtaritë e larmishme, ku gërshetohen temat ndërlëndore, të zgjohet tek nxënësit

interesimi për muzikën dhe të arrihet gradualisht zhvillimi i aftësive të tyre ë fusha të ndryshme në shkollë.

## **1.2.Shtrimi i problemit**

Ky studim eksploron efikasitetin e ndërthurjes së edukatës muzikore me lëndët e tjera në orën e mësimit.

Kalimi nga mësimdhënia tradicionale në mësimdhënien bashkëkohore dhe aplikimi i kurrikulës me bazë kompetencash në sistemin arsimor parauniversitar në Kosovë ka sjellë ndryshime në konceptim të procesit të të nxënit.

Konceptimet bashkëkohore për procesin e të nxënit theksojnë rolin aktiv të nxënësve në zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave. Nxënësit duhet të jenë veprimtarë aktivë, ta ndërtojnë vetë të nxënit e tyre. Kjo kërkon edhe ndryshimin e rolit të mësuesve që duhet të jenë, gjithnjë e më shumë, drejtues dhe krijues të situatave të të nxënit, duke përdorur metoda dhe strategji efikase, bashkëkohore, motivuese.

Gjithnjë e më tepër, në ditët e sotme, po synohet drejt integritit ndërlëndor, pasi mësimi i lëndëve mësimore të ndara nga njëra – tjetra çon në marrjen e njohurive të fragmentuara nga nxënësit.

Pavarësisht se parimisht integrimi ndërlëndor duket se është i zgjidhur për sa i përket dokumentacionit arsimor të Kosovës, praktikisht vihet re se në arsimin parauniversitar nuk është arritur nga mësuesit integrimi ndërlëndor. Kjo vihet re sidomos në integrimin e lëndëve që u përkasin fushave të ndryshme lëndore.

Edukimi muzikor shihet si lëndë joprimare në shkollë, për shkak të dy faktorëve: së pari, të sasisë së pakët të orëve që kjo lëndë zë në programin mësimor, në krahasim me lëndët që cilësohen, nga mësuesit dhe nxënësit, “kryesore”; së dyti, të mosnjohjes nga ana e mësuesve dhe e nxënësve të rëndësisë që ka edukimi muzikor në zhvillimin konjitiv, psikik, social të individit. Duke mos njohur vlerat e edukimit muzikor, shumica e mësuesve të lëndëve të tjera i përdorin pak apo aspak elementet muzikore në dobi të krijimit të një mjedisi sa më tërheqës dhe qetësues për nxënësit dhe duke mos bërë integrimin ndërlëndor të lëndëve të ndryshme me edukimin muzikor.

Ndërlidhja në edukimin muzikor mund të realizohet me të gjitha komponentet mësimore, qoftë në mënyrë direkte brenda vetë lëndës ose indirekte me lëndët tjera mësimore.

### **1.3.Qëllimi dhe objektivat e studimit**

Qëllimi i këtij punimi është të studiojë ndikimin që ka integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera mësimore, përmes aplikimit të elementeve muzikore në lëndë të ndryshme gjatë orës së mësimi.

Objektivat e studimit

- Të hulumtojë rreth integrimin ndërlëndor të edukatës muzikore me lëndët e tjera në shkollat fillore.



- Të nxjerrë në pah rëndësinë e përdorimit të muzikës brenda orës mësimore në lëndë të ndryshme në shkollë.
- Të eksplorojë rreth ndikimit që ka përdorimi i muzikës në rritjen e performancës akademike të nxënësve në lëndë të ndryshme në shkollë.
- Të eksplorojë rreth ndikimit që ka përdorimi i muzikës në lëndë të ndryshme, në përmirësimin e gjendjes shpirtërore të nxënësve.

#### **1.4.Pyetjet kërkimore**

Ky punim shkencor kërkon t'i përgjigjet pyetjes kërkimore:

- A ndikon në produktivitetin e orës mësimore, në lëndë të ndryshme, vendosja e muzikës në sfond dhe aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit?

Gjithashtu, krahas pyetjes kryesore kërkimore, që përbën boshti e studimit, për vetë fushë e gjerë që trajton tematika, janë ngritur dhe një sërë pyetjesh ndihmëse:

- A ndikon në të nxënit e nxënësve integrimi ndër-lëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore?
- A ndikon në gjendjen psikologjike të nxënësve muzika në orën e mësimit?

- A zbatohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera mësimore, në orë të ndryshme mësimore, në lëndë të ndryshme, nga mësuesit e arsimit fillor?
- A ka lidhje mes përdorimit të metodave integruese nga mësuesit e arsimit fillor dhe vjetërsisë së tyre në punë, si mësimdhënës?
- Në cilat shkolla (urbane apo rurale) aplikohet më shumë nga mësuesit ky integrim ndërlëndor?
- Në cilat lëndë realizohet më shumë integrimi ndërlëndor i muzikës në orë të ndryshme mësimore? Në cilat realizohet më pak ose nuk realizohet?

### **1.5. Hipotezat**

Hipoteza kryesore: Duke aplikuar elementet muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme, rritet produktiviteti i orës mësimore.

Hipoteza nul: Aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme nuk ka asnjë ndikim në produktivitetin e orës së mësimit.

### **1.6. Variablat**

Në produktivitetin e orës së mësimit ndikojnë shumë faktorë, objektivë dhe subjektivë . Integrimi ndërlëndor gjithnjë e më tepër, dita – ditës, shihet se ndikon pozitivisht në nxënien cilësore të nxënësve.

Për qëllimet e studimit tonë, vëmendja është përqendruar në integrimin e edukatës muzikore me lëndët e tjera. Pra, për të vërtetuar hipotezën, vëmendja është përqendruar në dy variabla:

- Variabëli i pavarur – integrimi i muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme
- Variabëli i varur – rritja e produktivitetit të orës së mësimin

Nga studimet e gjetura dhe të parashtruara në pjesë “Shqyrtimi i literaturës”, shihet se muzika ndikon pozitivisht në zhvillimin konjitiv të nxënësve, duke stimuluar zhvillimin e trurit, duke ndikuar pozitivisht dhe në performancën e tyre në të nxënë.

Gjithashtu, muzika në shkollë ndikon në krijimin e një mjedisi të qetë dhe mbështetës për të mësuar. Ajo ndikon në gjendjen shpirtërore të nxënësve, duke reduktuar stresin.

Prandaj, në studimin tonë, muzikën e kemi marrë në fokusi e integritit ndërlëndor për të rritur produktivitetin e orës së mësimin.

### **1.7. Rëndësia e studimit**

Krahas faktorëve të tjerë familjarë , mjedisorë e shoqërorë , në zhvillimin konjitiv e psiko – social të fëmijëve, një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan edhe muzika, e cila ndikon fuqishëm në gjendjen shpirtërore të tyre, duke sjellë te ta përmirësim të humorit dhe duke i dhënë dinamikë ritmit të jetës.

Studimet kanë dëshmuar se muzika ka lidhje me shumë fusha të tjera, si: gjuha, letërsia, matematika, historia, piktura, etj., ndaj një nga prioritetet e sotme të arsimit të fëmijë ve në shkollë është ndërlidhja e edukatës muzikore me lëndët e tjera përmes integritit ndërlëndor në shkollë .

Pikërisht, tek integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera në orën e mësimi qëndron rëndësia e këtij studimi, i cili synon të sjellë strategji të ndryshme efikase të integritit të muzikës në orën e mësimi në lëndë të ndryshme.

Zbatimi i muzikës në klasë mund të ndihmojë nxënësit që të jetë shumë të motivuar dhe kreativë , duke marrë pjesë gjallërisht në orën e mësimi, drejt rritjes së performancës së tyre shkollore.

### **1.8. Struktura e punimit**

Ky punim shkencor është strukturuar në gjashtë kapituj, duke u ndalur në vështrimi teorik dhe metodologjik. Renditja e kapitujve është bërë sipas udhëzimeve të marra nga Universiteti Europian i Tiranës.

Në secilin kapitull janë pasqyruar këto informacione:

**Në kapitullin e parë** të punimit pasqyrohen në mënyrë të detajuar informacione të rëndësishme të studimit, duke u ndalur në qëllimin dhe objektivat e studimit, shtrimin e

problemit, rëndësinë e studimit, pyetjet kërkimore, hipotezat e ngritura, si dhe variablat e studimit.

**Në kapitullin e dytë** të punimit pasqyrohen në mënyrë të detajuar gjetjeve shkencore të studiuesve të ndryshëm rreth ndikimit të muzikës në jetën e njeriut, rëndësisë së futjes së muzikës si lëndë shkollore në shkollë, rëndësisë së saj në zhvillimin emocional, social dhe konjitiv të nxënësve.

Gjithashtu, në këtë kapitull vëmendja është përqendruar në studimet e autorëve të ndryshëm rreth rëndësisë së integritit ndërlëndor për rritjen e produktivitetit të orës së mësimit, në të nxënit e dijeve jo të fragmentarizuara.

**Në kapitullin e tretë** të punimit përshkruhet në mënyrë të detajuar metodologjia e përdorur për realizimin e këtij studimi (metodat dhe instrumentet e përdorur, kufizimet e studimit, përzgjedhja e kampionimit, etika e përdorur në studim).

**Në kapitullin e katërt** të punimit pasqyrohen rezultatet e gjetura nëpërmjet anketimit të mësuesve dhe nxënësve për të parë ndikimin që ka muzika te nxënësit dhe rëndësinë e integritit të edukatës muzikore me lëndët e tjera në orën e mësimit.

Në këtë kapitull merr përgjigje pyetja kërkimore dhe testohet hipoteza kërkimore e ngritur për këtë studim.

**Në kapitullin e pestë**, pasqyrohet përpunimi i këtyre rezultateve me anë të programit statistikor SPSS, në mënyrë të hollësishme vlerat ndërmjet variablave të studimit.

**Në kapitulli e gjashtë** pasqyrohen përfundimet e arritura nga studimi mbi rëndësinë që ka integrimi ndërlëndor i muzikës në produktivitetin e orës së mësimin në lëndë të ndryshme. Gjithashtu, në këtë kapitull jepen rekomandime për mësuesit që të aplikojnë integrimin ndërlëndor të lëndëve të ndryshme me muzikën, për tema të ndryshme lëndore. Gjithashtu, rekomandohen edhe drejtuesit arsimorë, qoftë në nivel institucioni shkollor, qoftë në nivel të agjencive trajnuese që të zhvillojnë me mësuesit trajnime në fokus të të cilëve të jetë integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera shkollore.

## **KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS**

### **2.1.Hyrje**

Në këtë hulumtim, shqyrtimi i literaturës është i ndarë në dy pjesë: në pjesën e parë janë shqyrtuar teoritë më të njohura mbi zhvillimin e gjithanshëm të individit në fëmijërinë e mesme, si: Teoria e zhvillimit sipas Piazhësë, Teoria e zhvillimit sipas Erikson, Teoria e zhvillimit sipas Bandurës, Teoria e zhvillimit sipas Vigotskyt, Teoria e zhvillimit sipas Adlerit.

Në pjesën e dytë janë shqyrtuar studimet empirike mbi rëndësinë e edukatës muzikore në zhvillimin e individit në përgjithësi, sidomos në moshën e fëmijërisë. Në këtë pjesë janë shqyrtuar në mënyrë të hollësishme gjetjet nga studiues të ndryshëm rreth ndërlidhjes së edukatës muzikore në shkollë me lëndë të tjera mësimore, pasi muzika lidhet me fusha të ndryshme, si: gjuha, letërsia, matematika, fizika, historia, edukimi muzikor. Pra, me të gjitha fushat e jetës.

Duke parë lidhjen e muzikës me fusha të tjera të jetës, në pjesën e literaturës, janë shqyrtuar në mënyrë të hollësishme studimet e ekspertëve të fushës së edukimit rreth rëndësisë së integritimit ndërlëndor në shkollë, si pjesë mirëfunktionale e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

## **2.2. Teoritë shkencore mbështetëse të studimit**

Si çdo studim që ka nevojë për literaturën mbështetëse, edhe ky studim mbështetet mbi teoritë dhe studimet shkencore të të nxënit.

Teoritë që do të shqyrtohen në këtë hulumtim dhe do të na ndihmojnë për të hedhur dritë dhe për të mbështetur studimin rreth rëndësisë së ndërlidhjes së edukatës muzikore me lëndët e tjera, përmes integritimit ndërlëndor, në orën e mësimi, janë menduar të jenë :

- Teoritë e zhvillimit në fëmijërinë e mesme
- Teoritë e të nxënit

Mbështetja në këto teori mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e të nxënësve përmes ndërlidhjes së edukatës muzikore me lëndët e tjera, përmes integritit ndërlëndor, në orën e mësimit.

### ***2.2.1. Teoritë e zhvillimit në fëmijërinë e mesme***

Zhvillim i fëmijës, është pjesë integrale e procesit të rritjes dhe zhvillimit të qenies njerëzore. Të zhvilluarit, është një proces shumëdimensional, i cili përfshin aspektet fizike, psikologjike dhe sociale. Studiues të ndryshëm në fushën e psikologjisë, kanë parë proceset e rritjes dhe zhvillimit në aspekte të ndryshme.

Interesi për fushën e zhvillimit të fëmijëve, u shfaq në fillim të shekullit të 20-të. Në këtë periudhë studiuesit u bënë gjithnjë e më të interesuar në këtë fushë, duke përfshirë zhvillimin e fëmijëve në aspektin psikosocial, si dhe ndikimet në zhvillim. Studimi i fushës së zhvillimit të fëmijës paraqet mjaft interes, pasi nëpërmjet teorive të ndryshme, mësojmë për rritjen dhe mbarëvajtjen e tyre, gjë që na lejon të vlerësojmë plotësisht anën e zhvillimit emocional, fizik, social, dhe arritjen arsimore të fëmijëve, të cilët do të rriten dhe zhvillohen nëpër etapat që nga lindja dhe deri në moshën e rritur. Disa nga teoritë kryesore të zhvillimit të fëmijës janë të njohura si teori të mëdha dhe të rëndësishme. Ato përqipen për të përshkruar çdo aspekt të zhvillimit, si atë fizik, psikologjik, emocional ashtu edhe atë social. Më poshtë, janë vetëm disa nga shumë teori të zhvillimit të fëmijëve që janë sjellë nga teoricienë dhe studiues, të cilat përshkruajë fazat e zhvillimit psikosocial të fëmijëve dhe identifikimin e moshave tipike, nëpër të cilat rritet dhe zhvillohet qenia njerëzore. etj.



Teoria e sjellë nga Zigmund Frojdi, ka theksuar rëndësinë e ngjarjeve të fëmijërisë dhe përvojat e kaluara përgjatë stadeve të rritjes dhe zhvillimit të tyre. Sipas Frojdit, zhvillimi i fëmijës është përshkruar si një seri e "stadeve psikoseksuale". Frojdi i paraqiti këto faza si oral, anal, fallik, latent dhe gjenital. Frojdi sugjeroi se çdo fazë mund të luajë një rol në personalitetin e të rriturve.

### ***Teoria e zhvillimit sipas Eriksonit***

Teoricieni Erik Erikson solli teorinë e fazave të zhvillimit, por teoria e tij përfshinte rritjen e njeriut gjatë gjithë jetës. Eriksoni besonte se çdo fazë e zhvillimit është e fokusuar në tejkalimin e konfliktit. Teoria e Erik Eriksonit për zhvillimin psikosocial, është një nga teoritë më të njohur të personalitetit në psikologji. Erikson besonte se personaliteti zhvillohet në një seri të ndryshme fazash. Teoria psikosociale e Eriksonit përshkruan ndikimin e përvojës shoqërore, nëpër të gjithë jetëgjatësinë e individit. Një nga elementet kryesore të kësaj teorie është zhvillimi i identitetit vetja. Sipas Eriksonit, identiteti ynë, vetja jonë, është vazhdimisht në ndryshim për shkak të përvojave të reja dhe informacionit që ne fitojmë, në ndërveprimet tona të përditshme me të tjerët. Formimi i identitetit, është diçka që fillon në fëmijëri dhe bëhet veçanërisht e rëndësishme gjatë adoleshencës, por është një proces që vazhdon gjatë gjithë jetës. Identiteti ynë personal, i jep secilit prej nesh një ndjenjë të integruar dhe kohezive e që vazhdon të rritet me moshën. Çdo fazë në teorinë e Eriksonit ka të bëjë me faktin se personaliteti i njeriut, shkon duke u bërë më i aftë ose kompetent në një fushë të caktuar të jetës së tij. Nëse faza është trajtuar mirë, personi do të ketë një ndjenjë zotërimi, e cila nganjëherë është duke iu referuar forcës si “vetja”, apo

cilësinë “vetja”. Nëse kjo fazë është menaxhuar keq, personi do të dalë me një ndjenjë të pamjaftueshmërisë.

### *Teoria e zhvillimit sipas Piazhës*

Teoricieni Zhan Piazhë, solli teorinë që fëmijët mendojnë ndryshe nga të rriturit dhe propozoi teorinë e fazës së zhvillimit konjitiv sipas skemave. Ai ishte i pari që vuri re se fëmijët luajnë një rol aktiv nëpërmjet fitimit të njohurive të botës. Sipas teorisë së tij, për të zgjidhur një problem, fëmija duhet të zhvillojë strukturat konjitive më komplekse ose skemat e të menduarit. Piazhë studioi mënyrat me anë të të cilave fëmijët përvetësojnë konceptet dhe organizojnë idetë dhe skicoi periudhat e parashikueshme sipas një rendi të caktuar të zhvillimit intelektual. Progresi i këtyre periudhave varet nga përshtatshmëria vazhdimisht në rritje e fëmijës ndaj situatave të reja. Për Piazhën, për zhvillimin konjitiv, janë të rëndësishme dy procese: asimilimi dhe akomodimi.

Asimilimi është procesi me anë të të cilit përshtatet informacioni i ri në skemat ekzistuese. Akomodimi (rregullimi) është procesi i krijimit të një skeme të re ose ndryshimi i një skeme ekzistuese. Sipas Piazhës, bashkëveprimi dhe balanca e procesit të asimilimit dhe akomodimit, i quajtur ekuilibër, janë përgjegjëse për zhvillimin intelektual të fëmijës. Ai u përpoq të kuptonte se si formohen dhe funksionojnë strukturat konjitive ose skemat. Piazhë thotë se ne trashëgojmë një metodë të funksionimit intelektual, që na bën të aftë të reagojmë ndaj mjedisit, me anë të formimit të strukturave kognitive. Piazhë besonte gjithashtu, se individi zhvillohet konjitivisht përmes formimit të strukturave konjitive më të sofistikuara

në kohën që kalon përmes katër stadeve: stadi sensomotorik; stadi paraoperacional; stadi i operacioneve konkrete dhe stadi i operacioneve formale.

### ***Teoria e zhvillimit sipas Bandurës***

Psikologu Albert Bandura, solli atë që njihet si teoria e të mësuarit social. Sipas kësaj teorie të zhvillimit të fëmijës, fëmija mëson sjellje të reja nga të respektuarit e të tjerëve. Ndryshe nga teoritë e sjelljes, Bandura besonte se forcimi i jashtëm nuk ishte e vetmja mënyrë që njerëzit mësojnë gjëra të reja. Në vend të saj, përforcimet e brendshme, të tilla si ndjenja e krenarisë, kënaqësisë dhe arritjet, mund të çojë në të mësuarit. Pra, përmes muzikës nxënësit, bëhen më socialë, pasi zhduket kompleksi i të mbyllurit në vetvete.

### ***Teoria e zhvillimit sipas Vigotskit***

Në teorinë e tij Vigotski, trajtoi idenë unike pasi ai identifikonte dy rrugë për zhvillimin konjitiv: proceset biologjike dhe proceset psikologjike. Sipas tij, sjelljet e fëmijëve vijnë si rezultat i bashkëveprimit të këtyre procese biologjike dhe psikologjike. Për të kuptuar zhvillimin konjitiv, duhet të studiojmë proceset kulturore dhe sociale që i formojnë fëmijët. Teoria e tij socio-kulturore, gjithashtu sugjeroi se prindërit, kujdestarët dhe gjithë pjesëmarrësit në jetën e një fëmije dhe kultura në përgjithësi, janë përgjegjës për zhvillimin e funksioneve më të larta të të menduarit duke ju referuar proceseve interpsikologjike (bashkëveprimi social me të tjerët), dhe intrapsikologjik (përdorimi i të folurit të brendshëm për të drejtuar sjelljen).

### ***Teoria e zhvillimit sipas Adlerit***

Adleri ofroi nëpërmjet teorisë së psikologjisë individuale drejtimin social, rëndësinë që ka marrëdhëniet sociale, pasi njeriu është një qenie sociale dhe motivohet prej nevojave sociale. Qëndrimet sociale karakterizohen nga dëshira që ka individi për të bashkëpunuar me të tjerët, të cilët mund të jenë familja, grupe të mëdha, shkolla, etj. Gjithashtu, në teorinë e psikologjisë individuale, gjejmë edhe detyrat sociale që i dalin individit në procesin e zhvillimit të tij individual, siç është dashuria, miqësia dhe puna. Mënyra se individi e sheh veten në grupin e parë social që ai i përket, nëse individi përgjatë zhvillimit brenda ambientit ku jeton, ka një vlerësim dhe vetëvlerësim të lartë social, ai individ do të vazhdojë të rritet pozitivisht, nëse ndodh e kundërta që individi s'ka vetëvlerësim të lartë.

### ***2.2.2. Teoritë e të nxënimit***

Sipas teorisë konjitive, të nxënimit është një proces zhvillimor kognitiv, se nxënësit krijojnë të nxënimit sesa e marrin atë nga mësuesi. Qëllimi i edukimit sipas Piagjetit është të formojë individë kritikë, kreativë, zbulues dhe shpikës. Kështu pjesa më e madhe e të nxënimit të fëmijët mbështetet në eksperimentimin dhe zbulimin aktiv. Që të arrihet formimi i individëve të tillë, duhet që vëmendja e punës së edukatorëve dhe mësuesve të përqendrohet në aktivizimin e inteligjencave të nxënësve.

Howard Gardner, në vitin 1983, propozoi Teorinë e Inteligjencave të Shumëfishta, në themel të së cilës qëndron kreativiteti. Sipas kësaj teorie, ekzistojnë të paktën tetë lloje të veçanta të inteligjencave: Inteligjenca gjuhësore (verbale), muzikore, hapësinore, logjike – matematikore, trupore – kinestetike (lëvizja), ndërpersonale (të kuptuarit e të tjerëve),

intrapersonale (të kuptuarit e vetes) dhe natyraliste (vëzhgimi dhe kuptimi i sistemeve dhe modeleve të krijuara nga natyra dhe nga njeriu). Gardneri e bazon nocionin e tij për aftësitë e veçanta mbi faktet dhe provat e dëmtimit të trurit (për shembull nga një goditje cerebrale) shpesh prek funksionet e njëres prej zonave të trurit, si për shembull, gjuhën, por nuk prek funksionet e zonave të tjera të trurit. Përveç kësaj, individit mund të shkëlqejë në njëren prej këtyre tetë fushave, pra të mos ketë aftësi të spikatura në shtatë fushat e tjera. (Woolfolk, 2011, 115)

Sipas Graderit, çdo individ posedon këto inteligjenca, pavarësisht intensitetit të zhvillimit të tyre. Ato janë të pavarura nga njëra – tjetra. Sipas Gardnerit, për t'u zhvilluar një individ me të gjitha aftësitë e duhura për të njohur botën, duhet të ushqehen të gjitha këto inteligjenca. Inteligjencat, pavarësisht se janë të pavarura nga njëra – tjetra, ato ndihmojnë njëra – tjetrën të zhvillohet. Hulumtimet e shumta në fushën e muzikës kanë arritur në përfundimin se muzika ka lidhje me shumë fusha të jetës, madje edhe me shkencat ekzakte, si matematikën dhe fizikën.

Sipas pikëpamjes bihejvioriste, kuptimi i motivimit të nxënësit fillon me një analizë të kujdesshme të nxitjeve dhe shpërblimeve që janë të pranishme në klasë. Shpërblimi është objekt ose ngjarje tërheqëse që jepet si pasojë e një sjelljeje të veçantë. Nxitja është objekt ose ngjarje që inkurajon ose shkurajon sjelljen. Si nxitës të procesit të të mësuarit në orën e mësimi mund të shërbejë futja e elementeve muzikore si teknika efikase për një gjithëpërfshirje aktive e nxënësve në orën e mësimi (Woolfolk, 2011, 378) Në lidhje me

këtë, Maria Montesori besonte se nxënësit mësojnë nëpërmjet veprimtarive të zgjedhura me kujdes.

Teoria sociokonjitive ka në qendër mënyrën sesi njerëzit përftojnë aftësi shoqërore, emocionale, konjitive dhe të sjelljes; sesi njerëzit e rregullojnë jetën e tyre dhe çfarë i motivon ata (Bandura 2007; Bandura & Locke,2003). Pra, mësuesi gjatë procesit të mësimdhënies duhet të marrë parasysh interesat dhe prirjet e nxënësve, ndër të cilat mund të jenë prirjet muzikore.

## **Pjesa e dytë**

### **2.3.Edukimi muzikor. Vështrim i përgjithshëm rreth muzikës dhe vlerave të saj**

Estetika, si shkencë filozofike, studion qëndrimin dhe raportin e njeriut ndaj vlerave estetike, kudo qofshin ato: në art, në natyrë, në shoqëri, në të menduarit njerëzor, në jetë, në punë. Një vend të rëndësishëm në edukimin estetik të njeriut tonë zë edukimi muzikor me të gjithë aspektet e tij, si shfaqjet muzikore, emisionet e radio dhe të televizionit, koncertet vokale – instrumentale, koncertet simfonike, opera, baleti etj. (Kalemi, 1973: 3)

Muzika e konsideruar si “art i të shprehurit përmes tingujve, ndjenjave e mendimeve të njerëzve” apo “radhitje dhe kombinim tonesh” ka magjinë e saj të ndikojë në botën shpirtërore të dëgjuesit. Këta tinguj, janë organizuar në mënyrë të tillë që të kenë një efekt të këndshëm për veshin dhe të krijojnë një përshtypje të prekshme dhe të kuptueshme... këto

përshtypje kanë fuqinë të ndikojnë në pjesët e fshehura të shpirtit dhe zonat e ndjeshme.  
(Gardner, 2003: 141)

Në Greqinë e lashtë, arti përfaqësohej nga një bashkësi trielementëshe, ku “...poezia, muzika dhe vallja kanë qenë interpretuar nga aktorë – këngëtarë – valltarë të njëjtë, në amfiteatrot në natyrë. Në Iliri, arti muzikor ishte në kufirin e një gjuhe universale. Në prag të shek XX, muzika që kultivohej në Shqipëri, ishte ende e lidhur me muzikën e kultit. (Tole, 1997: 8-13)

Prania e muzikës është më e përhapur tani se kurrë më parë në histori. Muzika nuk është vetëm një formë arti për kënaqësi, ajo gjithashtu përmirëson gjendjen psikologjike të njeriut (Lin, Hsu, Chang, Hsu, Chou, & Crawford, 2009: 1139-1148), sjelljen e tij, përmirëson aftësitë njohëse (Furnham, Trew, & Sneade, 1999), si dhe përmirëson gjendjen emocionale (Cevasco, 2008: 273-306).

Muzika e ka shoqëruar njerëzimin përgjatë gjithë historisë njerëzore, në momente të ndryshme të jetës, në gëzime dhe hidhërime. Vlera dhe e bukura e muzikës është krijimi i emocioneve dhe përshtypjeve që shkakton kur e dëgjojmë. Muzika ka forcë shprehëse dhe ka një domethënie, një kuptim, që na komunikohet dhe kjo përbën esencën dhe vlerën e saj. Ajo ndikon në zhvillimin emocional të dëgjuesit, duke e bërë këtë të fundit të mendojë, përfytyrojë dhe reflektojë rreth pasazheve muzikore që dëgjon. Le të kujtojmë muzikën me të cilën shoqërohet lufta te filmi “Skënderbeu”, dëgjimi i së cilës krijon menjëherë emocione që kanë lidhje me heroikën e luftës, ose muzika e filmit “Ngadhënjim mbi vdekjen”, tek e

cila kuptohet qartë cila melodi shpreh veprimin e armiqve dhe cila atë të heronjve. (Kalemi, 1973: 11)

Muzika ndihmon shumë në sjelljet e njeriut. Mund të themi se çdo ndjenjë gëzimi, mërzie, dhimbje apo lodhje mundet të shprehet me muzikë. Muzika është aq e fuqishme saqë është e mundur që disa njerëz të krijojnë varësi ndaj saj. Për shumicën e njerëzve, muzika është tepër e dobishme gjatë punës, madje rrit performancën, sepse rregullon gjendjen shpirtërore duke e bërë një njeri të lumtur. Zhurma i ndihmon disa njerëz të përqendrohen. Gjithashtu muzika, teksti dhe zëri na bëjnë më bashkëpunues. Dëgjimi i muzikës i bën njerëzit më të ndjeshëm. Pra, muzika është arti më i drejtpërdrejt, pasi depërton në trurin e njeriut.

Përveç zhvillimit të shkathtësive personale dhe shoqërore, muzika mund të ketë aftësinë për të rritur ndjeshmërinë emocionale. Resnisow et al. (2004) zbuloi se kishte një marrëdhënie midis aftësisë për të menaxhuar emocionet në shfaqjet e muzikës klasike të pianos dhe inteligjencës emocionale.

Studimet e të rriturve kanë treguar përfitime fizike duke u angazhuar me muzikë. Duke luajtur piano ushtron zemrën po aq sa një shëtitje e shpejtë (Parr, 1985). Gjithashtu, vihet re se te personat që ndjekin ngjarje kulturore, lexojnë libra ose periodikë, këndojnë ose bëjnë muzikë, normat e vdekshmërisë janë më të ulëta. (Bygren, Konlaan & Johnansson, 1996;

Konlaan, Bygren dhe Johnansson, 2000: 174; Johnansson, Konlaan dhe Bygren, 2001: 229234; Hyypa dhe Maki, 2001: 148-155).



Studimet tregojnë se ka një marrëdhënie pozitive ndërmjet muzikës dhe ndjenjës së lumturisë. Hulumtimet e kryera për të shpjeguar marrëdhënien midis muzikës dhe lobeve frontale zbuluan se në përgjithësi muzika rrit aktivitetin brenda lobit të majtë, e cila shoqërohet me lumturinë. (Strichland, 2001/2002:101)

Pra, përfitimet që vijnë nga muzika janë: relaksimi fizik; çlirimi nga emocionet negative dhe uljen e ndjenjave të stresit; ndjenja e lumturisë, humori pozitiv, gëzimi; ndjenja të zgjimit dhe energjisë; stimulimin i kapaciteteve të njohjes, vëmendja, përqendrimi, kujtesa dhe mësimi; ndjenja e rritur e vetëbesimit; një ndjenjë të përfitimit terapeutik rreth problemeve psikologjike dhe sociale; aktivitete të vlefshme që japin ndjenjën e qëllimit dhe motivimit (Clift et al, 2008; Stacey et al., 2002)

Clift dhe Hancox (2001: 248-256) raportojnë se në një studim të 84 anëtarëve të një shoqërie korale të një kolegji, rezultoi se 87% e tyre treguan se kishin përfituar prej muzikës në aspektin social, 75% në aspektin emocional dhe 49% në aspektin shpirtëror.

Deri më sot, efektet e muzikës në sfond kanë qenë me interes për grupe të ndryshme të studiuesve, duke përfshirë psikologët, terapistët dhe mjekët. Psikologët e aplikuar janë të interesuar në atë se si muzika rrit ose zvogëlon produktivitetin; psikologët njohës janë të interesuar në mënyrën se si muzika përmirëson vëmendjen dhe përpunimin e informacionit gjatë detyrave të ndryshme; dhe teoricienët e personalitetit janë të interesuar të shohin si reagojnë për kryerjen e detyrave të dhëna individët, në praninë e muzikës.

Për efektet pozitive që shkakton muzika në gjendjen shpirtërore të dëgjuesit, në ditët e sotme ajo është mjaft e popullarizuar edhe në ambiente të tilla si: qendra tregtare apo edhe në mjediset spitalore. Sipas Murphey (1992: 37) tani, muzika e humorit është shumë e popullarizuar, qoftë në kirurgjinë e dentistit për të na çlodhur, ose në qendrat tregtare për të na inkurajuar për të blerë. Kirurgët e zemrës përdorin muzikë për të relaksuar ekipet operative gjatë operacioneve të gjata dhe të vështira. Në një spital në Londër gratë mund të dëgjojnë muzikë gjatë lindjes për t'u çlodhur.

Edukimi muzikor ushqen komponentët e nivelit të lartë si angazhimin, këmbënguljen apo aftësinë e problemzgjdhjes (Costa & Kallick, 2000), zakone të mendjes që janë thelbësore për të arritur sukses në ditët e sotme, në ekonominë globale, të bazuar në dijen.

### **2.3.1. Edukimi muzikor përmes shkollës**

Nisur nga roli i muzikës në jetën e njeriut dhe ndikimit që ka në të, shfaqet dhe rëndësia e formimit edukativ-muzikor. Edukata muzikore në shkollën fillore dhe të mesme të ulët ka për detyrë t'u japë mundësi nxënësve të aftësohen para se gjithash për:

- dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e mjeteve të informimit dhe shfaqjeve muzikore;
- pjesëmarrje në formacione korale dhe veprimtari të tjera muzikore;
- arsimim të mëtutjeshëm që nënkupton interesim më të gjerë me përgatitje për ndonjë profesion ku muzika është pjesë përbërëse.

### **Qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të lëndës së Edukatës muzikore janë:**

- Të sjellë gëzim, emocione pozitive, të zgjojë interes për veprimtari muzikore;
- Të formojë qëndrim pozitiv ndaj muzikës kombëtare dhe botërore;
- Të zhvillojë përgjegjësinë dhe kuptimin për pjesmarrje në muzikimin e përbashkët;
- Të këndohet dhe të luhen pëmbajtje muzikore;
- Të bëhet dëgjimi aktiv i muzikës duke i përjetuar dhe njohur cilësitë e saj;
- Të aftësojë për zgjedhjen e programeve muzikore dhe të edukojë;
- Të zhvillojë kritere për vlerësim dhe mendim kritik;

### **Objektivat specifike të lëndës së Edukatës muzikore janë:**

- të zhvillojë aftësitë muzikore (ndjenja ritmike, melodike e harmonike, formimi estetik dhe muzikaliteti) si dhe shkathhtësitë interpretuese;
- të njohin veprat muzikore, krijuese dhe interpretuese;
- të kuptohen konceptet themelore, ligjshmëritë dhe informacionet mbi mjetet, shprehjet elementare muzikore, format dhe llojet të cilat mundësojnë të kuptuarit e muzikës;

- të krijojë muzikë dhe të shprehë imagjinimet tingullore personale;
- të shprehë përjetime dhe përftyrime muzikore përmes lëvizjes, vallëzimit, shprehjes figurative dhe gjuhësore;
- të mundësojë njohjen e ndërlidhjes së muzikës me gjuhën amtare, të huaj dhe me artet tjera;
- të njihen shenjat themelore të shkrimit muzikor si dhe orientimi elementar në të;
- të ushtrohët zbatimin e teknologjisë bashkohore muzikore;
- të jepen informacione aktuale mbi shkollimin muzikor dhe profesionet muzikore.

Në programin e lëndës së muzikës (2014), mësojmë se “Muzika është një disiplinë artistike e artit dhe gjuhë universale që ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe lidhin fenomenet dhe dukuritë muzikore, proceset dhe çështjet që i përkasin muzikës, duke vërtetuar ligjshmërinë e tyre, si dhe duke shpjeguar mënyrat e interpretimit dhe ndërtimit të tyre, gjë e cila çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të mësimin të muzikës.”

Një nga lëndët më të hershme në shkollë është muzika. Muzika ndikon në zhvillimin e personalitetit të nxënësve, prandaj në kurrikulën e arsimit parauniversitar muzikës i lihet një hapësirë e konsiderueshme, krahas lëndëve të tjera.

Muzika ishte një komponent kryesor i programit shkollor në Greqinë e Vjetër, ashtu si në shkollat fetare ndër shekuj. Mësimi i këngës kishte vlerë për të marrë pjesë në shërbimet

fetare dhe gjithashtu për të ngritur ndjenjat patriotike. (Hala, 2002: 64) Në kurrikulën e shkollës Pitagoriane, muzika ishte e vendosur në të njëjtin nivel si aritmetika, gjeometria dhe astronomia. Pra, edukimi muzikor ë shtë vlerësuar si lëndë mësimore ndër shekuj.

Ndryshimet e bëra vitet e fundit në sistemin kurrikular arsimor të Kosovës, të bazuar në grupimi e lëndëve shkollore sipas fushave, ku bëjnë pjesë – Gjuhët dhe komunikimi; Artet; Matematika; Shkencat e natyrës; Shoqëria dhe mjedisi; Edukata fizike, sportet dhe shëndeti; Jeta dhe puna -, si dhe ndryshimet në konceptimin e të mësuarit, nga të mësuarit me objektiva, në të mësuarin në bazë të kompetencave, i kanë dhënë lëndës së Edukatës muzikore rëndësinë e duhur, përkrah lëndëve të tjera.

Në sistemin arsimor të Kosovës, në kurrikulën e arsimit parauniversitar, lënda e edukimit muzikor, për shkak të rëndësisë që ka në zhvillimin e nxënësve, zhvillohet në të gjitha shkallët e kurrikulës, duke qenë pjesë e kurrikulës, në fushën e Arteve.

Në Kurrikulën bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës, jepet ky përkufizim për kompetencat dhe rezultatet e të nxënit: “Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të njohurive, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat do t’u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura”, ndërsa “rezultatet e të nxënit përkufizohen si: “Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një nxënës/se në fund të një shkalle apo niveli”. Ato shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Rezultatet e të nxënit për

kompetenca shprehin pritjet e mësimdhënësve, të autoriteteve arsimore, të prindërve dhe të shoqërisë në raport me arritjet konkrete, të matshme, të nxënësve në fund të çdo shkalle të kurrikulës. Ato duhet të përdoren gjatë hartimit të programeve mësimore, organizimit mësimor në shkollë, hartimit të teksteve shkollore dhe materialeve mësimore.

Përmes lëndës së Edukimit muzikor, nxënësit zhvillojnë aftësi të ndryshme, si:

1. Aftësinë për të kënduar, duke mësuar të respektojnë rregullat e të kënduarit, të frymëmarrjes, të qëndrimit kritik ndaj tekstit të këngës etj.
2. Aftësinë për të dëgjuar muzikë, edukimi për të dëgjuar muzikë të të gjitha llojeve, përzgjedhja e muzikës, përcaktimi i llojit të muzikës që dëgjojnë.
3. Zhvillimi i aftësisë për të luajtur dhe shoqëruar muzikën përmes instrumenteve, duke shoqëruar këngët, lojërat apo pjesë të ndryshme muzikore.

Edukimi muzikor i përgatit nxënësit për të mësuar, duke rritur aftësitë motorike të tyre, duke përgatitur trurin për arritje, duke nxitur kujtesën superiore të punës dhe kultivuar aftësi më të mira të të menduarit.

Edukimi muzikor e ndihmon nxënësin edhe në përmirësimin e arritjet shkollore duke përmirësuar rikthimin dhe ruajtjen e informacionit verbal, duke përparuar arritjet në matematikë, duke nxitur të lexuarin, njohuritë gjuhësore dhe artet, gjithashtu edhe duke përmirësuar rezultatet mesatare të testeve të standardizuara.

Përmes edukimit muzikor zhvillohen kapacitetet krijuese për të pasur sukses gjatë gjithë jetës, duke mprehur vëmendjen e nxënësve, përforcuar këmbënguljen e tyre, nxitur shpirtin kreativ të tyre dhe inkurajuar zakonet më të mira të studimit dhe vetëvlerësimin e tyre.

### **2.3.2.Integrimi i muzikës me lëndë të tjera në shkollë**

Veprimtaritë dhe përmbajtjet në lëndë arti muzikor ndërlidhen thuajse me të gjitha fushat artistike dhe shkencore. Në këtë drejtim lidhjet më të ngushta realizohen me artet dhe gjuhën amtare e të huaj, psikologjinë, zhvillimin historik dhe sociologjik të shoqërisë, gjeografinë, lëndët nga shkencat e natyrës, fizikën, teknologjinë, ekologjinë etj.

Interpretimi në mësimdhënien e muzikës përfshin këndimin dhe luajtjen instrumentale. • Në këtë nivel këndimi duhet të përfshijë përmbajtje interesante që i nxisin nxënësit në përjetim;

- Përmbajtjet e këngëve duhet të zhvillojnë lirinë e të shprehurit vokal;
- Në raste të caktuara është mirë që të zhvillohet punë në grupe sipas mundësive të nxënësve, që ndikon në socializimin e tyre;
- Përzgjedhja e këngëve për këndim koral në klasë bëhet me kujdes, duke pasur parasysh vlerën artistike dhe interesimet aktuale të kësaj moshe;
- Këngët interpretohen sipas metodës së kombinuar (sipas veshitimitimit dhe tekstit notal);
- 

Përforcojmë njohuritë e mëparshme, bëjmë ushtrime për këndimin e drejtë dhe të bukur;

Loja në instrumente gjen zbatim edhe në këtë nivel. Krijimi Kjo veprimtari mësimore përfshin dëgjimin si inspirim për shprehje kreative me mjete të arteve të tjera, riinterpretimin e përmbajtjeve të mësuara dhe krijimin e tërësive të reja muzikore. Në mënyrë të lirë nxënësit shprehin idetë e tyre muzikore dhe përmes interpretimit njëherësh socializohen dhe vlerësojnë arritjet e tyre.

Tërheqja e nxënësve në veprimtaritë muzikore dhe integrimi i muzikës me lëndë të tjera, sigurisht, kërkon realizimin e objektivave dhe të kompetencave jo vetëm në muzikë, por edhe nga lëndë të tjera. Kjo është një mënyrë efektive e të mësuarit dhe një nga parimet më të rëndësishme që ka kurrikula e edukimit muzikor. Temat e integruara kanë një motivim dhe kënaqësi të lartë për nxënësit. Ndërthurja e linjave me njëra - tjetrën apo e njohurive në lëndë të ndryshme brenda një niveli, ndihmon në përforcimin më të mirë të njohurive të nxënësit dhe i bën veprimtaritë e kësaj lënde të këndshme dhe të dashura.

### **2.3.3.Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare**

Muzika është e lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Melodia, ritmi, harmonia, dinamika, tempio, forma, historia etj.,lidhen shumë mirë me lëndët e tjera artistike, brenda fushës, por disa koncepte studiohen në disa fusha të tjera në kontekstin e objektit të studimit që ata kanë, si: matematika, gjuha dhe komunikimi, shkencat shoqërore dhe natyrore, edukimi fizik, sporti dhe shëndeti, TIK-u.

Kështu që në arsimin fillor, mësuesit përmes mësimit të shumë përmbajtjeve mësimore, duhet t'u japin mundësinë fëmijëve/nxënësve të konsolidojnë përvojat që ata kanë krijuar dhe që i sjellin në klasë, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave.

Gjatë studimit të fenomeneve dhe dukurive muzikore, nxënësit duhet të zhvillojnë kompetencën e komunikimit dhe të përdorin drejt gjuhën dhe terminologjinë artistike. Nëse nxënësit shprehin rrjedhshëm mendimet e tyre rreth informacioneve muzikore në veçanti



dhe atyre artistike në përgjithësi, ata zhvillojnë saktë kompetencën e komunikimit të gjuhës. Por njëkohësisht edhe lëndët brenda fushës së arteve kontribuojnë në zgjerimin dhe përpunimin e fjalorit artistik të nxënësve duke i nxitur ata të parashtrajnë qartë dhe saktësisht idetë e tyre përmes komunikimit apo përmes diskutimeve mbi përshkrimin e punëve krijuese dhe shpjegimit të rezultateve të tyre e krijuar një fjalor artistik.

Studimi i muzikës lidhet me fushën e shkencave shoqërore, pasi nëpërmjet saj nxënësit marrin informacion mbi historitë e zhvillimit të arteve në periudha të caktuara historike në

vende, kontekste dhe kultura të ndryshme. Duke hedhur vështrimin nga e

kaluara historike mund të marrin përgjigje si ka evoluar muzika. Kështu nëse nxënësit bëjnë kërkime dhe prezantojnë informacionet muzikore qartë, ata zhvillojnë kompetencën e komunikimit, digjitale, personale etj. Fusha e arteve lidhet me fushën e shkencave natyrore, pasi disa teknika specifike të fushës së arteve zbatohen nëse njihen mirë ligjet e fushës së shkencave .P.sh. për të kryer lëvizjet e trupit një kërcimtar mund të arrijë performancën më të lartë, nëse njeh mirë ligjet e dinamikës. Por njëkohësisht duke shfrytëzuar programet e arteve pamore nxënësi bëhet njohës i mirë i figurave dhe trupave gjeometrikë në hapësirë dhe plan.

Tik-u mbështet kërkimin e mjaft proceseve në fushën e arteve dhe lehtëson bashkëpunimin e nxënësve me njëri-tjetrin. Për shembull, nëpërmjet përdorimit të Tik-ut nxënësit diskutojnë dhe ndajnë idetë e tyre mes njëri –tjetrit. Nxënësit mund të zbulojnë dhe vizualizojnë

koncepte të ndryshme të fushës së arteve duke përdorur mjete për të ndryshuar për prezantimin e tyre <sup>1</sup>

#### **2.3.4.Integrimi i muzikës me lëndë të fushave të tjera**

Disa aspekte të shprehjes dhe imagjinatës nga fusha të tjera të arteve, lidhen edhe me muzikën. P.sh. koncepti i ritmit (harmonia) apo i formës në artin figurativ mund të ilustruhet edhe në muzikë. Zhvillimi i një skeme personale, i një sistemi që prezanton botën në pikturë dhe simbolet në artin figurativ lidhet edhe me simbolet grafike në muzikë (p.sh. regjistrimet grafike të tingujve apo melodisë së një kënge). Muzika mund të transmetojë ose të përçojë imazhe të ndryshme nga nxënës të ndryshëm, duke ilustruar ose krijuar imazhet apo krijimet e tyre në linjën SHKM ose DM. Tematika e programit në edukimin muzikor, veçanërisht në linjën SHKM, mund të realizohet jo vetëm përmes edukimit figurativ, por edhe përmes disa lëndëve të tjera siç janë: vallëzimi, drama, edukimi fizik etj. Kështu, edukimi fizik mund të realizohet edhe përmes vendosjes së një muzike të njohur popullore

apo të muzikës bashkëkohore.

Muzika integrohet lehtë me lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, si gjuha amtare dhe gjuhët e huaja. Në të gjitha nivelet kurrikula e edukimit muzikor, ka si qëllim që nxënësit të dëgjojnë dhe t’i përgjigjen muzikës në rrugë të ndryshme. Këngët sigurojnë te nxënësit një të kënduar të rrjedhshëm dhe të saktë të tyre. Gjithashtu ato kërkojnë të zhvillojnë më tej gjuhën amtare që ata mësojnë çdo ditë. Gjatë mësimit të këngëve apo njohurive muzikore BAM, nxënësit njihen dhe ushtrojnë konceptet: theksi në gjuhën e folur dhe muzikë ose

---

<sup>1</sup> Kurrikula e Bazuar në Kompetenca, IZHA, Tiranë 2016

koha e theksuar, e pa theksuar. Këto mund të demonstrohen pasi një këngë është mësuar shumë mirë, duke u kërkuar nxënësve të gjejnë fjalë 2- rrokëshe, 3 – rrokëshe dhe 4rrokëshe. Duke gjetur këto fjalë nxënësit mësojnë të vënë theksin aty ku duhet. Gjithashtu ata mësojnë të këndojnë me një diksion të qartë , që do të thotë të dinë të këndojnë pastër fjalët gjatë këndimit.

Integrimi i muzikës me shkencat e natyrës realizohet përmes disa temave ndërlendore: si harmonia, dinamika dhe valët. Integrimi i muzikës me shkencat shoqërore arrihet përmes disa temave ndërlendore si: kultura, identiteti kombëtar, trashëgimia kulturore dhe kostumet. Me lëndët e fushës së matematikës, ky integrim ndërlëndor arrihet përmes temave të tilla, si thyesat dhe intervalet, të cilat trajtohen gjerësisht qoftë në matematikë, qoftë në muzikë.

#### *2.3.5.Lidhja e muzikës me fusha të tjera*

Muzika është një ndër fushat që, në pamje të parë, duket sikur nuk ka shumë lidhje me fushat e tjera të jetës. Por në kohë dhe vende të ndryshme kanë gjeneruar ide të veçanta për sa i përket estetikës së muzikës, të cilat, për rëndësinë e tyre krijuese, mund të quhen “ide gjenerative”. Po përmendim pesë nga këto ide të cilat mund të konsiderohen si me mjaft ndikim, mbi atë se çfarë mund të kuptohet me ide gjenerative. Ato janë:

- Muzika si matematikë.
- Muzika si imitim.
- Muzika si shprehje.
- Muzika si gjuhë.

- Muzika si strukturë formale (Tole, 1997: 45)

Pra, muzika nuk mund të konsiderohet e shkëputur nga fushat e tjera të jetës. Të shumtë kanë qenë studiuesit që kanë hulumtuar rreth ndërlidhjes së aftësisë muzikore me aftësitë e tjetra të njeriut. Studimet kanë treguar se muzika ka lidhje me gjuhën, letërsinë, matematikën, artet, historinë, gjeografinë, sportet etj.

### **Lidhja e muzikës me gjuhën dhe letërsinë**

Gjuha dhe muzika janë dy mënyra që përdorin njerëzit për të komunikuar dhe shprehur mendimet të tingullit.

Muzika dhe gjuha kanë të përbashkëta ndërmjet tyre. Ato përbëhen nga tingujt dhe për të komunikuar përdorin ritmin, tonin, theksin dhe pauzat. Brandt et al. (2012: 5) e cilëson muzikën me një status të privilegjuar që na mundëson të fitojmë jo vetëm muzikën e kulturës sonë amtare, por gjithashtu na mundëson që të mësojmë gjuhën tonë amtare". Qoftë muzika, qoftë gjuha, janë të bazuara në informacione akustike, që përfshijnë një numër të kufizuar të elementeve ose klasave kategorike (foneme dhe tonet) që janë të organizuara në sekuenca të strukturuar sipas rregullsive specifike.

Koelsch (2011: 16) shkon deri aty sa ngre hipotezën se "truri i njeriut, veçanërisht në moshë të hershme, nuk trajton gjuhën dhe muzikën si fusha rreptësisht të ndara, por më tepër trajton gjuhën si një rast special të muzikës".

Pa aftësinë për të dëgjuar muzikë, ne s'mund të jemi të aftë të mësojmë gjuhën. Lidhja ndërmjet muzikës dhe gjuhës sipas studiuesve, duket që në ditët e para të jetës së njeriut.

Aftësitë melodike janë të rëndësishme për zhvillimin e gjuhës. Këto aftësi fillojnë që nga thirrjet e foshnjave: kompleksiteti melodik i të qarës që vjen në rritje gjatë muajve të parë të jetës. Foshnjat që nuk shfaqin kompleksitet melodik në rritje, shfaqin një performancë më të varfër gjuhësore pas dy viteve, kur fëmija fillon të flasë. (Erenke & Mende, 2000)

Andon (1990: 170) zbuloi se kur hemisfera e majtë dhe hemisfera e djathtë aktivizohen në të njëjtën kohë për një veprimtari të caktuar, krijohet një rrethanë ideale e të mësuarit dhe mësimi është më produktiv. Përdorimi i aftësive joverbale të anës së djathtë të trurit, si veprimet, emocionet dhe muzika ndihmon në përmirësimin e krijimtarisë, të kujtesës dhe të aftësisë për të imituar, e cila konsiderohet si një nga strategjitë më të dobishme në mësimin e gjuhëve.

Kërkimet e zhvillimit të fëmijës duket se tregojnë se trajnimi muzikal është e vetmja metodë që përmirëson aftësitë intelektuale, gjuhësore dhe emocionale tek fëmijët. Ata sugjerojnë se trajnimi në muzikë ka aftësinë për të rritur IQ në fjalor dhe u jep fëmijëve një sens më të mirë të gramatikës.

Muzika ka qenë gjithmonë një mënyrë për fëmijët për të kujtuar histori dhe për të mësuar rreth botës së tyre. Përdorimi i muzikës si një stimul mund të ndikojë në emocionet e dikujt dhe të lehtësojë rikujtimin e informacionit. Muzika gjithashtu krijon një ambient favorizues për të mësuar. Mund të ulë stresin, të rrisë interesin dhe të vendosë skenën për të dëgjuar dhe për të mësuar. Ngjashmëritë midis përvetësimit të shkrim-leximit dhe zhvillimi muzikor janë të shumta. Prandaj, mësimdhënia që kombinon muzikën me mësimin e artit gjuhësor mund të jetë më efektive (Davies, 2000).

Njerëzit që studiojnë muzikë para moshës 7 – vjeçare kanë një avantazh afatgjatë kur vjen puna tek shqiptimi. Kjo do të thotë se përgjatë jetës së tyre ata mund të jenë më të shpejtë në mësimin e një gjuhe të dytë në krahasim me njerëzit e tjerë, të cilët nuk e kanë pasur këtë lloj stimulimi në moshë të hershme. Mendohet se arsyeja e këtij efekti është se lidhjet nervore që kanë të bëjnë me muzikën dhe gjuhën mund të përkojnë.

Inteligjenca muzikore ka trajektoren e saj të zhvillimit dhe neuromekanizmat e saj, ndaj dhe nuk mund të “gllabërohet” aq lehtë nga inteligjenca linguistike si thjesht një shfaqje tjetër e saj. Pra, jo të gjitha aspektet e gjuhës mund të gjejnë analogen e tyre në muzikë; p.sh, aspekti semantik i gjuhës është tepër i pazhvilluar në muzikë dhe nocioni i rregullave strikte gramatikore është paksa i huaj për muzikën për të mos thënë që “thyerja” e tyre vlerësohet. (Gardner, 2003, 162)

Veprat e artit duke qenë produkte të mendjes dhe shpirtit njerëzor, veç të tjerash kanë padyshim edhe një lidhje të veçantë të të dhënave natyrore të njeriut me to. Letërsia dhe muzika strukturohen në një formë më të dukshme për veshin sesa për çfarëdo organi tjetër duke u quajtur Arte të të dëgjuarit. Përmes këngëve nxënësit njohin krijimet poetike për fëmijë dhe përforcojnë konceptet nga gjuha amtare. Në përmbajtjet tekstuale dhe muzikën programore përfshihen situata të ndryshme jetësore (njohja e mjedisit).

Marrëdhëniet e para të muzikës me letërsinë kanë qenë të ndërsjella më pas ato u shndërruan në forma të ndryshme komunikimi. Mes letërsisë dhe muzikës, ka pika të përbashkëta si p.sh: marrëdhëniet e tyre me kohën, aspekti tingëllues, intonativo-fonetik të fjalës etj. Ashtu

si perceptojmë muzikën e ekzekutuar, ashtu perceptojmë edhe tingujt e artikuluar të fjalës ose germat e saj.

Muzika dhe letërsia nuk mund të zëvendësojnë njëra tjetrën, pasi poezia nuk priret drejt muzikës, kurse muzika nuk ka nevojë për fjalë. Shkrimtarët dhe kompozitorët gjithmonë e kanë gjetur një gjuhë të përbashkët dhe kanë qenë shumë të lidhur me njëri - tjetrin. Tek poeti-muzikant konstatojmë të njëjtin procedim teknik mbi unitetin e të dy gjuhëve: gjuhës së fjalëve dhe asaj të tingujve.

Muzika mund të dëgjohet edhe vetëm si vijë melodike por kur asaj i shtohet teksti bëhet më e kompletuar. Për shumë njerëz mësimi i gjuhëve të ndryshme arrihet shumë më lehtë me anë të muzikës.

Gjatë dëgjimit të ndonjë veprë muzikore nxënësit janë më të priur për të shkruar ndonjë poezi, tregim apo shkrime letrare. Në vazhdim do paraqes një këngë ku përmes këngës arrihet deri tek mësimi i gjuhës angleze. **Shembulli:**

Alphabet Song  
Tin Whistle Sheet Music

Now I've said my A B C Tell me what you think of me

Martin Dardis Tin Whistle Music

2

## Figura 2. Ndërlidhja e muzikës me letërsinë - poezinë

Ndërlidhja e muzikës me letërsinë është e hershme. Këtë lidhje shohim më shumë mes muzikës dhe poezisë, si një nga format e gjinisë letrare lirike, pasi "...vendosja e poezisë në funksion të melodisë, tregon faktin e gërshetimit dhe korrelacionit të dy arteve, përshtatjen e artit të poezisë në horizontalen e modelimit (sepse muzika është modelim i tingujve në një situatë të caktuar, qoftë kjo situatë edhe pa ndonjë lidhje apo pa ndonjë efekt që e presim) për të dhënë mundësinë e shpërthimit emocional në aspekt të fuqizimit dhe energjisë së shprehur...".

Poezia gjithashtu përparon brenda ligjësisë të masës dhe më shumë se me prozën ajo ngjan me muzikën sepse i bashkon një gjenezë e përbashkët e kërkimit të një impulsi psikik

joracional dhe jo kartezi.

2

[https://www.google.com/search?q=abc+notes+song&bië=1242&bih=606&tbm=isch&imgil=30CioHmE957y - M%](https://www.google.com/search?q=abc+notes+song&bië=1242&bih=606&tbm=isch&imgil=30CioHmE957y - M%2F)

Shkrimtari i vërtetë është një ndërtues i cili njih ose mund të njohë rrugën që kalon sa përmes vlerës së fjalëve, po aq edhe të masës dhe përpeshimit të brendshëm, e ngjashme me krijimin e një shembulli nga realiteti. Këta mund të jenë faktorë që shpjegojnë se pse shkrimtarët dhe kompozitorët gjatë gjithë kohëve kanë qenë të lidhur me njëri-tjetrin.



Edhe pse muzika, letërsia – poezia janë të pavarura, kanë një fushë të gjerë të analogjive formale dhe esenciale. Gjatë zhvillimit të tyre historik, këto arte kanë qenë bazë e bashkëveprimit në fushën e muzikës vokale, formave vokale – instrumentale dhe të artit skenik, si opera, opereta, melodrama, pjesë në këndim etj.

Në të kaluarën dhe në ditët e sotme, muzika është shfaqur me lloje të tjera artesh, posaçërisht me poezinë, ndaj edhe janë bërë përpjekje për të paraqitur diçka, për të shprehur apo edhe për të kërkuar diçka. Kështu që muzika edhe mund të ndihmojë, por edhe të jetë e ndihmuar nga poezia.

Një studim tjetër është ai i Vincent Katz dhe Tim Peterson, ku jepen sqarime për lidhjen e muzikës me poezinë. Ky diskutim u zhvillua në Shkollën e Arteve Pamore, New York, 17 mars, 2011.

Çfarë është muzika? Muzika është tinguj dhe ritme, tinguj dhe sekuenca, tinguj dhe fraza të tilla si duke folur...!

Përsëritjet, regjistrat e ndryshëm, timbri, harmonia, kontrapunkti, forma në shkallë të gjerë, motive. Të gjitha këto i gjejmë edhe në poezi, edhe në muzikë. Siç dihet, ka pasur një lidhje të gjatë përgjatë historisë mes poezisë dhe muzikës. Shumë poezi janë kryer në këngë.

Tekstet hyjnë në: balada, oda, kushtet e tjera që ne i përdorim për poezi që vijnë nga kënga. Gjithashtu jemi duke folur edhe për format muzikore, kështu që këtu janë vetëm disa: kanon, motet, këngë, sonata, janë elemente të muzikës dhe këto mund të jenë të dobishme kur flasim për mënyrat e të folurit. Një hyrje, një temë, një zhvillim, një kulm, një përfundim, ose një coda, por edhe përbërja nga fraza. Pra, lidhja e muzikës me letërsinë e në veçanti me poezinë është

shembulli më i mirë që na bënë të kujtojmë se nga koha e hershme, madje, mendohet se edhe prej kohës kur njeriu ka ditur të flasë, ai ka krijuar melodi dhe ka kënduar, gjë të cilat i ka bërë në mënyrë reciproke gjatë zhvillimit jetësor.

Marrëdhëniet e para të muzikës me letërsinë kanë qenë të ndërsjella. Më pas ato u shndërruan në forma të ndryshme komunikimi. Fjala ka domethënie të caktuar, ajo ngërthen në vete “ idenë”, krahasuar me tingullin i cili është fenomen akustik por njëkohësisht estetik, mirëpo si i tillë nuk ka domethënie krejtësisht të përcaktuar si fjala. Fjala në letërsi sajton një vepër, që më vonë mund të quhet roman apo edhe ndonjë gjini tjetër letrare, ashtu edhe tingulli si element themelor i muzikës, është atom në formimin e një përmbajtjeje specifike të re muzikore.

Letërsia dhe muzika strukturohen në një formë më të perceptueshme për veshin sesa për çfarëdo organi tjetër duke u quajtur “...arte të të dëgjuemit”. Të klasifikuara në grupimin e arteve kohore – kinetike, sot mes letërsisë dhe muzikës shikohen ende pika të përbashkëta si për sa u përket marrëdhënieve të tyre me kohën, ashtu edhe aspektit tingëllues, intonativo – fonetik të fjalës. (V. Tole, 1997: 7)

Lidhjet e poezisë me muzikën shfaqen edhe në të gjitha gjinitë muzikore, si ato vokale po ashtu edhe tek ato vokalo-instrumentale. P.sh Tek opera bëhet gërshetimi i të gjitha arteve

(skena, baleti, koreografia, regjia, orkestra, solistët, kori, dramaturgjia), por lidhja kryesore e muzikës është tek poezia (meqë teksti në këtë gjini është i kënduar dhe i recituar, varësisht ideja e kompozitorit). Ariet janë pjesë vokale të operave me bazë melodinë të mbështetur në libret të ndonjë shkrimtari me famë botërore apo edhe të epokës kur ai ka jetuar. Ky libret (i cili është shkruar në formë të dramës, poezisë, prozës apo edhe i bërë enkas për veprën në fjalë), është pjesë përbërëse e veprave muzikore, ku paraqet bazën letrare të dramës muzikore, pra të operës. Pra, muzika është art i shprehur përmes tingujve (tingujt janë mjete shprehëse muzikore - abstrakte për t'u kuptuar), për dallim prej fjalëve që janë mjet komunikimi në mes të njerëzve qysh në kohët e lashta e deri në ditët e sotme.

Përveç ndërlidhjes së edukimit muzikor me gjuhën amtare, muzika gjithashtu ka lidhje edhe me gjuhët e huaja dhe është e një rëndësie të veçantë në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhëve të huaja.

Pedagogët e gjuhëve të huaja aplikojnë këngë, të cilat ndihmojnë mësimin e gjuhëve të ndryshme ngase fjalët e huaja përmes këngës mbahen mend më lehtë. Me këtë rast bashkëveprohet në dy sfera njëkohësisht: në sferën njohëse kuptimore dhe emocionale.

**Shembull:** mësimi i alfabetit dhe një teksti anglisht.

### The ABC

The musical score for "The ABC" is presented in two staves. The top staff is a vocal line in G major (one flat) and 2/4 time, with lyrics: "A B C D E F G H I J K L M N O P Let - ters twen - ty six in all, back - wards now we'll sing - them all." The bottom staff is a piano accompaniment in the same key and time, consisting of chords and a simple bass line.

Si mund të ndërlidhen këto shprehje artistike në procesin mësimor?

Muzika e dëgjuar mund t'i nxitë nxënësit me prirje letrare të hartojnë ndonjë përmbajtje letrare, në formë tregimi apo poezie. Shkrimtarët dhe kompozitorët gjithmonë e kanë gjetur një gjuhë të përbashkët dhe kanë ndërlidhur veprimtarinë e tyre me njëra tjetrën.

Në orët mësimore të leximit, ku zbatohet integrimi ndërlëndor, muzika e dëgjuar, e luajtur ose e kënduar nga nxënësit, është një element jo vetëm relaksues, por edhe ndërlidhës

ndërmjet njohurive ndërlëndore. Për veprimtari mësimore që kërkojnë krijimin artistik nga nxënësit të një poezie ose të një krijimi artistik në prozë, muzika shërben si burim frymëzimi për nxënësit.

Modeli i një përgatitje ditore nga mësuesi për një orë integruese ndërlëndore në lëndën e leximit.

Klasa: V

Lënda: Lexim

Tema mësimore: Ku është pranvera?

Objektivat e përgjithshëm:

- Edukimi i kulturës për të lexuar.
- Kultivimi i atdhedashurisë të nxënësit.

Objektivat specifikë: Në fund të orës së mësimit nxënësit:

- Të lexojnë në mënyrë shprehëse – emocionale poezinë.
- Të zbërthejnë kuptimin e vargjeve të poezisë.
- Të bëjnë një përshkrim të pranverës.

Metodologjia: Stuhi mendimi, lexim shprehës – emocional, punë e pavarur, diskutim

Mjetet e duhura: Teksti “Leximi 5”, CD me melodi muzikore

Fjalët kyçe: pranvera, dielli, dëbora, parqe, dallëndyshe

Zhvillimi i mësimi

Evokimi (Stuhi mendimi)

Punë parapërgatitore: Në sfond, në klasë, përgjatë gjithë orës së mësimi vihet për të shoqëruar orën e mësimi muzika “4 stinët”, nga Vivaldi.<sup>2</sup>

Flasim për pranverën

- Ju pëlqen pranvera?
- Ç’karakteristika ka stina e pranverës?

Realizimi

Prezantimi i temës së re të mësimi.

Leximi shprehës – emocional i poezisë nga mësuesja dhe 2-3 nxënës të përzgjedhur të klasës.

Diskutim rreth të kuptuarit e tekstit, duke punuar edhe pyetjet e aparatit pedagogjik të

---

<sup>2</sup> <https://youtu.be/5Eaxcioiy2ë>

tekstit.

- Çfarë kërkojnë vogëlushët?
- Çfarë bën dielli kur dëgjon pyetjet e tyre?
- Nga e kërkojnë fëmijët pranverën?
- Si e thërrasin në fund fëmijët pranverën dhe si u vjen ajo?

Reflektimi

Punë e pavarur: Përshkruani ardhjen e pranverës në vendlindjen tuaj. Ndërkohë, në sfond dëgjohet muzika klasike “4 stinët” nga Vivaldi.

Punë e drejtuar: Leximi i punës së pavarur nga nxënësit. Diskutohet nga nxënësit rreth punës së njëri – tjetrit.

Konkluzioni i orës së mësimit.

### **Ndërlidhja e lëndës muzikore me gjuhën angleze**

Përveç ndërlidhjes së edukimit muzikor me gjuhën amtare ajo po ashtu ka të bëjë edhe me gjuhët e huaja dhe është e një rëndësie të veçantë në procesin edukativ arsimor.

Pedagogët e gjuhëve të huaja aplikojnë këngë, të cilat ndihmojnë mësimin e gjuhëve të ndryshme ngase fjalët e huaja përmes këngës mbahen mend më lehtë. Me këtë rast bashkëveprohet në dy sfera njëkohësisht: në sferën njohëse kuptimore dhe emocionale.

**Shembull:** mësimi i alfabetit dhe një teksti anglisht.

### The ABC

A B C D E F G H I J K L M N O P  
Let - ters twen - ty six in all, back - wards now we'll sing - them all.

Në “The music in poetry” jepen disa shembuj shumë të kapshëm për fëmijët në lidhjen e muzikës me poezinë. Sipas këtij studimi, poezia ndihmon shumë në muzikë, sepse secila vepër muzikore punohet në fraza, kështu që edhe vargjet në poezi punohen pjesë-pjesë, në fraza, për të qenë sa më afër asaj që mendohet të shprehet dhe thuhet me fjalë në poezi, ndërsa në muzikë shprehet me tinguj si shembulli në vijim:

The *iamb's* tread across a line  
Can sound a bit like yours or mine  
☺ / ☺ / ☺ / ☺ /  
If we went stomping through a room  
In just one shoe: *ba-BOOM, ba-BOOM.*

4

Muzika dhe poezia në gjuhën angleze

(Këtu është paraqitur një poezi në gjuhën angleze, ku, në bazë të shenjave, janë paraqitur edhe pjesët e theksuara dhe të patheksuara në vargje – element që lidhet direkt me masat në muzikë).

<sup>4</sup> [http://www.smithsonianeducation.org/publications/siycëinter\\_06.pdf](http://www.smithsonianeducation.org/publications/siycëinter_06.pdf)

### **Lidhja e muzikës me matematikën e fizikën**

*"Nëse unë nuk do të isha një fizikant, unë ndoshta do të bëhesha muzikant. Unë shpesh mendoj në muzikë. Unë i jetoj ëndrrat e mia në muzikë. Unë e shoh jetën time në terma të muzikës"*

Albert Einstein

Në jetën e përditshme duket sikur nuk ka pikëtakime ndërmjet muzikës dhe matematikës apo muzikës dhe fizikës, nisur dhe ka natyra që secila lëndë ka dhe nga roli që luan secila prej tyre në shoqëri.

Matematika dallohet nga abstraksioni, përfaqësuar nga gjuha e numrave. Por, matematika nuk ka të bëjë vetëm me numrat, aritmetikën, algjebren, analizën, llogaritjet. Thelbi i matematikës janë strukturat, konceptet mbi strukturat, teoria e formës, forma e të menduarit dhe përgjithësimi i tyre.



Matematika nuk ka të bëjë vetëm me formula, simbole dhe ekuacione por edhe me ide, ka të bëjë me të menduarit dhe të kuptuarit të saj. Matematika ka të bëjë me modelin dhe strukturën; ka të bëjë me analizën logjike, me të menduarit dhe njehsimin me këto metoda dhe struktura.

- Matematika është gjuhë universale.
- Matematika përdoret në art dhe muzikë.
  
- Matematika është logjike; ajo i ndihmon njerëzit të zgjidhin problemet në mënyrë sistematike.
  
- Matematika është objektive (reale); nuk ka fusha të përhime (gri). Për shembull,  $1+1=2$  ose është deklarim i saktë ose i pasaktë por jo kombinim i tyre. -Matematika është e nevojshme në studimin e shkencave natyrore, si fizika dhe kimia. A mund të imagjinohet një kimist apo fizikan që të mos dijë dallimin në mes të dhe . -Studimi i matematikës është i nevojshëm për t'u bërë inxhinier. Paramendo ndërtimin e një ure pa dije nga matematika.
  
- Ekonomistët dhe agjentët e bursave i dinë disa gjëra nga matematika shumë mirë. (Q. Gjonbalaj)<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> [https://www.researchgate.net/profile/Qefsere\\_Doko\\_Gjonbalaj/publication/258848188\\_Si\\_të\\_rrisim\\_inter\\_esin\\_dhe\\_suksesin\\_e\\_studenteve\\_ne\\_lendet\\_matematike/links/00b7d5293d86dae3ba000000/si-te-rrisiminteresin-dhe-suksesin-e-studenteve-ne-lendet-matematike.pdf](https://www.researchgate.net/profile/Qefsere_Doko_Gjonbalaj/publication/258848188_Si_të_rrisim_inter_esin_dhe_suksesin_e_studenteve_ne_lendet_matematike/links/00b7d5293d86dae3ba000000/si-te-rrisiminteresin-dhe-suksesin-e-studenteve-ne-lendet-matematike.pdf)

Në “Dimensionet e mendjes”, Hoëard Gardner (2003), thekson se ka pasur një interes të vazhdueshëm ndër shekuj nga studiuesit për sa i përket lidhjes së muzikës dhe matematikës. Që nga koha e klasikëve, që nga zbulimet e Pitagorës, lidhja midis muzikës dhe matematikës ka tërhequr vëmendjen e shumë mendimtarëve. Në mesjetë, studimi i detajuar i muzikës kishte shumë të përbashkëta me aplikimin e matematikës, si p.sh, një interes në proporcionet, raporte të veçanta, ripërsëritje formash dhe seri të tjera.

Disa hulumtime kanë dëshmuar se fëmijët duke luajtur në piano shpesh, tregojnë aftësi të përmirësuar në shkenca të aplikuara, në zgjidhjen e problemeve (enigmave), duke luajtur shah apo kryerjen e veprimeve matematikore<sup>4</sup>. Së dyti, në një analizë të veçantë krahasuese nxënësi duke marrë një kurs muzike tregoi rezultate më të mira rreth 11% mbi mesataren në mësim. Të gjitha këto studime mbi raportet “harmonike” dhe proporcionet ishin thelb i muzikës gjatë etapës Pitagoreane.

Një ndarje e një linje kreative dhe imagjinare në dy pjesë të pabarabarta quhet mesi i artë. Kjo përqindje nuk mund të gjendet vetëm në forma gjeometrike por edhe në natyrë.

Një tjetër hulumtim ka treguar se Moxarti në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme ka aplikuar harmoninë mes zhvillimit dhe përmbledhjes në pothuajse të gjitha sonatat për piano. Ai e ka aplikuar këtë seksion (mes) të artë edhe pse disa prova tregojnë tërheqjen e tij nga matematika dhe reflektojnë mbi një aspekt artistik gjeometrik.

---

<sup>4</sup> <http://documents.tips/documents/lidhja-e-matematikes-me-lendet-e-tjera.html>

Muzika është ART ndërsa Matematika ka shumë nga karakteristikat e një arti të identifikuar me periudha artistike (barok, klasik, renesancë etj.), kjo dhe çfarëdo lidhje tjetër që ekziston në mes të muzikës dhe matematikës, mund të themi se edhe pse kanë shumë të përbashkëta, të dyjat pa dyshim janë disiplina shumë të ndryshme.




Fig. 3 Ndërlidhja muzikë - matematikë

Nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë deri në shekullin e njëzetë, diskutimet mbi natyrën matematikore të muzikës ishin më të rralla. Në shekullin e njëzetë, së pari, me rastin e muzikës dymbëdhjetë tonëshe, dhe, së dyti, përdorimit të gjerë të kompjuterëve, lidhja midis matematikës dhe muzikës ka tërhequr edhe një herë vëmendjen. (Gardner, 2003: 163)

Sipas Gardner, për të kuptuar plotësisht funksionimin e ritmit në një pjesë muzikore, individi duhet të ketë disa aftësi numerike. Disa pjesë muzikore kërkojnë një ndjeshmëri ndaj rregullsisë dhe raporteve, edhe pse kjo ka të bëjë me të menduarit matematik në një nivel shumë të thjeshtë. Në rastin kur kemi të bëjmë me të kuptuarit e strukturave muzikore dhe mënyrën se si ato përsëriten, transformohen, përfshihen ose vendosen përkrah njëra – tjetrës, atëherë nevojiten disa aftësi më të avancuara matematike, megjithatë Stravinski deklaroi se “muzika dhe matematika nuk janë njësoj”. (Gardner, 2003: 163 - 164)

Pavarësisht se ndërmjet muzikës dhe matematikës gjenden shumë pikëtakime, shumë janë munduar gjatë shekujve që të shoqërojnë muzikën me matematikën për të theksuar nacionalitetin (ose për t’i mohuar fuqinë emocionale) muzikës. Megjithatë, është e pamohueshme që muzika ka një ndikim emocional. (Gardner, 2003: 142)

Ekzistojnë mundësi të shumta ndërlidhjesh midis disiplinave shkencore dhe arteve, ku fizika u jep muzikantëve instrumente me mundësi edhe më të reja, si muzikë elektronike etj. Gjatë shekullit të XX-të, teknologjia u zhvillua me ritme të shpejta, duke sjellë mundësi aparatesh incizuese – riprodhuese, siç është fonografi etj.

Për sa i përket literaturës studimore vërehet një zhvillim i theksuar duke përmendur fizikantin anglez, Aleksandër Gjon Elis, i cili shkroi librin studimor “Për shkallët muzikore të popujve të ndryshëm”. Gjithashtu, është i njohur edhe “cent sistemi” i Eliesit. Shumë dukuri muzikore shpjegohen me metodologji hulumtuese studimore të shkencës së Etnografisë dhe Muzikologjisë.

Ngjashmërinë më të madhe në mes të muzikës dhe fizikës e hasim më shumë tek instrumentet, ndërtimi i tyre dhe mënyra se si ato lëshojnë tingullin, bie fjala flauti është në thelb një tub që është i hapur në të dyja anët. Ajri është në lëvizje nga fillimi gjerë në fund dhe kështu krijojnë një ton në bazë të vullnetit dhe dëshirës. Kjo është nga aspekti teknik i ndërtimit dhe ekzekutimit të instrumenteve. Muzika dhe Fizika, sado që kanë terminologji bukur të ngjashme ato plotësisht janë të ndryshme.

$$\frac{a+\beta}{a} = \frac{a}{\beta} = \varphi$$

$$\varphi = \frac{1+\sqrt{5}}{2} = 1.6180339\dots$$

Fig. 4 Ndërlidhja e muzikës me fizikën

Ndërlidhjen ndërmjet muzikës dhe fizikës e shohim edhe në këndvështrimin që kanë fizikanët për muzikën. I pyetur a mund ta përkufizojë muzikën shkencërisht në një fjali të vetme, fizikani i madh Albert Ajnshtajn është shprehur se “muzika është një mori vibracionesh” dhe “ gjëja më e bukur që ne mund të përjetojmë është misterioze. Muzika është burim i artit të vërtetë dhe i të gjitha shkencave”.

## **Lidhja e muzikës me historinë**

Marrëdhëniet e muzikës me artet e tjera i gjejmë qysh në antikitet, kurse elementet e veprimtarive të gërshetuara edhe më parë, ku magjistari mund të paramendohej edhe si një lloj paramësuesi i muzikës, i cili edhe me magjinë e tij kishte një ndikim jashtëzakonisht të madh për sa i përket muzikës, por edhe arteve të tjera, prandaj edhe nga kjo rezulton se ato marrëdhënie kanë vazhduar të gërshetuara në nivele të përparura sidomos në kohët e vona. Nëpërmjet arteve, duke përfshirë këtu muzikën, artet vizuale, vallëzimin, letërsinë e dramën, ne mësojmë për çdo periudhë historike.

Vlerat e artit muzikor kanë karakter shoqëror-historik, sepse arti muzikor pasqyron më së miri zhvillimin historik e shoqëror të njerëzimit. Në lëmin muzikor, janë të panumërta vepra muzikore që i kushtohen heronjve, ngjarjeve historike e shoqërore të një populli. Përmes veprave muzikore shohim të pasqyruar në kohë të gjithë dinamikën e jetës së një populli.

Përmes lëndës së edukimit muzikor në shkollë apo përmes sjelljes së shembujve ilustrues nga fusha e muzikës në orë të ndryshme lëndore, përmes veprave muzikore, nxënësit përjetojnë më thellë ngjarjet që kanë ndodhur përgjatë historisë, e ndiejnë më thellë heroizmin e popullit, himnizimin e virtyteve njerëzore. Përmes njohjes së elementeve muzikore, nxënësit do të mësojnë traditën e popullit të tij dhe tiparet e saj, si dhe traditat e popujve të tjerë. (Hala, 2002: 64)

Veprat muzikore që paraqesin figurat e heronjve dhe ngjarjet historike, shërbejnë si mjet motivues dhe emocional për njohjet në orën e historisë dhe të letërsisë. Njëkohësisht,

ngjarjet dhe figurat historike e shoqërore mund të bëhen shkas edhe për krijimtari muzikore me karakter historik e shoqëror.

Kjo marrë dhënie mes muzikës dhe historisë tregon ndikimin që këto kanë te njëra – tjetra. Më poshtë janë paraqitur vetëm disa nga shumë këngë të cilat tregojnë për lidhjen e muzikës me historinë. “Himni i Flamurit” është kompozuar nga kompozitori rumun Ciprian Pourmbesku, me tekst të autorit tonë të njohur Asdrenit. Kjo këngë u shpall Himn kombëtar në vitin 1912.

### Hymni Kombëtar

Rbeth fla- mu- rit të për- bash- kuar, Me një dës- hi- rë dhe një qël- lim. Të gji- thë a- tji duke lu be- tuar, të lid- him bes ën për shpë- tim. Prej luf- te veç ay lar- go- let, Që ësh- të lin- duri tra- dhë- tor. Kush ësh- të bur- rë nuk frik- so- het, Po vdes, po vdes si një dësh- mor. Prej mor.

Një tjetër shembull që flet për ngjarjet historike të një vendi është kënga "Lidhja e Prizrenit", shembull ky që na dëshmon lidhjen e muzikës me historinë, popullin dhe

ngjarjet e vendit.

Atëherë kur populli kishte një nevojë tjetër për çlirim e përkrahje u themelua edhe Lidhja e Prizrenit më 10 qershor 1878, formimi i lidhjes shqiptare, kishte karakterin kombëtar të së cilës e mbrojtën si patriotët radikalë ashtu dhe qarqet e moderuara.



### Kënga “ O Prizren”

Gjithashtu, përmes këngës “ Dëshmorët e pavarësisë”arrihet përjetimi i (muzikësmelodisë), këngës dhe përvetësimi i përmbajtjes tekstuale për dëshmorët e pavarësisë.

### Shembulli:



## Dëshmorët e pavarësisë

Drita Kryeziu

Madhërishtëm

Musical score for the song 'Dëshmorët e pavarësisë'. The score is written in 4/4 time and B-flat major. It consists of two staves. The first staff contains the first line of the melody with the lyrics: 'Ju dësh-mo - rët e Ko-so - vës lu - let e li - ris' U fli - ju - at,'. The second staff starts at measure 6 and contains two first endings. The first ending is marked '1.' and ends with a fermata over the note 'g'. The second ending is marked '2.' and ends with a fermata over the note 'sis'.

Ju dësh-mo - rët e Ko-so - vës lu - let e li - ris' U fli - ju - at,

6

1. g 2.

për kët' dit' di - tën e pa - var' - sis' di - tën e pa - var' - sis'.

### *Ju dëshmorët e Kosovës, lulet e liris'*

*U flijuat për kët' dit'*

*ditën e pavar' sis'*

Pra, për ta fuqizuar përjetimin dhe të kuptuarit të përmbajtjeve muzikore dhe të ngjarjeve historike e shoqërore, në mësimin e edukimit muzikor dhe mësimin e lëndëve të tjera, aplikohen në mënyrë të ndërsjellë njohuritë nga lënda e historisë dhe e edukimit shoqëror, si domosdoshmëri e vazhdimësisë së ndërlidhjes ndërlëndore të edukimit muzikor me

lëndët e tjera.

Modeli i një përgatitje ditore nga mësuesi për një orë integruese ndërlëndore në lëndën e historisë, klasa 5: Klasa: 5

Lënda: Histori

Tema: Lidhja Shqiptare e Prizrenit

Objektivat e orës së mësimi: Në fund të orës së mësimi, nxënësit të arrijnë që:

- Të tregojë kur u mbajt Lidhja Shqiptare e Prizrenit;
- Të identifikojnë qëllimet e formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; - Të nxjerrin  
ë pah shkaqet e shuarjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Metodologjia: Reflektimi, shpjegimi, punë e pavarur, diskutimi

Fjalët kyç: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, pavarësi, çlirim

Mjetet: Teksti “Historia 5”, CD me këngë për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit

Zhvillimi i mësimi

Evokimi

Në sfond vendoset kënga “Lidhja e Prizrenit”, koduar nga Marash Krasniqi.<sup>5</sup> Reflektojmë

rreth këngës:

- Ju pëlqeu kënga?
- Për çfarë flet kënga?

---

<sup>5</sup> <https://www.youtube.com/ëatch?v=-a9A-qxCtYQ>

## Realizimi

Prezantimi i temës së re të mësimit. Shpjegimi i çështjeve:

- Lufta për liri bashko të gjithë shqiptarët.
- Qëllimet e formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
- Shuarja e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

## Reflektimi

Duke vëzhguar foton e dhënë në fq. 57, bëni një shkrim të shkurtër me temë “Vizitë në Shtëpinë e Lidhjes shqiptare të Prizrenit”.

Leximi i punës së pavarur nga nxënësit.

Konluzioni i orës së mësimit.

## **Lidhja e muzikës me artet**

"Arti është veprimtari krijuese artistike, e shpikur nga njeriu, për dallim nga veprat e natyrës, që pasqyron ambientin që na rrethon nëpërmjet riprodhimit të realitetit". Bota e artit është një univers i vërtetë dhe ka një histori të gjatë, që nga kohët e lashta e deri në ditët e

sotme, dhe që përfshin në vete një larmi të madhe dukurish si: letërsia, arkitektura, muzika, teatri, filmi, skulptura, piktura etj.

Veprat e artit duke qenë produkte të mendjes dhe shpirtit njerëzor, përfshirë këtu sigurisht dhe muzikën, kanë një lidhje të veçantë të të dhënave natyrore të njeriut me to. Arkitektura, skulptura dhe artet vizive, paraqiten në përgjithësi si projekttime të strukturës në hapësirë pasi janë drejtpërdrejt në funksion të syrit njerëzor.

Sipas studiuesve (Hala, 2002: 60), artet i mundësojnë nxënësit të formojnë, kuptojnë dhe shprehin përvojat e tyre personale. Përmes marrjes së koncepteve themelore, përdorimit të teknikave apo burimeve të ndryshme artistike, nxënësit mësojnë të komunikojnë, të interpretojnë këto aftësi të marra. Gjithashtu, artet japin një kontribut të ndryshimit shoqëror dhe zhvillimit në të gjitha kulturat. Artet janë pjesë integrale e procesit të të mësuarit dhe kanë lidhje midis imagjinatës dhe inteligjencës. (Hala, 2002: 62)

Artet stimulojnë ndërgjegjësimin trupor, ushqejnë imagjinatën dhe kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit, ndihmojnë në krijimin dhe zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar nëpërmjet elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare si dhe në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve. Fusha e arteve ndihmon në krijimin e identitetit dhe në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve, mundëson zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, nëpërmjet trajtimit të elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare.

Artet (muzika, piktura, skulptura, baleti) nuk mund të jenë dhe as të përfytyrohen të shkëputura nga njëra – tjetra. Marrëdhënien e muzikës me pikturën e shpreh dhe Odhise Paskali, teksa shprehet “Vepra e artit figurativ mund të krahasohet me një koncert. Si koncerti, ajo duhet të ketë unitet kompozicional, harmoni, qendër emocionale, përmbajtje ideore”. (Tole, 1997: 85)

Në studimin "Music and Figurative Arts in the Twentieth Century", Opera Omnia Luigi Boccherini (Lucca) thotë se: "Marrëdhëniet mes muzikës dhe arteve figurative gjatë shekullit të njëzetë janë koduar në lidhjet që ekzistojnë mes kompozitorëve të ndryshëm dhe artistëve (të tillë si Schönberg dhe Kandinsky, Stravinski dhe Marino Marini apo

Picasso) dhe veçanërisht në përvojat personale të kompozitorëve Bussotti, Guaccero dhe Cage" <sup>6</sup>.

Në orën e edukimit figurativ, teksa nxënësit dëgjojnë një vepër muzikore, përshtypjet emocionale që marrin mund t'i nxisin ata për shprehje kreative për vizatim dhe anasjelltas. Trajnime të tilla asociative të përshtypjeve janë të njohura në krijimtarinë dhe pedagogjinë muzikore. Prirjet kreative në shkallë të ndryshme nuk duhet të jenë pengesë e punës së përbashkët dhe individuale të nxënësve. Përkundrazi, këto mund të jenë motivim dhe nxitje për punë më të frytshme.

Në aktivitetet e ndryshme muzikore – krijuese nxënësi mund të paraqitet si krijues, interpret dhe vlerësues i punës apo lojës së vet dhe kjo mund të merret si një ndërlidhje më vete të aktivitetit. Mbresat emocionale që i përjetojnë nxënësit duke dëgjuar një vepër muzikore,

---

<sup>6</sup> <http://www.luigiboccherini.org/figurativearts.html>

sidomos me karakter programor, mund të nxisin kreativitetin e tyre për të vizatuar dhe anasjelltas, tablotë figurative mund të zgjojnë imagjinatën për krijimtarinë e tyre muzikore.



“Vizatimi i muzikës” i nxënëses Tringa Salihu, ( kl. 5 – të) e sh.f. “ Selami Hallaçi” – Gjilan, i krijuar në bazë të impresionit nga: “ Kënga e gjinkallës”, të kompozitorit I. Shehu me tekst të F.Lamaj.

Komenti: Nxënësja është inspiruar nga përmbajtja e këngës ku ka vizatuar gjinkallën me violinë në duar dhe disa insekte tjera duke përdorur ngjyra të ndryshme.

Me këtë rast edhe pse ka ndikuar titulli i këngës prapëseprapë vërejmë një pamje figurative të kontekstit të këngës.

Në procesin edukativ muzikor nxënësve nuk duhet t'ua ndërpresim lojën kreative, përkundrazi ajo duhet të gërshetohet me të gjitha komponentët e edukimit. “Ne dëshirojmë që fëmijët ti zhvillojmë emocionalisht, ti sensibilizojmë ata, t'ua zgjojmë fantazinë, ti nxisim shprehjet e tyre kreative dhe ndjenjat ndaj të bukurës”.<sup>7</sup>

Ndërlidhja e suksesshme arrihet me planifikimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve mësimore në lëndët e ndryshme me shfrytëzimin e përvojës së nxënësve, me qëndrimin e drejtë të mësimdhënësit ndaj lëndëve tjera mësimore, me hartimin dhe shfrytëzimin e teksteve shkollore dhe aktiviteteve të lira.

Nxënësit, duke dëgjuar një vepër muzikore, përshtypjet emocionale mund t'i nxisin ata për shprehje kreative për vizatim dhe anasjelltas. Tejtrajtime të tilla asociative të përshtypjeve, janë të njohura në krijimtarinë dhe pedagogjinë muzikore. Prirjet kreative në shkallë të ndryshme nuk duhet të jenë pengesë e punës së përbashkët dhe individuale të nxënësve, përkundrazi, këto mund të jenë motivim dhe nxitje për punë më të frytshme.

Mësimdhënësi duhet të jetë ai i cili orën e vizatimit do ta bëjë edhe më inspiruese duke e ndërlidhur dëgjimin e ndonjë vepre muzikore që për nga shprehja përkon me karakterin e temës nga edukimi figurativ në mënyrë që ata të shprehin sa më mire potencialin e tyre krijues.

---

<sup>7</sup> Revista “Muziča kultura”, nr. 5, Zagreb, 1982, fq. 189

Në ditët tona muzika është e lidhur ngushtë me teatrin, me skenën. Muzika shoqëron një film, shoqëron aktet e momentet më të rëndësishme të një pjese teatrale, shoqëron baletet duke u futur gjithmonë në ambientin e saj. Sot muzika përdoret gjerësisht në veprën teatrale dhe emocionet që ajo është e aftë të ngjallë, ngjyrat e saj që ndihen deri në skutat më të thella shpirtërore të dëgjuesit që e bëjnë gjithmonë më të kuptueshme atë që skena paraqet.

(Hysenbengas, 1984:180)

### **Lidhja e muzikës me edukimin fizik**

Muzika është pjesë e jetës sonë të përditshme që nga fëmijëria dhe një formë joverbale e komunikimit dhe e transmetimit të ideve përmes tingujve, simboleve muzikore, lëvizjeve apo ritmit. Qysh në moshë të vogël, secili fëmijë përmes ninullave, lojërave, vallëzimeve fillon të përjetojë ndjenjën ritmike dhe nga ajo moshë lidhet ngushtë me muzikën deri në përjetësi. Marrëdhëniet e ngushta midis muzikës dhe lëvizjes tregojnë lidhjet mes inteligjencës muzikore dhe trupore.

“Lëvizjen nuk duhet ta konsiderojmë vetëm si funksion muskolor, por si rrjedhim të një mendimi që zgjatë, kurse muzikën nuk e konsiderojmë vetëm lojë tingujsh, por si forcë të brendshme, e cila të lëvizë. Kështu fillon loja e pashtershme, e pasur dhe e njëpasnjëshme e raporteve në mes njëres dhe tjetres, me kohën, hapësirën, forcën dhe formën” – thotë Josip Kramershek ne librin e tij “Estetska gimnastika”.



Dukuritë ritmike të paraqitura përmes onomatopeve fëmijët i shprehin me duartrokitje, goditje të këmbëve me pëllëmbë të dorës etj. Leximi i vargjeve apo interpretimi i poezive



### *Fëmijët në lojë - lëvizje*

bëhet duke bërë edhe lëvizje ritmike, edhe ecja bëhet në mënyrë ritmike por e pa vërejtur

nga njerëzit pasi që çdo lëvizje bëhet në mënyrë të caktuar dhe në përputhje me ligjet e natyrës.

Raportin e ngushtë në mes të muzikës dhe lëvizjes si tërësi estetike do ta ndjejnë nxënësit në vallet popullore dhe fëmijërore, të cilat mund të realizohen të ndërlidhura si në edukatën muzikore ashtu edhe të lëndës edukatë fizike.

Shumë forma të hershme të muzikës dhe valles u krijuan dhe u interpretuan së bashku. Ky zhvillim i përbashkët ka vazhduar gjatë kohëve me format e valles – muzikës, të tilla si: valle e

shpejtë, e ngadalshme, e gëzueshme e deri në vallet aktuale si: vals, tango, elektronike, hi – hop etj. Gjithashtu, disa zhanre muzikore kanë një formë paralele valleje, të tilla si muzika barok dhe valle barok, ndërsa të tjera zhvillohen të ndara si: muzikë klasike dhe balet klasik.

Tek nxënësit lëvizja apo vallëzimi janë pjesë interesante dhe atraktive, vallëzimet apo këndimet të përshtatura me lëvizje janë improvizime të cilat pëlqehen nga ta dhe lirojnë energjinë e tyre. Frymëmarrja, cilësia e zërit, intonimi i saktë, diksioni dhe këndimi i drejtë ndërlidhin kulturën vokale me atë të lëvizjes.

Shumë kompozitorë, mes tyre edhe Sessios, kanë theksuar lidhjen e ngushtë që ekziston midis muzikës dhe gjesteve. Në një lloj niveli, muzika mund të mendohet vetë si një lloj i avancuar gjesti – një lloj lëvizjeje ose direktivë, që zbatohet të paktën, në mënyrë indirekte, nga trupi.... Disa nga metodat më efektive të mësimdhënies në muzikë janë ato që përpiqen të kombinojnë zërin, lëvizjet e duarve dhe trupit. (Gardner, 2003: 160)

Raportin e ngushtë mes muzikës dhe lëvizjes si tërësi estetike do ta ndiejnë nxënësit në vallet popullore dhe fëmijërore, të cilat mund të realizohen të ndërlidhura si në një orë mësimore të edukatës muzikore, ashtu edhe në një orë muzikore të edukatës fizike.

Varësisht nga karakteri i veprës, nxënësit do t'i realizojnë edhe lëvizjet: me temp të shpejtë, karakter të gëzueshëm - lëvizje të gjalla, marshi – me lëvizje të mprehta, kompozimi lirik – lëvizjet e gjëra dhe të buta.

Frymëmarrja, intonimi i saktë, cilësia e zërit, këndimi pa shtrëngime dhe diksioni me një edukim të mirëfilltë, ndërlidhin kulturën vokale dhe kulturën e lëvizjes.

Aftësitë e nxënësve zhvillohen dhe formohen në mënyrë graduale, por nxënësi në çdo etapë të zhvillimit është krijesë e tërësishme. Të tërësishëm janë edhe karakteri, të shprehurit dhe përjetimet e tij.

Kur loja është e përcjellë me muzikë i bënë nxënësit më të gjallë, më të hareshëm, më atraktiv.

Në orën e mësimi që do të prezantohet në vijim, muzika planifikohet për t'u vendosur në sfond si shoqëruese e aktivitetit fizik në orën e Edukatës Fizike.

Klasa: 5

Lënda: Edukata Fizike

Tema mësimore: Ushtrime ritmike me rekuizita

Objektivat mësimorë: Në fund të orës së mësimi, nxënësit janë të aftë që:

- Nxënësi mëson kërcimet me litar, kërcimet me stilin drenush dhe kërcimi pupth.

Metodologjia: Veprimtari praktike

Mjetet: litar, fjollë, bilbil, CD me muzikë ritmike

Zhvillimi i mësimit

Evokimi

Në sfond vendoset muzikë ritmike për të shoqëruar orën mësimore, që të krijohet atmosferë ritmike dhe ora e mësimit të jetë dinamike.

Për 10 minuta bëhet ushtrime për nxemje.

- rreshtimi i klasës
- Përshëndetja, marrja e mungesave
- Njohja me temën e mësimit
- Vrapim i lehtë
- Ushtrime për zhvillimin e fleksibilitetit.

Realizimi

U shpjegohet nxënësve kërcimi drenush dhe pupthi.

Nxënësit demonstrojnë ushtrimin e mësuar disa herë, njëri pas tjetrit.

Organizimi i garave mes nxënësve, kush e demonstroi ushtrimin më saktë.

Reflektimi

Ushtrime të ndryshme qetësuese.

Konkluzioni i orës së mësimi.

Çdo vepër e re e dëgjuar nxënësit e përcjellin në forma të ndryshme, në mënyrë spontane pasi që muzika nxitë emocione dhe ndjenjat thellohen te ata.

Gjithashtu duhet pasur kujdes në përzgjedhjen e materialit që do t'ju ofrojmë nxënësve pasi që në rend të parë ai duhet t'ju përshtatet moshës së tyre, në mënyrë që ata të kenë mundësi përjetimi sa më të thellë.

Këngët me karakter vallëzues janë më të afërta për ta ngase në të njëjtën kohë këndojnë dhe vallëzojnë.


Ja një këngë e cila mund t'i nxitë nxënësit më të vegjël që të këndojnë e të vallëzojnë njëkohësisht.

**Shembulli:**

## Zilja jonë

F. Beqiri

Andante



Tring, tring, tring kjo zil - ja jon' për në m'sim a - jo na fton

5

E - ni nxë - nës me nxi - tím na thurret shko - lla gjith' gë - zim

Kënga “Klasa ime feston sot”:

Ësht' si pula me gjith zogj'

Na uron që dhe këtë her'

T'kem plot pesa në ditat

Ja një këngë tjetër me tempo të valsit ku nxënësit më të rritur gjatë kohës që janë duke kënduar në mënyrë spontane do t'i koordinojnë hapat e tyre sipas ritmit të këngës.

**Shembulli:**

## Ma come bali bela bimba

Në tempo të valsit

Italiane



Ma co-me ba-li be-la bim-ba, be-la bim-ba be-la bim-ba, ma co-me ba-li be-la bim-ba co-me ba-li ba-li

9

Fine

ben! Var-da che pas - sa la vi - la - ne - la A - gi - le a sve - la, sa - ben ba - lar.

Muzika lidhet me mënyra të ndryshme me sisteme simbolesh dhe me sfera të tjera të intelektit njerëzor. Lidhjet midis muzikës dhe inteligjencës hapësinore janë më pak evidente e, megjithatë, me shumë mundësi ato janë po aq reale. Përqendrimi i aftësive muzikore në hemisferën e djathtë sugjeron se disa prej tyre mund të jenë të lidhura ngushtë me ato hapësinore. Psikologu Lauren Harris citon disa raste në mbështetje të idesë se kompozitorët janë të varur nga aftësitë hapësinore, të cilat u nevojiten atyre për të imagjinuar, vlerësuar dhe modifikuar strukturën komplekse të një kompozimi. (Gardner, 2003: 160 - 161)

Secila prej inteligjencave ka rëndësinë e saj në jetën e njeriut. Sipas Gardnerit, lloji i inteligjencës që vlerësohet më shumë varet nga kontekstet e ndryshme të të nxënimit. Në shoqëritë tradicionale pa shkrim e këndim, njohuritë ndërpersonale vlerësohen më tepër. Shfrytëzohen shumë format trupore dhe hapësinore të njohurive, ndërsa format muzikore dhe gjuhësore të njohurive mund të çmohen në disa rrethana të specializuara. (Gardner, 2003: 161)

### **Ndërlidhja e edukimit muzikor me njohjen e kulturës së popujve të ndryshëm:**

Ndërlidhja me folklorin muzikor në kontekstin e njohjes së kombeve dhe vendeve të ndryshme, do të njohë nxënësit për së afërmi edhe me vlerat shpirtërore muzikore, të këtyre vendeve.

Ngjarjet historike e aktuale të një kombi, përshkrimi i natyrës së një vendi, personalitetet e njohura, kompozitorët mund t'i shprehin përmes gjinive të ndryshme muzikore: me muzikë orkestrale, programore, në formën e poemës simfonike si tërësi të pandashme etj. P.sh. është e njohur poema simfonike “Vëlltava”, e kompozitorit çek, Bedzhih Smetana, i cili përmes tingujve muzikor përshkruan rrjedhën e lumit Vëlltava që nga burimi i tij.

Kompozitori edhe përmes simboleve muzikore shpreh forcën, guximin dhe trimërinë, me tinguj të fuqishëm, ritëm të theksuar, melodi të karakterit dramatik (përmes frymorëve të tunxhit), pastaj krenarinë, entuziazmin, gëzimin dhe mallëngjimin e bashkëvendësve të tij.

“Vëlltava” shtratin e saj e fillon me dy burime në një hije mali (dy flauta),

Allegro comodo non agitato

The image shows a musical score for two woodwind instruments: Piccolo and Flute. The tempo is marked 'Allegro comodo non agitato'. The key signature is one sharp (F#) and the time signature is 6/8. The Piccolo part is mostly silent, indicated by a horizontal line with a dash. The Flute part begins with a piano (*p*) dynamic and plays a rhythmic pattern of eighth notes. The score consists of four measures. The first measure shows the Flute starting with a piano (*p*) dynamic. The second measure continues the pattern. The third measure has a piano (*p*) dynamic marking above the staff. The fourth measure concludes the phrase with a piano (*p*) dynamic marking below the staff.

të cilat pastaj shkrihen në një përrua. Ajo duke rrjedhë nëpër Çeki krijon shtratin e një lumi të madh. Duke kaluar nëpër male, dëgjohet zëri i bririt (kornës), e cila paralajmëron kohën për gjueti, ndërsa duke kaluar nëpër fushat e bujshme me lule dëgjojen vallet e ahengut dasmor.



“Pra, gjeografia muzikore mund të pasurojë njohuritë e përgjithshme të nxënësve për vendet dhe popujt e ndryshëm”.<sup>8</sup>

Temën e poemës simfonike “Vëlltava”, nxënësit mund ta këndojnë para dëgjimit të veprës.

### Tema nga poema simfonike "Vëlltava"

B. Smetana

Allegro

*p* Violinat *sf* *p* *dim.*

9 1. 2.

14

### Ndërlidhja e muzikës me shtrirjen gjeografike

Si ndërlidhje mjaft e ngushtë është lidhja në mes të cilësive muzikore dhe shtrirjes gjeografike ku mund të dallohet se cilit komb i takon, kështu që do të vërehet më lehtë muzika autoktone e një populli.

“Shpjegimet dhe përshkrimet lidhur me një vend të caktuar do të jenë më piktoreske po të shoqërohen edhe me ilustrime muzikore të popullit të këtij vendi”.<sup>11</sup>

### Shembulli:

<sup>8</sup> Prof.mr.Seniha Spahiu” Metodika e muzikës”, Prishtinë, 2009, fq.269

## Çardash

përshtati S. Spahiu

G. Altaj

Vivo

The musical score is written on a single staff with a treble clef and a 2/4 time signature. It consists of two lines. The first line starts with a dynamic marking of *mf* and the tempo marking 'Vivo'. The melody is: G4, A4, B4, C5, B4, A4, G4, F4, E4, D4, C4. Below the notes are the lyrics: 'Jam dja-losh sy - kal-trosh ti më thu - a bu - ku-rosh çar - dash kër-cejm' k'të ri - tëm'. The second line starts with a measure rest for 8 measures, then has a dynamic marking of *p* and the tempo marking 'Fine'. The melody is: D4, E4, F4, G4, A4, B4, C5, B4, A4, G4, F4, E4, D4. Below the notes are the lyrics: 'ndejim' p la la la la la la la la la la la la la la la la la la la'. The score ends with a double bar line and the number 12.

*mf* Jam dja-losh sy - kal-trosh ti më thu - a bu - ku-rosh çar - dash kër-cejm' k'të ri - tëm

8 Fine *p* la la la la la la la la la la la la la la la la la la la 12

Da capo al fine

Edukimi muzikor mund të ndërlidhet me lëndë të ndryshme duke i plotësuar ato elementin muzikor që ndihmon arritjen e përjetimeve më të thella gjatë përfitimit të njohurive në lëndët respektive.

Nga ana tjetër për ta lehtësuar përjetimin dhe të kuptuarit e përmbajtjeve muzikore, në mësimin e edukimit muzikor aplikohen në mënyrë të ndërsjellë njohuritë nga lëndët tjera, si domosdoshmëri e vazhdimësisë së ndërlidhjes në edukimin dhe arsimimin muzikor.

### Ndërlidhja e aktiviteteve të lira në klube me mësimin e rregullt (standard)

<sup>11</sup> <http://www.google.com/>

<sup>12</sup> Seniha Spahiu, Edukata muzikore 7, Prishtinë, 2009 , fq. 104

Edukimi dhe arsimimi muzikor nuk përfundon në klasë, në kor dhe orkestër, ky proces mund të organizohet në klubet muzikore për nxënësit me interesim më të zgjeruar ndaj artit muzikor.

Në çdo shkollë mund të hasim në fëmijë me prirje të theksuara muzikore. Puna e nxënësve në klubet muzikore është më e relaksuar.

Aktivitetet e ndryshme muzikore të zhvilluara në klube janë formë e përshtatshme ku nxënësit mund të shprehin talentin e tyre muzikor e kështu edhe zgjerojnë njohuritë muzikore të cilat kanë vlera edukative-muzikore.

Veprimtaria në klub bazohet në përcaktimin plotësisht të lirë, si në zgjedhjen e përmbajtjeve, ashtu dhe të formave të aktivitetit, ndryshe dhe nga mësimi i zgjedhur, i cili pas zgjedhjes së lirë nga nxënësi, merr statusin e mësimit të rregullt.<sup>9</sup>

Aktivitetet e lira janë forma më e përshtatshme ku nxënësit do të kenë mundësi që të shpalosin dispozitat e tyre krijuese, pasi që këtu janë më të lirë në realizimin e dëshirave të tyre krahasuar me mësimin e rregullt ( standard).

Si faktor shumë i rëndësishëm padyshim që është roli i mësimitdhënësit, i cili me përgatitjen e tij profesionale – pedagogjike do t'i ndihmojë nxënësit në organizimin dhe realizimin e këtyre aktiviteteve, por gjithnjë duke pasur kujdes që mos t'ju imponojë mendimin e tij. Po ashtu mësimitdhënësi duhet t'i korrigjojë e t'i këshillojë nxënësit, duke iu ofruar variante të

---

<sup>9</sup> Mr.Seniha Spahiu “ Metodika e mësimit të muzikës” Prishtinë, 2009, fq.276

ndryshme, në mënyrë që të lehtësojë punën, në realizimin dhe koordinimin e aktiviteteve brenda klubit.

Për punën e klubeve, për format e ndryshme të veprimit dhe punën kreative të nxënësve, mësimit duhet të jetë frymëzues edhe atëherë kur nxënësit nuk i përmbushin njohuritë e të shprehurit muzikor.

Në kuadër të klubeve muzikore mund të zhvillohen aktivitete të cilat nxënësit i përzgjedhin sipas vullnetit të tyre. Mësimit duhet zhvilluar brenda klubeve prirjet eventuale të nxënësve për të krijuar ndonjë melodi nga poezitë e shkruara të nxënësve të klubit të gjuhës amtare, e pastaj ato këngë vetë ti këndojnë dhe ti shoqërojnë me instrumente muzikore të cilat ata edhe mund ti ndërtojnë e sidomos ato ritmike.

Kështu realizohet forma e shumëfishtë e ndërlidhjes me gërshetimin e disa përmbajtjeve të ndryshme letrare – muzikore. Në kuadër të klubit muzikor marrin pjesë solistët e rinj dhe të talentuar, me zë të bukur dhe ata të cilët luajnë në instrumente muzikore. Tek ky grup i solistëve vokale ose instrumentale vihet në pah zhvillimi individual i nxënësve.

Me këta nxënës, mësimit mund të ndërlidhë dhe formojë ansamble vokale dhe instrumentale me vlerë më të lartë muzikore dhe edukative.

Në grupin e krijuesve të rinj nxënësit kanë mundësi që të shprehin tërë imagjinatën e tyre, duke krijuar këngë nga më të ndryshmet.

Nxënësit të cilët kanë afinitet dhe interesim ndaj aktiviteteve muzikore dhe shkathtësive teknike, e përbëjnë grupin e ndërtuesve të instrumenteve dhe të mjeteve muzikore në kuadër të klubit muzikor. Kryesisht ndërtojnë instrumente ritmike të cilat i përdorin për përcjelljen e këngëve të ndryshme.

Në kuadër të klubit muzikor mund të anëtarësohen edhe grupi i dëgjuesve dhe i vizitorëve të koncerteve dhe shfaqjeve të ndryshme muzikore, si: takimet me nxënësit e talentuar të shkollave të muzikës e po ashtu takimet me kompozitorët dhe bisedat për krijimtarinë e tyre muzikore.

Rezultatet që i arrijnë grupet në kuadër të klubit muzikor, gazetarët e rinj të muzikës informojnë lexuesit për aktivitetet e nxënësve brenda shkollës. Në revistën e shkollës botohen edhe kompozimet më të suksesshme të nxënësve krijues, vizatime dhe poezi të punuara gjatë dëgjimeve muzikore.

Të gjitha këto aktivitete që zhvillohen në kuadër të klubit muzikor me nxënës të talentuar, mundësojnë edukim të pasur muzikor dhe gjithëpërfshirës, dhe të ndërlidhur në kuadër të formave, të aktiviteteve të lira të tyre.

#### **2.4.Zhvillimi konjitiv, psikosocial i fëmijës gjatë fëmijërisë së mesme**

Zhvillimi i njeriut, përfshin ndryshimet fizike që ndodhin në trup, mënyrën e të menduarit, emocionet, sjelljen, marrëdhëniet me të tjerët, rolet etj., të para këto përgjatë fazave të rritjes dhe zhvillimit (*Karaj 2005: 63*).

Duke iu referuar psikologjisë së zhvillimit, do të vërejmë se fëmijëria ndahet në katër periudha: foshnjëria, fëmijëria e hershme, periudha e latencës dhe adoleshenca (Waldinger, 2007).

Sipas studiuesve të psikologjisë zhvillimore, rritja dhe zhvillimi, ndahet me periudha (Pettijohn. 1996) foshnjëria, fëmijëria e hershme, fëmijëria e mesme ose periudha e latencës dhe adoleshenca.

Fëmijëria e mesme i përket moshës 6- 10 vjeç. Kjo grup moshë i përkon moshës shkollore, ku fëmija shkëputet nga ambienti familjar për të hyrë në shkollë dhe (Woolfolk, 2006), karakterizohet nga zhvillime të mëdha konjitive. Në këtë periudhë, ndryshimet fizike janë më të ngadalta.

Gjatë viteve të mesme të fëmijërisë – 6 -12 vjeç –, fëmijët vazhdojnë të bëjnë hapa të mëdhenj në zhvillimin e tyre. Ata përparojnë fizikisht dhe intelektualisht, teksa vazhdojnë të bëhen më të gjatë, më të rëndë dhe më të fortë dhe të mësojnë shprehi të reja dhe koncepte njohëse. Ata përdorin më mënyrë më efektive njohuritë e tyre për numrat, fjalët dhe konceptet.

Karakteristikat e personalitetit që fëmijët kanë nisur t'i shfaqin tashmë, skaliten më thellë. Teksa prindërit vazhdojnë të ushtrojnë një ndikim të fuqishëm, tani bëhet i rëndësishëm edhe grupi i bashkëmoshatarëve. Fëmijët duan të rrinë me shokët e tyre dhe zhvillohen nga ana sociale përmes këtyre kontakteve.

Individin përgjatë fazave të rritjes dhe zhvillimit, e shoqërojnë një sërë karakteristikash, faza këto ku nëpërmjet tyre, njeriu pëson ndryshime të rëndësishme në fushat e zhvillimit psiko-motorr, njohës, emocional, social dhe psikik. Në proceset e zhvillimit të njeriut, kemi ndryshime përgjatë gjithë jetës dhe këto ndryshime, në vetvete janë shumë dimensionale dhe vendimtare. Së pasi përmendim zhvillimin biologjik. Ky ndryshim i rëndësishëm, ka të bëjë me bazat neurologjike dhe hormonale të sjelljes (Karaj, 2005). Proceset biologjike ndikojnë në zhvillimin fizik, konjitiv, emocional dhe të personalitetit.

Zhvillimi fizik, ka të bëjë me ndryshimet fizike që ndodhin në trupin e njeriut që në konceptim dhe përgjatë gjithë jetës.

Zhvillimi konjitiv, ka të bëjë me proceset e të menduarit dhe ndryshimet që ndodhin gjatë rritjes si p.sh., të menduarit, kujtesën, perceptimet, vëmendjen dhe gjuhën.

#### ***2.4.1. Zhvillimi i të menduarit***

##### *Faza e operacioneve konkrete (Piazheja)*

Diku mes moshës 5-7 vjeçare, sipas Piazhesë, fëmijët hyjnë në fazën e operacioneve konkrete, ku ata mendojnë në mënyrë logjike mbi të tashmen (tani dhe këtu).

### *Mendimi operacional*

Fëmijët në këtë fazë mund të përdorin simbolet për të kryer *operacionet* – aktivitetet mendore, përkundrajt aktiviteteve fizike që ishin baza e shumicës së të menduarit të tyre të mëparshëm. Për herë të parë, bëhet e mundur logjika. Fëmijët e operacioneve konkrete janë shumë më të zotë se ata paraoperacionalë në klasifikimin, punën me numrat, trajtimin e koncepteve të kohës dhe hapësirës dhe dallimin e realitetit nga fantazia.

Kujtesa e menjëhershme (afatshkurtër) rritet shpejt në fëmijërinë e hershme. Gjuha gjithashtu, zhvillohet shpejt në fëmijërinë e mesme. Fëmijët mund të kuptojnë dhe interpretojnë më mirë komunikimin, fjalori dhe aftësia e tyre për të përkufizuar fjalët rriten dhe ata janë më të aftë të bëhen të kuptueshëm për të tjerët.

Zhvillimi social, ka të bëjë me ndërveprimin e fëmijës me mjedisin që e rrethon dhe ku fëmija rritet dhe zhvillohet.

Grupi i parë i teorive që kanë përshkruar fëmijërinë e hershme janë ato psikoanalitike. Të gjitha ato theksojnë se fëmijët janë të gatshëm për të mësuar mbi universin e tyre social në zgjerim. Për shembull, Frojdi e përshkroi këtë si periudha e latencës, gjatë së cilës shtysat emocionale janë më të qeta, nevojat e tyre psikoseksuale janë të represuara dhe konfliktet e tyre të pandërgjegjshme të mbuluara. Kjo e bën latencën ‘një periudhë për të fituar shprehi njohëse dhe për të asimiluar vlera kulturore, teksa fëmijët zgjerojnë botën e tyre për të përfshirë mësuesit, fqinjët, bashkëmoshatarët, drejtuesit e grupeve dhe trajnerët. Energjia seksuale vazhdon të ekzistojë, por



kanalizohet në interesa sociale”.

Erik Eriksoni binte dakord me Frojdin se kjo është një periudhë e qetë emocionalisht. Gjatë fazës së tij të krizës së zellit përkundrejt inferioritetit, fëmijët përpiqen të zotërojnë cilatdo aftësi që vlerëson kultura e tyre. Ata e gjykojnë veten si të zellshëm ose inferiorë – pra si të aftë apo të paaftë, si produktivë apo të dështuar, si fitues apo humbës.

Teoricienë të tjerë, të ndikuar nga dy teori të tjera të mëdha – teoria e sjelljes dhe e të menduarit – janë të interesuar përkatësisht lidhur me fitimin e shprehive të reja dhe të vetëkuptuarit. Veçanërisht një degë e teorisë së sjelljes, teoria njohëse sociale, është më e përshtatshme për fëmijërinë e hershme, pasi thekson sesi fëmijët e moshës shkollore përparojnë në të mësuar, njohje dhe kulturë<sup>61</sup>. Kjo teori thotë se maturimi dhe eksperiencia kombinohen duke i lejuar fëmijët të jenë të artikuluar, reflektues dhe aktivë, të aftë të kuptojnë veten dhe të jenë efektivë dhe kompetentë. Ata mendojnë në mënyrë logjike, siç pamë më sipër dhe i aplikojnë aftësitë e tyre të të mësuarit në botën e tyre sociale që zgjerohet.

Koncepti për veten është sensi ynë mbi veten që përfshin të kuptuarit e vetes dhe vetëkontrollin ose vetërregullimin. Vetëkoncepti që ndërtohet gjatë fëmijërisë së mesme është shpesh i fortë dhe i qëndrueshëm.

Sipas Erik Eriksonit, një përcaktues i rëndësishëm i një vetimazhi të mirë, është mënyra sesi fëmija e sheh kompetencën e vet. Kriza madhore e fëmijërisë së mesme, sipas teorisë së Eriksonit është ajo e zellit përkundrejt inferioritetit. Çështja për t’u zgjidhur këtu është

aftësia e fëmijës për punë produktiv. Të gjithë fëmijët, në çdo kulturë duhet të mësojnë shprehitë që iu nevojiten për të mbijetuar; specifikat e kësaj varen nga shoqëria ku jetojnë.

Zhvillimi emocional përfshin ndjenjat dhe reagimet afektive të individit. Zhvillimi i personalitetit, ka të bëjë me veten dhe konceptimin e vetes, sipas karakteristikave që ka personi apo sipas atyre që do të zhvillohen në bazë të faktorëve dhe rrethanave që e rrethojnë një individ.

Zhvillimi i fëmijës është holistik që do të thotë është tërësor, pra përfshin të gjitha fushat dhe si rezultat i këtij zhvillimi, varet nga ndërveprimi i fushave me njëra-tjetrën.

#### **2.4.2.Ndikimi i muzikës në zhvillimin konjitiv e psiko – social të fëmijëve**

Ndikimi i edukimit muzikor në zhvillimin konjitiv e psiko – social të fëmijëve (nxënësve)

Në zhvillimin konjitiv e psiko – social të fëmijëve ndikojnë shumë faktorë, si mjedisi familjar, bashkëmoshatarët, shkolla, media etj. Një rol të rëndësishëm luan dhe muzika.

Studimet kanë treguar se muzika ndikon pozitivisht në zhvillimin konjitiv të individit, duke stimuluar zhvillimin e trurit. Sipas Efektit të Moxartit, ideja është që foshnjat dhe fëmijët e vegjël mund të përfitojnë nga ekspozimi dhe trajnimi i hershëm muzikor. (Caulfield. 1999, 119)

Studiuesit besojnë se muzika ka aftësinë për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin e trurit tek nxënësit e rinj (Strickland, 2001 /2002). Në lidhje me këtë, Davies (2000) shpjegon se mësim optimal ndodh kur dy hemisferat e trurit punojnë së bashku. Çdo strategji kullimi, siç është muzika, që integron funksionet e të dy hemisferave, përdor projektin natyral të trurit për ta bërë mësimin më të lehtë, dhe më shumë argëtim "( Davies, 2000: 148)

Duke qenë se muzika ndikon pozitivisht në stimulimin e zhvillimit të trurit, ajo ndikon pozitivisht dhe në performancën e nxënësit në të nxënë. Nga rezultatet e dokumentuara të studimit të Schellenberg (2006: 57) tregohet se fëmijët që ishin të ekspozuar ndaj mësimëve të muzikës kishin performancë më të lartë në mësim, në një shumëllojshmëri të gjerë të detyrave që përfshijnë perceptimin dhe njohjen e muzikës, krahasuar me pjesën tjetër të fëmijëve që nuk ishin të ekspozuar ndaj muzikës. Kjo ndodh pasi muzika krijon një lidhje të fortë nervore, duke bërë që të kujtohet më lehtë informacioni Davies (2000: 149) Hulumtimet rreth marrëdhënieve ndërmjet muzikës dhe lëndëve të tjera tregojnë se muzika ndikon në përmirësimin e aftësisë për të lexuar, për t'u shprehur. Mësimi i muzikës zhvillon aftësitë perceptuese të nevojshme në lexim, duke nxitur dashurinë për të lexuar, sidomos te nxënësit e klasave të para në arsimin fillor, ndërsa fëmijët mësojnë si të lexojnë.

Nga studiues të ndryshëm është konstatuar një lidhje mes muzikës dhe zhvillimit të aftësive të të lexuarit dhe të të shkruarit. Një studim, i kryer me fëmijët që vinin nga familje me disnivele ekonomike, kishte qëllimin të shihte zhvillimin e aftësive të të lexuarit dhe të të shkruarit të nxënësve, nën ndikimin e muzikës. Gjatë kohës së ushtrimit të këtyre aftësive, nxënësit dëgjonin edhe muzikë. Përmes studimit u konstatua se nxënësit i përmirësuan këto

aftësi. (Standley dhe Hughes, 1997). I njëjti studim u përsërit nga Register (2001) e përsëriti këtë studim me një kampion prej 50 fëmijësh. Rezultatet e marra treguan përfitime të konsiderueshme për instruksione të zgjeruara nga muzika në përmirësimin e aftësive në të lexuar dhe në të shkruar.

Studentët që mësojnë muzikë krahasuar me studentët që nuk merren me muzikë kanë aftësi më të mira në të shkruar, aftësi në përdorimin e burimeve të informacionit, aftësi në lexim dhe në të kuptuarin e informacionit. Këto aftësi të fituara përmes muzikës përmirësohen me kalimin e kohës (Baker, 2011; Catterall, 1998).

Studimi i një vegle muzikore zhvillon aftësinë dëgjimore që ka një ndikim pozitiv në zhvillimin e aftësive fonetike. (Yoon, 2000: 17). Madje, muzika nxit të nxënit në matematikë. Sipas Holden (1999) fëmijët që marrin mësim pianoje arrijnë rezultate më të larta në testet e performancës së matematikës. Këto gjetje janë të vërteta, pavarësisht nga statusi socio-ekonomik dhe raca / etnia e individit (Baker, 2011; Catterall, 1998). Përveç kësaj, studentët që angazhohen në muzikën instrumentale, kanë performancë më të mirë në algjebër, një mundësi kjo shumë e mirë për arritjet e mëvonshme (Helmrich, 2010; Paneli Këshillëdhënës Kombëtar i Matematikës, 2008).

Muzika e lehtë dhe e ngadaltë nxit valët alfa, relakson trurin, i cili mund të jetë më aktiv e produktiv, sidomos kur shqyrton përmbajtjen, në mënyrë që informacioni të kalojë në kujtesën afatgjatë (Millbower 2000).

Studiuesit kanë arritur në përfudimin se muzikantët kanë kujtesën e punës më të lartë, duke u krahasuar me personat e tjerë që nuk merren me muzikë. Sipas këtyre studiuesve, muzikantët janë në gjendje më të mirë për të mbështetur kontrollin mendor gjatë kujtesës dhe kujtojnë më shpejt detyrat. Kjo, më shumë gjasa si rezultat i trajnimit të tyre afatgjatë muzikor (Berti et al., 2006; Pallesen et al., 2010)

Angazhimi i vazhdueshëm me muzikë zhvillon rajonin e trurit, përgjegjës për kujtesën verbale, e cila shërben edhe për të kujtuar fjalët të folura, duke shërbyer si themeli për mbajtjen e informacionit nga të gjitha subjektet akademike. Te studentët e muzikës, të cilët u testua kujtesa verbale e tyre, u vu re një kujtesë më e lartë për fjalët në krahasim me studentët e tjerë që nuk studionin për muzikë (Ho et al., 1998; 2003)

Roli i muzikës në rritjen e performancës akademike të nxënësit vihet re edhe në rezultatet e testeve të standardizuara. "Një analizë e të dhënave të testeve të standardizuara, të siguruara përgjatë 10 viteve, që bëhen të nxënësit për t'u pranuar në kolegji, zbuloi se studentët që morën përgjatë katër viteve kurse në fushën e arteve, arritën rezultate më të larta, krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre që nuk i kishin frekuentuar këto kurse. (Vaughn et al., 2000). Nga këta studentë, ata që ndoqën kurse muzike arritën pikë të larta në matematikë dhe në testet verbale. (Bordi i Kolegjit, 2010).

Hulumtimet tregojnë se funksioni kompleks i funksionimit të trurit është më dominues në profesionistët e muzikës (të cilët punojnë me dhe kujtojnë muzikën dhe të gjithë përbërësit

e saj) në krahasim me fillestarët, por ka prova për të provuar se funksionimi më i lartë i trurit është i dukshëm në të dyja llojet (Reimer, 2004).

Hulumtimet mbi ndikimin ndërmjet muzikës dhe zhvillimit shoqëror dhe personal në raport me ndikimin e muzikës në zhvillimin dhe arritjen intelektuale të individit, kanë pasur më shumë vëmendjen e hulumtuesve, pasi përkundër faktit se efektet në arritje intelektuale mund të ndikohen pjesërisht edhe nga statusi social dhe kulturor i individit. Në lidhje me këtë, Broh (2002) tregoi se studentët që morën pjesë në aktivitete muzikore bashkëbisedonin më shumë me prindërit dhe mësuesit, dhe prindërit e tyre kishin më shumë gjasa të flisnin me prindërit e shokëve. Ajo arriti në përfundimin se këto përfitime sociale mund të çonin në vetëvlerësim më të lartë të studentëve.

Përveç zhvillimit të shkathësive personale dhe shoqërore, muzika mund të ketë aftësinë për të rritur ndjeshmërinë emocionale. Resnisow et al. (2004) zbuloi se kishte një marrëdhënie midis aftësisë për të menaxhuar emocionet në shfaqjet e muzikës klasike të pianos dhe inteligjencës emocionale.

Fëmijët, duke çuar në rritjen e motivimit dhe vetëfikasitetit. Një studim nga Këshilli i

Kërkimeve Norvegjeze për Shkencën dhe Humanizmin mbështeti këtë gjetje, pra lidhjen midis zhvillimit social e personal, me argumenti se individët që kanë aftësi muzikore dhe motivim të lartë, kanë gjasa për të arritur rezultate më të larta në shkollë (Lillemyr, 1983).

Whitwell (1977) thotë se ka korrelacione të larta midis vetëperceptimit pozitiv, shkathësive njohëse, vetëvlerësimit të nxënësve dhe përfshirjes së tyre në muzikën e shkollës, duke

argumentuar se pjesëmarrja kreative në muzikë përmirëson vetimazhin, vetëdijesimin dhe krijon vetëqëndrime pozitive.

Muzika ka magjinë të ndikojë në gjendjen shpirtërore të njeriut, duke larguar ngarkesën negative që prish humorin dhe ngadalëson ritmin e jetës. Studimet rreth marrëdhënies së muzikës dhe lobeve frontale zbuluan se në përgjithësi muzika rrit aktivitetin brenda lobeve ballore të majtë, e cila shoqërohet me lumturinë (Strickland, 2001/ 2002, 101). Kjo mund të shpjegojë pse muzika krijon një mjedis çlodhës, të ç'tensionuar psikologjikisht. Davies (2000, 150) thotë se muzika në klasë redukton stresin, rrit produktivitetin, rregullon energjinë dhe krijon një mjedis të qetë dhe mbështetës për të mësuar. Angazhimi me muzikën mund të rrisë vetëperceptimin te nxënësit, nëse ofron eksperiencë pozitive të të nxënësve, të cilat janë të dobishme (Hallam, 2010: 281/282)

#### ***2.4.3.Përdorimi i muzikës në klasë për të rritur të nxënësit***

Muzika kultivon aftësi më të mira të të menduarit. Shkathtësitë e të menduarit të tilla si arsyetimi abstrakt janë pjesë integrale e aftësisë së studentëve për të aplikuar njohuritë dhe për të vizualizuar zgjidhjet. Studimet kanë treguar se fëmijët e vegjël të cilët marrin mësimë muzikore në tastierë, kanë aftësi më të mëdha të arsyetimit abstrakt, se moshatarët e tyre, dhe këto aftësi përmirësohen me kalimin e kohës gjatë angazhimit të vazhdueshëm me muzikë. (Rauscher, 2000: 215-228)..

Studiuesit kanë arritur në konkluzionin se muzika e vendosur në sfond në klasë mund të rrisë entuziazmin e fëmijëve gjatë punës së tyre. Diefenbacher (1999: 32) thotë se në një

orë mësimore, ku nxënësit mësojnë rreth metamorfozës, janë më të interesuar për temën, teksa dëgjojnë fjalët dhe melodinë e këngës dhe lexojnë rreth krimbave duke u kthyer në flutura.

Sipas disa teoricienëve, muzika në sfond dhe media, potencialisht, pengojnë performancën njohëse për shkak të sasisë së kufizuar të përpunimit njohës të burimeve mendore (Basil, 1994). Këta teoricienë arrijnë në këtë përfundim për këto arsye:

1) Ndodh çrregullimi kur tejkalohet kapaciteti i ndërgjegjësimit;

2) Ndërhyrja strukturore ndodh kur detyrat kryhen në të njëjtën kohë.

Në lidhje me këtë, Bourke dhe kolegët shqyrtuan kufizimet në detyra dhe veprimtari që jepen njëkohësisht dhe zbuluan se detyrat duhet të strukturohen sipas një logjike të përgjithshme duke matur edhe faktorët ndërhyrës. (Bourke, Duncan dhe Nimmo-Smith, 1996). Sipas tyre, kombinimi i detyrave të shtëpisë me mediat i sfidon studentët me ruajtjen e vëmendjes dy detyra. Burimet mendore të njeriut kanë kapacitet të kufizuar dhe prandaj lejojnë vetëm një pjesë të informacionit që do të përpunohet. Kjo është veçanërisht e vërtetë për shkak të stimujve të ndryshëm reagues që media shkakton, psh. përmbajtjes së efekteve zanore, efekteve vizuale dhe lëvizjeve televizionit. (Lang, 2000).

Gjithashtu, Murpheu thotë se muzika ka potencialin për të ndryshuar atmosferën. Duket se ajo të jep energji aty ku energjia mungon, nxit imagjinatën e studentëve kur këta ankohen se



nuk kanë asgjë për të shkruar rreth një teme të caktuar. Pra muzika nxit imagjinatën e nxënësve .

Një studim i bërë me nxënësit e shkollave të mesme provoi se muzika popullore e sotme mund të ndihmonte në përforcimin e studimit të historisë. Studentët, të cilët u paraqitën në orën e mësimit me tekste të këngëve popullore, ku trajtoheshin tema historike, kishin performancë më të mirë në tema të veçanta krahasuar me studentët e tjerë , të cilët nuk patën detyrë të sillnin si ilustrim për temën mësimore këngë popullore (Eady & Wilson, 2004: 245).

Për vetë rolin që muzika luan në jetën e njeriut dhe rëndësinë që ka ajo në zhvillimin emocional, social e shoqëror të fëmijëve, është shumë efikase metoda e integritit ndërlëndor në shkollë, ku efekti çlodhës i muzikës të shërbeje si instrument nxitës në etapa të veçanta të orëve mësimore në lëndë të ndryshme.

Në lidhje me këtë, Davies ( Davies, 2000: 150) i sugjeron mësuesit që të luajnë pjesë muzikore relaksuese, në fillim dhe në fund të ditës së shkollës, pas drekës dhe para testeve, për të krijuar mjedis qetësues për nxënësit dhe personelin mësimor. Kjo do të rriste performancën e nxënësve dhe mësuesve në shkollë, pasi kur dëgjojmë muzikë ose ndonjë ligjëratë, ne përpunojmë shpejt një sasi të madhe të informacionit pa vetëdijen tonë.

(Blakemore dhe Frith, 2000)

Kenney (2004) thekson se fëmijët ndërtojnë njohuritë e tyre duke u përpjekur për të kuptuar nga çdo gjë që është rreth tyre, dhe ata zhvillojnë aftësitë e tyre duke manipuluar atë që

është më interesante për ta. Sigurimi i një ambienti muzikor është një mënyrë efektive për të ndihmuar fëmijët e vegjël të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe dispozita muzikore në kuptim të asaj se si e shohin botën" (Kenney, 2004: 29)

Arthur dhe McCrary (1999) hulumtuan se një pjesë e mësuesve ndihen të përgatitur në mënyrë adekuate për të integruar në klasë muzikën me tema të ndryshme në lëndë të ndryshme, por një pjesë e mësuesve akoma nuk ndihen të përgatitur për të realizuar këtë integrim ndërlëndor.

## **2.5.Mësimdhënia dhe të nxënësve të Arsimit Fillor**

### *2.5.1.Mësimdhënia produktive*

Procesi i të mësuarit, në të cilin marrin pjesë aktorë dhe faktorë të caktuar, përbëhet nga mësuesi dhe nxënësi. Dy anët e pandara të këtij procesi janë mësimdhënia dhe mësimnxënia.

Të nxënës realizohet nën drejtimin e mësuesit, si dhe në mënyrë të pavarur nga vetë nxënësit. Të nxënës është një proces i motivuar. Motivimi i të nxënës është i lidhur me:

- Si mund të realizohet cilësisht procesi i të nxënës?
- Deri ku duhet të shkojë orientimi i nxënësve nga mësuesi gjatë procesit të të nxënës, gjatë punë për përvetësimin e njohurive të transmetuara?

- Si mund të bëhet procesi i të nxënit një proces i motivuar dhe nxitës?
- Nxënësi mëson ngaqë i pëlqen të nxënit e njohurive apo ngaqë ai plotëson nevojat e tij kulturore dhe arsimore?

Nga studimet dhe anketimet e ndryshme, në mësimdhënie janë përcaktuar pesë

karakteristika, tipare kryesore, të cilat kanë çuar në një mësimdhënie efektive, rezultateve, dhe këtu mund të përmendim:

- 1- Cilësia dhe qartësia në mësimdhënie, e cila ka të bëjë me kthjelltësinë e paraqitjes së mësimit ë klasë.
- 2- Llojet e ndryshme në mësimdhënie, konsiston në aftësinë që ka mësuesi i suksesshëm për të qenë krijues në orën e mësimit, duke përdorur metoda dhe teknika aktive, të ndryshme, sipas kontekstit mjedisor e mësimit. Një element i rëndësishëm në këtë drejtim është krijimi i një mjedisi mësimit tërheqës dhe nxitës për nxënësit, për të zhvilluar imagjinatën dhe kreativitetin te ta.
- 3- Orientimi në detyrën që kryen, që konsiston ë metodologjinë që ka të bëjë me orientimin për ta ndarë mësimit në mënyrë funksionale dhe konkretisht:
  - Koha e nevojshme për të reflektuar me pyetje, diskutime dhe reflektime në fazë e evokimit të mësimit; koha për të shpjeguar dhe për të kontrolluar njohuritë e reja;
  - Hartimi i teknikave të mësimdhënies, gjetja e llojeve të tyre në funksion të të mësuarit;

- Koha që është e nevojshme për punët e pavarura.  
Pra, orientimi në detyrë është adresimi i nxënësve në ato përvijime ku mësuesi e kupton se vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes së orientuar prej tij, përvetësimi i njohurive do të vijë natyrshëm dhe produktiv, nxënësi do të jetë i motivuar dhe do të ndjekë një linjë orientuese në procesin e mësimit dhe në këtë mënyrë vëmendja e tij do të jetë e organizuar e me synime të qarta.

Konceptimet bashkëkohore për procesin e të nxënësve theksojnë rolin aktiv të nxënësve në zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave. Nxënësit duhet të jenë veprimtarë aktivë në procesin e ndërtimit, zbatimit dhe vlerësimit të tyre. Vetëm kështu, njohuritë, shkathhtësitë, vlerat dhe qëndrimet do të organizohen në struktura që mundësojnë përdorimin e tyre. Kjo kërkon edhe ndryshimin e rolit të mësuesve që duhet të jenë, gjithnjë e më shumë, drejtues dhe krijues të situatave të të nxënësve.

Në procesin mësimor, është shumë e rëndësishme nxitja e nxënësve e nxënësve për të marrë pjesë aktivisht dhe ë mënyrë cilore, të logjikshme dhe krijuese. Kjo ka të bëjë me aftësinë e mësuesit për të nxitur, për të gjallëruar orën e mësimit, në mënyrë që nxënësit të ndjehen pjesë e raportit subjekt – objekt i procesit mësimor.

Në praktikën e përditshme mësimore, nga mësuesit mendohet që nxitja ka të bëjë vetëm me teknikat nxitëse të të pyeturit, por ka nxënës që janë të aftë për t'u aktivizuar në dhënien e përgjigjeve për pyetje të ndryshme, por ka edhe nxënës, të cilët edhe pse mund ta dinë përgjigjen, kanë emocion dhe hezitojnë të përgjigjen.

Nxitja e nxënësve për të marrë gjallërisht në procesin mësimor, nis që ë krijimin e një klime nxitëse e motivuese në klasë. Mjedisi në klasë, i krijuar nga mësuesit, duhet të jetë në funksion të motivimit të nxënësve dhe të pasqyrohet ë qëndrimin e tyre aktiv në procesin e të nxënësve. Muzika është një faktor nxitës shumë i frytshëm për procesin e të nxënësve.

4- Shkallët e suksesit të nxënësve në vite dhe në sesione të ndryshme mësimore, që ka të bëjë me shkalën e të kuptuarit të njohurive.

Pa një harmoni midis orientimit në detyrë dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësve, nuk mund të ketë sukses të nxënësve. Mësuesi duhet të jetë i qartë dhe duhet të krijojë raporte të drejta me nxënësve dhe hap pas hapi ai duhet të nxitë, të kultivojë interesimin e nxënësve si individ dhe i grupuar.

Tipar themelor i mjeshtërisë pedagogjike, i mjeshtërisë në mësimdhënie është edhe motivimi i nxënësve në procesin e mësimin, në pjesëmarrjen e tyre aktive në të gjithë veprimtarinë e shkollore. Motivimi është një nga bazamentet e suksesit të njeriut e aq më tepër në shkollë, kur ai e shtyn atë drejt suksesit.

Motivimi ndikohet nga:

- a- Motivimi i brendshëm;
- b- Motivimi i jashtëm;
- c- Shpresa për sukses.

Mësuesi i suksesshëm duhet të bazohet në tri pyetje kryesore, konkretisht:

1- Cili është shkaku që e nxit një njeri të bëjë një veprimtari:

2- Cila është forca që e nxit njeriun energjikisht drejt qëllimit?

3- Çfarë e bën njeriun të këmbëngulë në përpjekjet e tij për të arritur qëllimin?

Detyra kryesore e mësuesit është të ndërtojë orë mësimi funksionale në drejtim të të nxënësve.

Në çdo orë mësimi, mësuesi orienton veten dhe nxënësit se cila metodë është më frytdhënëse, bën një skemë se si duhet ta realizojë orën e mësimit që të nxënësve të jetë produktiv dhe në zbatim të objektivave shkollore.

Tipar dallues i mësimdhënies, si një veprimtari e organizuar, është procesi i emërtuar planifikim. Vendimet e mësuesit në planifikim janë kryesore për të hartuar orë mësimore të suksesshme, pasi vetëm në këtë mënyrë ai siguron një strukturë të qartë të planifikimit mësimor.

Për të përgatitur një mjedis nxënësor sa më nxitës, mësuesi, jo vetëm që duhet të zotërojë anën shkencore të lëndës, por duhet të perceptojë dhe të kuptojë nevojat e nxënësve e nxënësve, pra:

- Të dijet stilet e nxënësve;
- Zellin e tyre për mësim;
- Konceptet e tyre për veten;

Mbi bazën e metodave mësimore, mësuesi merr edhe:

- Ritmin e përshtatshëm për materialin që do të mësohet;
- Mënyrën e parashtrimit të materialit;
- Organizimin dhe menaxhimin e klasës;
- Përzgjedhjen e materialeve të mësimdhënies. Kjo do ishte në themel të mësimdhënies efektive për integritet ndërlëndor.

### ***2.5.2. Veçoritë e arsimit fillor (klasat I - V)***

Arsimi fillor është niveli i sistemit arsimor, që shtrihet nga klasa e parë deri në klasën e gjashtë, ku përvojat mësimore në shkollë kontribuojnë për kalimin gradual nga të nxënit përmes lojës, në të nxënit më të sistemuar të nxënësve. Puna edukativo-arsimore përqendrohet në përvetësimin e shkrim-leximit themelor, matematikës elementare, njohjes së mjedisit natyror e shoqëror të rrethinës, elementet e edukimit estetik dhe fizik në kontekstin e vendosjes së një baze të shëndoshë për zhvillimin njohës, socio-emocional dhe motorik.

Në këtë nivel arsimimi, kujdes i veçantë i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv të tij për të nxënit që ndihmon zhvillimin e shprehive themelore për, ‘mësimin për të nxënë’. Realizimi i procesit mësimor bëhet në mënyrë të integruar, duke mundësuar që marrëdhënia e fëmijëve me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu të kuptohet në mënyrë sa më të plotë.<sup>10</sup>

---

<sup>10</sup> <http://masht.rks.gov.net/uploads/2017/03/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>

Veçori e arsimit fillor është se pothuaj të gjitha lëndët mësimore zhvillohen vetëm nga një mësues, i cili ka kryer studimet universitare si mësues për arsimin fillor. Ky mësues ka edhe funksionin e mësuesit kujdestar ë klasë ku jep mësim, ndryshe në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë, ku secila lëndë zhvillohet nga mësuesi specialist përkatës. Mësuesi i arsimit fillor, duke qenë që qëndron gjatë gjithë kohës me nxënësit e tij dhe zhvillon me ta pothuaj të gjitha lëndët mësimore, njih shumë mirë veçoritë individuale të secilit nxënës, zhvillimin e tyre konjitiv, emocional dhe social. Ai njih stilet e të nxënit të secilit nxënës.

Mundësia e njohjes së gjithanshme të nxënësve nga ana e mësuesit fillor, kërkon nga mësuesi gjetjen e rrugëve sa më efikase për realizimin e procesit mësimor, përmes metodave dhe teknikave mësimore nxitëse dhe motivuese, drejt një nxënie sa më produktive, duke aplikuar integrimin ndërlëndor. Integrimi ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera, e bën orën mësimore çlodhëse, zbavitëse dhe produktive, pasi ndikimi pozitiv i muzikës në gjendjen shpirtërore të nxënësve përmirëson gjendjen shpirtërore të tyre dhe çon në përmirësimin e rezultateve mësimore.

### **2.5.3. Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar dhe metodat me në qendër nxënësin**

Lëndët mësimore, duke u mësuar të ndara nga njëra-tjetra, ndikojnë që nxënësit të marrin njohuritë, t'i zhvillojnë shkathhtësitë dhe qëndrimet në mënyrë të fragmentuar (të shkëputur/parcializuar). Kështu vështirësojnë të kuptuarit proceseve të natyrës dhe të shoqërisë si një tërësi dhe në ndërvarësi. Me qëllim të integritit të këtyre aspekteve, Kurrikula Bërthamë



për klasën përgatitore dhe arsimin fillor, realizohet përmes lëndëve mësimore të integruara në fusha të kurrikulës dhe përmes mësimdhënies e nxënies së bazuar në qasjen e integruar.

Mësimdhënia dhe nxënia e integruar është në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të parapara për shkallë kurrikulare. Për t'i zbatuar me sukses kërkesat e KK-së dhe të Kurrikulës Bërthamë për KSNA 2, mësuesit përgatitorë dhe fillorë duhet të zbatojnë mësimdhënien dhe të nxënit e integruar, duke bërë:

- ndërlidhjen/korrelacionin e fushave kurrikulare/lëndëve mësimore, ku përmbajtjet e veçanta dhe të përbashkëta mësimore ndihmojnë njëra-tjetrën në zhvillimin e kompetencave kryesore për shkallë kurrikulare;
- integrimin në procesin e mësimdhënies dhe në nxënies të karakteristikave të përbashkëta të lëndëve të fushës përkatëse (p.sh., të gjuhës amtare me gjuhën angleze) apo të karakteristikave të përbashkëta të fushave kurrikulare (p.sh., të fushës *Shoqëria dhe mjedisi* me fushën *Shkenca natyrore*);
- Ndërlidhjen e mësimdhënies me temat/praktikat jetësore, ku gjërat kuptohen natyrshëm se si funksionojnë në natyrë dhe shoqëri.
- Ndërlidhjen e mësimdhënies më përvojat e nxënësve, gjë që ndihmon ndërtimin më të lehtë të dijes duke vazhduar mbi atë që nxënësit dinë dhe bëjnë.
- Trajtimin e çështjeve (temave) ndërkurrikulare përmes secilës fushë kurrikulare duke i ndërlidhur rezultatet e të nxënit me tema ndërkurrikulare apo përmes projekteve të përbashkëta ndër-fushore- ndërlëndore.

- Aktivitete me nxënës që të zhvillojnë kompetencat për të gjetur dhe për të përpunuar informata në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme, për shfrytëzimin e mësimit elektronik, të teknologjive aktuale dhe të ardhshme në epokën digjitale;
- Aktivitete me nxënës që promovojnë perspektivën e mësimit tërëjetësor (gjatë gjithë jetës), të cilat i ndihmojnë nxënësit që të zhvillojnë kompetencat e tyre për t'u ballafaquar me sfidat dhe mundësitë brenda zhvillimeve në shoqërinë dhe në ekonominë e sotme dhe të ardhshme.

Integrimi ndërlëndor nënkupton lidhjen e pashkëputshme të komponentëve edukativë brenda një lëmi mësimor. Kur nxënësit mësojnë shkrim – leximin muzikor, ata shfrytëzojnë edhe aftësi të tjera, të cilat ndërlidhen me inteligjencën gjuhësore. Kjo mund të jetë arsyeja pse mësimi muzikor në moshë të vogël është i shoqëruar me aftësi të përshpejtuara të leximit, të përparimit në matematikë e në fusha të tjera.

Në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, integrimi ndërlëndor arrin efektivitetin e tij në të nxënit e nxënësve, me anë të mësimdhënies bashkëkohore, ku nxënësi vihet në qendër të orës mësimore, ndryshe nga mësimdhënia tradicionale, ku mësuesi shpjegonte dhe nxënësi ishte një dëgjues pasiv. Mësuesi bashkëkohor drejton dhe menaxhon orën mësimore, duke e nxitur nxënësin ta ndërtojë vetë të nxënit.


Dallimet ndërmjet mësimdhënies bashkëkohore dhe mësimdhënies tradicionale<sup>11</sup>

---


<sup>11</sup> Doracaku “Zhvillimi i Shkathtësive të Shekullit 21 në klasat me nxënësin në qendër”, ne [http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/06/21-st-Century-Classroom\\_shq1.pdf](http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/06/21-st-Century-Classroom_shq1.pdf)

| Mësimdhënia tradicionale  | Mësimdhënia bashkëkohore   |
|---|--|
| -Theksi është në mësimdhënësin dhe mësimdhënien.                                    | -Theksi është edhe në nxënësin edhe në mësimdhënësin me theksin kryesor në mësimdhënie.  |
| -Theksi është në atë që di mësimdhënësi për lëndën.                                 | -Theksi është në të mësuarit e nxënësve si të mësojnë dhe si të gjejnë informata.  |
| -Mësimdhënësi flet; nxënësit dëgjojnë.  | -Mësimdhënësi ofron model; nxënësit ndërveprojnë me mësimdhënësin dhe me   |
|   | njëri-tjetrin.   |
| -Nxënësit punojnë vetëm.  | -Nxënësit punojnë në çifte, në grupe, apo të vetëm varësisht nga qëllimi i aktivitetit.  |
| -Mësimdhënësi monitoron dhe përmirëson secilën përgjigje nga nxënësi.               | -Nxënësit flasin pa monitorim të vazhdueshëm të mësimdhënësit;<br><br>mësimdhënësi ofron informatë kthyesë përmirësim kur parashtrohen pyetje. |
| -Mësimdhënësi u përgjigjet pyetjeve të nxënësve në lidhje me temën apo përmbajtjen. | -Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të njëritjetrit, duke shfrytëzuar mësimdhënësin apo internetin si burim i informatave.                         |
| -Mësimdhënësi i zgjedh temat.   | -Nxënësit kanë mundësi të zgjedhin një pjesë të temave.  |

|   |  |
|---|--|
| -Mësimdhënësi vlerëson dhe evoluon të nxënëit e nxënësve. | -Nxënësit e vlerësojnë të nxënit e vetvetes; mësimdhënësi gjithashtu vlerëson dhe evoluon. |
| -Klasa është e qetë dhe ka rregull.                       | -Klasa shpesh herë është e zhurmshme dhe plot aktivitet.                                   |



Metodat e mësimdhënies me në qendër mësuesin



Metodat e mësimdhënies me në qendër nxënësin

**2.5.4. Planifikimi në planin ditor të mësuesit i integritit ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera, në orë mësimore të lëndëve të ndryshme.**

Për një mësimdhënie të suksesshme, duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë planifikimit të orës së mësimit përmes planifikimit ditor apo të ditarit nga mësuesi. Vitet e fundit mësuesve u janë prezantuar modele të ndryshme të planit ditor, si:

- Plani ditor i hartuar mbi bazën e objektivave të arritjeve.
- Plani ditor i hartuar mbi bazën e kompetencave të nxënit.

Gjithashtu, struktura të ndryshme të planit ditor, si:

Plani ditor i hartuar sipas strukturave:

1- ERR (Evokim – Realizim – Reflektim).

Evokimi është ajo fazë e orës së mësimit në të cilën pasqyrohet informacioni që sjell nxënësi, burime e shfrytëzuara për të marrë informacionin, mënyrat dhe metodat e prezantimit të njohurive që kërkohen).

Realizimi është ajo fazë e orës së mësimit që pasqyron prezantimin e materialit të ri mësimor, metodat dhe teknikat e përdorura për të arritur që të kuptohen njohuritë e reja nga nxënësit.

Realizimi është ajo fazë e orës së mësimit që pasqyron zbatimin e njohurive të marra në ushtrime të ndryshme për të arritur përpunimin e informacionit të ri.

2- PNP (Parashikim – Ndërtim i njohurive – Përforcim)

Në fazën e parashikimit nxënësve u kërkohet të mendojnë

dhe të bëjnë pyetje për temën që do të mësohet. Në fazën e ndërtimit të njohurive, n drejton nxënësit të bëjnë pyetje, të

zbulojnë, të kuptojnë materialin, t'u përgjigjen pyetjeve të mëparshme dhe pyetjeve të reja. Në fazën e përforcimit, nxënësit duhet të reflektojnë për ato që kanë mësuar,

të vërejnë si kanë ndryshuar mendimet e tyre të mendojnë se ç'farë kuptimi ka mësimi për ta.

3- Struktura me të mësuarin me kompetenca, me tre fazat:

- Lidhja e njohurive të mëparshme me njohuritë paraprake;
- Ndërtimi i njohurive të reja;
- Demonstrimi dhe prezantimi i rezultateve të arritura nga nxënësit.

Pavarësisht ndryshimeve në emërtim të pjesëve përbërëse të strukturës së planit ditor, në themel të hartimit të tij pasqyrohet në mënyrë të detajuar e gjithë veprimtaria mësimore që do të zhvillohet brenda orës së mësimit për temën e dhënë.

Mësuesi, në konceptimin e planit ditor të mësimit, do të ketë parasysh materialin mësimor që do të zhvillojë në klasë, të gjithë komponentët e duhur për të arritur që ky material të përthithet nga nxënësi, duke u finalizuar me ndërtimin e të nxënësit nga nxënësit.

Planifikimi me kujdes nga mësuesi i metodave dhe teknikave efikase, për çdo hallkë të strukturës së mësimit do të jetë në përputhje me natyrën e materialit mësimor, me nivelet e arritjeve të nxënësve, si dhe me stilet e të nxënësve të tyre.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i planifikimit të orës së mësimit është nevoja për të qenë fleksibël, në lidhje me zbatimin dhe përmbushjen e objektivave. Kur në klasë paraqitet situata që dikton ndryshimin e veprimtarive të parashikuara, nuk ka rëndësi pastaj si është

përgatitur plani, por parësore është si të veprohet në situatën e re të krijuar. (Musai, 2003, 84)

Në “Metoda të mësimdhënies” (Grup autorësh, 1999: 64) thuhet se veprimtaritë hyrëse janë të domosdoshme pasi përgatisin veprimtaritë zhvilluese që do të pasojnë. Në veprimtaritë hyrëse ju mund të zhvilloni ushtrime përsëritëse e përmbledhëse, të tregoni objektivat e mësimit të ri ose ndonjë veprimtari tjetër motivuese.

Që përmes mësimdhënies të ndodhë të nxënit, është e rëndësishme që ndodhitë e mësimit të marrin parasysh ndodhitë e të nxënit, përfshirjen aktive të nxënësve në procesin e të nxënit. (Musai, 2003: 86). Këto duhet të merren parasysh nga mësuesit në përgjithësi, sidomos ga mësuesit kur hartojnë planin ditor për orë mësimore të integruara mes lëndëve. Një integrim i tillë mund të jetë edhe integrimi i muzikës me lëndët e tjera.

Më poshtë paraqitet një plan ditor, ku është planifikuar integrimi mes muzikës dhe leximit.

Klasa: 5

Lënda: Lexim

Tema mësimore: O malet e Shqipërisë Objektivat

e përgjithshëm:

- Kultivimi i pasionit për të lexuar.



- Kultivimi i atdhedashurisë të nxënësit.

Objektivat specifikë:

- Të lexojnë në mënyrë shprehës – emocionale poezinë.
- Të nxjerrin kuptimin e poezisë.
- Të shkruajnë një tekst të shkurtër në prozë ose në vargje në bazë të fjalëve kyçe.

Metodologjia: meditim rreth këngës në sfond, turi i galerisë, diskutim, punë e pavarur

Mjetet mësimore: teksti “Leximi 5”, CD me këngë për Atdheun, fletore

Lidhja me fusha të tjera: Histori, Muzikë  
Zhvillimi i mësimimit

Evokimi (Meditim rreth këngës në sfond)

Vendos në sfond këngën “Shqipëri, o Nana ime”, kënduar nga Gezim Nika.<sup>12</sup> Reflektim

rreth këngës:

- Ju pëlqeu kënga?
- Çfarë teme trajton?

---

<sup>12</sup> <https://www.youtube.com/ëatch?v=5EYPtyDBKr0>

- Kush i ka shkruar vargjet e kësaj kënge?

### Realizimi

Prezantimi i temës së re të mësimit.

Leximi shprehës – emocional i poezisë “O malet e Shqipërisë” nga mësuesi ose nxënës të zgjedhur.

Punimi i pyetjeve të aparatit pedagogjik për të zbërthyer kuptimin e poezisë.

### Reflektimi

Punë e pavarur: Bëni një krijim artistik (në vargje ose në rreshta), duke u bazuar në fjalët kyçe: Atdhe, jam, mërgim, mall, diell, lot etj.

Turi i galerisë: Ekspozimi i punimeve të nxënësve në murin e klasës. Nxënësit lexojnë punët e njëri – tjetrit dhe veçojnë 3-4 punimet më të bukura.

Konkluzioni i orës së mësimit.

Në orën e mësimit që do të prezantohet në vijim, muzika planifikohet për t’u vendosur në sfond si frymëzim për nxënësit për punën e pavarur

### **2.5.5.Faktorët që ndikojnë në të nxënit produktiv**

Mësuesi është aktori kryesor i suksesit të mësimdhënies. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i tij mbetet kusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve të synuara. Për këtë arsye, kurrikula, veçanërisht, ajo e arsimit bazë, kërkon ndryshimin e formimit fillestar të mësuesve, nëpërmjet rinovimit të kurrikulës së shkollave të larta e universitare dhe ndryshimin e sistemit të formimit dhe trajnimit të mësuesve.

Sipas Pettijohn, të mësuarit konjitiv nënkupton se, për të marrë vendime në lidhje me sjelljen e tij, individi përdor strukturat mendore dhe kujtesën. Të mësuarit:

Së pari, nënkupton një ndryshim relativisht të përhershëm; së dyti, nënkupton një ndryshim në sjelljen e individit ose në aftësinë për të manifestuar një sjellje të caktuar; së treti, të mësuarit është rezultat i përvojës në mjedis. (Pettijohn , 1996, 194)

Mësimdhënia është produktive kur të nxënit e nxënësve ndryshon pozitivisht nga ditë në ditë, kur nxënësi arrin që të nxënit ta ndërtojë vetë dhe jo ta marrë atë të gatshëm nga mësuesi. Mësimdhënia dhe nxënia efektive:

- *siguron kompetencat për të nxënit gjatë gjithë jetës.* Aftësia për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese, aftësia për të përballuar situata problemore, për të menaxhuar informacionin, shprehitë e punës së pavarur individuale ose në grup, vetëvlerësimi etj., janë thelbësore për të siguruar këtë lloj të nxëni.

- *bazohet në bindjen se çdo nxënës mund të jetë i suksesshëm.* Mësimdhënia që nxit zhvillimin e kompetencave siguron *kushtet* dhe *situatat* e të nxënit për të gjithë nxënësit.

▪ *bazohet në njohuritë paraprake të nxënësve dhe e planifikon të nxënit mbi bazën e tyre.*

Njohuritë paraprake të nxënësve janë kusht jo vetëm për përvetësimin e njohurive të reja,

por edhe për realizimin e një mësimdhënieje ndërvepruese.

▪ *planifikohet për rezultate të nxëni që synojnë kompetencat.* Mësuesi saktëson rezultatet e pritshme të nxënësve të tij mbi bazën e kërkesave të gjithanshme të kurrikulës. ▪ *aftëson*

*nxënësit të përdorin njohuritë.* Aftësimi i nxënësve për të përdorur njohuritë dhe shkathtësitë e fituara duhet të jetë synimi kryesor i procesit të mësimdhënies dhe të nxënit

në shkollë.

▪ *siguron partneritetin mësues-nxënës në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit.* Ky partneritet rrit motivimin e nxënësve dhe krijon klimën dhe kushtet e domosdoshme për

shfrytëzimin e njohurive dhe përvojave të nxënësve dhe mësuesve.

▪ *mbështetet në situata të nxëni reale ose të ngjashme me realitetin.* Ajo mundëson përzgjedhjen dhe përdorimin e situatave që hasen në jetën e përditshme, që nga jeta vetjake, familjare, shoqërore e deri tek e vendit, rajonit e më gjerë *bazohet në parimin e integritit lëndor*, i cili pasqyron integrimin e dijeve njerëzore, të cilat kurrikula e zbatuar merr përsipër t'i zhvillojë. Në këtë mënyrë, mësimdhënia efektive kultivon të menduarit ndërnlëndor.

▪ *përshkohet nga parimi i përzgjedhjes.* Ajo vë në përdorim forma të larmishme të veprimtarive mësimore, si: përmbajtje të veçanta kurrikulare, detyra të diferencuara, projekte, burime informacioni etj., që sigurojnë realizimin e këtij parimi. ▪ *zhvillohet mbi bazën e burimeve të shumëllojshme të informacionit.* Qëmtimi në burime alternative

informacioni, përveç tekstit shkollor, është kusht i rëndësishëm për përvetësimin më të mirë të koncepteve dhe metodave dhe aftëson nxënësit për të nxënë gjatë gjithë jetës, për të përzgjedhur informacionet në mënyrë kritike. ■*mbështetet në TIK*. Të nxënit nëpërmjet TIK-ut luan rol të rëndësishëm në metodat e mësimdhënies. Shkollat duhet të eksplorojnë jo vetëm mundësitë e përdorimit të TIK-ut për të mbështetur mënyrat e mësimdhënies, por edhe hapësirat e tij, për të krijuar mënyra të

reja e të ndryshme të nxëni.

■*përfshin sistematikisht nxënësit në eksperimente e vëzhgime*, për njohjen jo vetëm të natyrës, por edhe të shoqërisë.

#### **2.5.6.Krijimi i mjedisit motivues**

Motivacionet mund të përcaktohen si gjendje hipotetike në gjirin e organizmit, që aktivizojnë sjelljen dhe shtojnë organizmin drejt një qëllimi të caktuar.

Tipar thelbësor i mjeshtërive mësimdhënëse, i përfshirë në krijimin e mjedisit pozitiv të klasës, është kujdesi që duhet bërë për motivimin e nxënësve në mësim. Motivimi paraqitet si diçka që i jep nxitje, energji dhe drejtim sjelljes së njeriut. Forca e motiveve ndryshon edhe sipas situatave.

Sipas profesor Musai (2003), motivimi paraqitet në tri versione: motivim i brendshëm, motivim i jashtëm dhe shpresa për sukses. Motivimi i brendshëm ka të bëjë me shkallën në të cilën nxënësit merren me një veprimtari, me qëllim që të plotësojnë ose të kënaqin kuriozitetin dhe interesin e tyre në drejtim të temës së dhënë apo të zhvillojnë aftësitë e tyre

në marrëdhënie me kërkesat e bëra, për të mirën e tyre. Strategjitë dhe metodat që mbështeten në motivimin e brendshëm të nxënësit përmbajnë tema të përzgjedhura, që paraqesin interes për nxënësit, sidomos nëse ato janë të lidhura me përvojën e vetë nxënësve. Motivimi i jashtëm ka të bëjë me tërheqjen në një veprimtari, me qëllim që të arrihen disa qëllime apo synime, të cilat shpërblehen dhe nga mjedisi i jashtëm ndaj detyrës. Strategjitë dhe metodat që mbështeten në motivimin e jashtëm të nxënësve përfshijnë përpjekjen për të lidhur suksesin me shpërblimet materiale dhe privilegjet. Strategjitë dhe metodat që ndërtohen mbi shpresat e nxënësve për sukses përfshijnë sigurinë që detyrat e caktuara janë nxitëse dhe u ofrojnë nxënësve mundësi reale të suksesit, duke marrë parasysh aftësitë e tyre dhe nivelin e njohurive të mëparshme. (Musai, 2003: 216219)

#### **2.5.6.Strategjitë e të nxënësve produktiv përmes mësimdhënies integrale**

Strategjitë e të nxënësve që nxisin përfshirjen e nxënësve dhe çojnë në nivele më të larta atë që mësohet në fillim (përmes përsëritjeve, testeve, vlerësimeve, kontrollit të dijeve dhe përfshirjes aktive në projekte të ndryshme të të nxënësve), bëjnë të mundur që njohuritë të mbahen mend për një kohë të gjatë. (Woolfolk, 2011: 253)

Në shkollë nxënësit kanë interesa të ndryshme mësimore, siç janë të ndryshme edhe interesat e njerëzve në jetë. Interesat janë veçori të rëndësishme psikologjike të personalitetit të njeriut që formohen si rezultat i ndërgjegjësimit, i shndërrimit në motive të brendshme të kërkesave, qëllimeve, detyrave që shtron një mjedis i caktuar shoqëror para individit. (Hajdaraga, 1988: 22)

Në përmbajtjen e interesave mësimore integrohen edhe motivet, dëshirat, qëllimet, idealet që kërkon të realizojë nxënësi në veprimtarinë mësimore – edukative. Struktura dhe përmbajtja e interesave kushtëzohen nga niveli i përgjithshëm i zhvillimit psikosocial të nxënësit në një moshë të caktuar nga kërkesat, qëllimet, aspiratat që kërkon të realizojë mikromjedisi social, shkolla, familja ku bën pjesë nxënësi, nga niveli i formimit të personalitetit të tij në periudha mohore të ndryshme. (Hajdaraga, 1988: 12)

Interesat ndihmojnë në pasurimin, zgjerimin e horizontit mendor e kulturor të nxënësit, ndikimi i tyre në formimin e botëkuptimit, bindjeve dhe personalitetit të tij është kaq i rëndësishëm saqë në psikologjinë bashkëkohore theksohet se ato përbëjnë bazën rreth së cilës zhvillohet procesi i formimit të personalitetit.

Nga një cikël shkollor në tjetrin, interesat njohëse, bashkë me ato mësimore, zgjerohen dhe pasurohen vazhdimisht me elemente të reja.

Struktura dhe përmbajtja e interesave mësimore (shkollore) zhvillohet krahas zgjerimit, thellimit e pasurimit të vazhdueshëm të brendësisë së procesit mësimor nga një klasë në tjetrën, zbatimit të një teknologjie të përparuar mësimore, përvetësimit të thellë e të qëndrueshëm të njohurive, të koncepteve, ligjeve e kategorive shkencore në disiplina të ndryshme shkollore. (Hajdaraga, 1988: 23)

Formimi dhe zhvillimi i interesave shkollore, ndikohet edhe nga shumë faktorë të tjerë, ndër të cilët personaliteti i mësuesit, përgatitja e tij, aftësitë organizuese e drejtuese të tij në procesin mësimor – edukativ, tipi i marrëdhënies mësues – nxënës në një periudhë të dhënë,

veprimtaritë jashtëshkollore që zhvillohen në ndihmë të procesit mësimor, përdorimi në procesin mësimor i një informacioni të pasur e të shumëllojshëm që vjen e integrohet organikisht në përmbajtjen e lëndëve mësimore, etj. (Hajdaraga, 1988, 23)

Për të arritur integrimin ndërlëndor, mes muzikës dhe lëndëve të tjera, mësuesit duhet të përdorin metoda dhe teknika mësimore nxitëse dhe motivuese për nxënësit, duke parashikuar paraprakisht në planin ditor, në etapat e ndryshme të tij, në përfaqje të tematikave mësimore që trajtohen, futjen e elementeve muzikore, të tilla si: këngë ilustruese të temave mësimore, melodi qetësuese dhe nxitëse të kreativitetit të nxënësit. Kjo, pasi një nxënës i motivuar fiton dije dhe shprehi të reja më shpejt se ai që nuk është i motivuar. Nëse mësuesi nuk arrin të kapë interesat dhe imagjinatën e nxënësve duke tërhequr vëmendjen e tyre, ai ka humbur pjesën tjetër të mësimin. Pavarësisht nga fakti sa e rëndësishme mund të duket përmbajtja ose sa të aftë janë nxënësit, nëse interesat e tyre nuk nxiten gjatë etapave mësimore, ata nuk ndihmohen për të kuptuar përmbajtjen e lëndës.

(Musai, 2003: 87)

Krijimi i situatave ideale për mësimin optimal dhe të menduarin fleksibël, mund të jetë çelësi për të bërë integrimin ndërlëndor. Muzika ndihmon kujtesën. Shumë njerëz shpesh kujtojnë ritmin, melodinë më mirë sesa shpjegimin e zakonshëm. (Falioni, 1993: 98) Ëallace (1994), i cili hulumtoi rreth rikujtimit të teksteve, vuri re se kur një tekst shoqërohet me muzikë, kujtohet më mirë se kur i njëjti tekst mësohet pa asnjë melodi. (Ëallace, 1994, 73-1474)



Metodologjia e përdorur duhet t'i përshtatet nevojave të nxënësve. Ashtu sikur ai sjell shprehi vetjake në situatat mësimore, ashtu edhe çdo nxënës hyn në klasë me dëshira, interesa, aftësi dhe përvoja të ndryshme. Përzgjedhja e veprimtarive të të nxënës bëhet duke pasur parasysh:

1. Natyrën e materialit mësimor;
2. Tipin e të nxënësve;
3. Nivelin dhe nevojat e nxënësve;
4. Gjendjen e bazës materiale didaktike të klasës/shkollës. (Musai, 2003: 92)

Detyra e mësuesit është t'i tërheqë nxënësit në veprimtari të tilla që, në një farë mënyre, t'i çojë ata tek dëshira për të mësuar.

## **METODOLOGJIA E PËRDORUR NË STUDIM**

Metodologjia e përdorur në këtë studim ka pasur për qëllim hulumtimin rreth ndikimit të ndërlidhjes së edukatës muzikore me lëndët e tjera brenda orëve të ndryshme të mësimin.

“Qëllimi i metodologjisë është që të na ndihmojë për të kuptuar, në aspektin më të gjerë të mundshëm, jo produktet e kërkimit shkencor, por vetë procesin” (Cohen, Manion & Morrison, 2000: 45).

Ky studim synon të hedhë dritë mbi rëndësinë e integritit ndërlëdor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera, brenda orëve të ndryshme të mësimin, në lëndë të ndryshme mësimore.

Ky studim synoi t’u përgjigjet pyetjeve kërkimore dhe të testojë hipotezën e ngritur, të parashtruara në kapitullin e parë, rreth të cilave ndërtohet studimi.

Për të realizuar këto synime të këtij studimi, është përzgjedhur metoda sasiore kërkimore.

Në këtë kapitull janë trajtuar përshkrimi i metodave që janë përdorur në kë të hulumtim dhe arsyeja e përzgjedhjes së tyre. Gjithashtu, në kë të studim janë trajtuar instrumentet e mbledhjes së të dhënave, etika e përdorur dhe kufizimet që lidhen me kë të studim.

### **3.1.Përshkrimi i studimit**

Studimi është shtrirë në periudhën kohore 2017 – 2018, gjatë së cilës puna është përqendruar kryesisht në:

- Hartimin dhe zhvillimin e pyetësorëve me mësuesit e Ciklit Fillor dhe nxënësit e klasave të pesta në komunën e Gjilanit, Kamenicës dhe të Vitisë, në regjionin e Anamoravës, në Kosovë.
- Përpunimin e të dhënave të marra nga anketimi me mësuesit dhe nxënësit e përzgjedhur për kampionimin dhe nxjerrjen e përfundimeve të studimit dhe hartimin e rekomandimeve drejtuar specialistëve të fushës së arsimit.

### **3.2.Burimet e referimit**

Për këtë studim, kanë shërbyer këto burime referimi:

- 1- Literatura bashkëkohore shqiptare dhe e huaj, ku janë trajtuar:
  - Çështje të zhvillimit të individit në fëmijërinë e mesme;
  - Çështje të rëndësisë së edukimit muzikor në shkollë;
  - Çështje të rëndësisë së integritit ndërlëndor në shkollë.
- 2- Gjetjet e marra përmes anketimit me mësuesit që japin mësim në Arsimin Fillor, dhe nxënësit e klasave të pesta, të regjionit të Anamarovës, ë Kosovë.

### **3.3.Metodat dhe instrumentet**

Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura për këtë studim synojnë mbledhjen e të dhënave sasiore rreth ndikimit të muzikës në zhvillimin emocional dhe konjitiv të nxënësve, si dhe rëndësinë që ka ndërlidhja e muzikës me lëndët e tjera në orën mësimore.

Për të matur rëndësinë që ka përdorimi i muzikës në orën e mësimi në lëndë të ndryshme, si integrim ndërlëndor, është përdorur si instrument matës pyetëtori.

Synimi i pyetëtorit të përdorur për këtë studim ka qenë mbledhja e të dhënave paraprakisht të strukturuar, me përgjigje të renditura sipas shkallës Likert (gjithmonë; shpeshherë; ndonjëherë; asnjëherë).

### **3.4. Besueshmëria e instrumentit**

Në këtë rubrikë, do të trajtohen analizat, të cilat janë bërë me qëllim të matjes së besueshmërisë së shkallëve, të cilat janë përdorur në instrument. Në këtë aspekt, për matjen e besueshmërisë, është përdorur koeficienti i Alfës së Kronbahut, duke përfshirë të dy pyetëtorët.

Më poshtë paraqitet tabela e besueshmërisë të këtij testi, dhe duke ditur që me një nivel 0.5 një pyetësor, testi fillon të quhet i besueshëm.

Pyetëtori i parë i aplikuar me mësuesit, i cili mat integrimin ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore, ka dalë Cronbach Alpha me një vlerë 0.66, çfarë tregon besueshmëri të moderuar:

### Reliability Statistics

| Cronbach's Alpha | N of Items |
|------------------|------------|
| .661             | 25         |

Tab.Instrumenti i aplikuar me mësuesit

- Për instrumentin e dytë të aplikuar me nxënësit ka dalë Cronbach Alpha me një vlerë 0.72, çfarë tregon besueshmëri të moderuar:

### Reliability Statistics

| Cronbach's Alpha | N of Items |
|------------------|------------|
| .721             | 7          |

Tab.Instrumenti i aplikuar me nxënësit

### 3.5.Pilotimi i instrumentave

Instrumentet që janë përdorur për të marrë të dhënat e nevojshme për testimin e hipotezave të ngritura për këtë studim dhe pyetjeve kërkimore, janë pilotur fillimisht përpara aplikimit të tyre në fazën përfundimtare. U përzgjedhën 10 mësues që japin mësim në Arsimin Fillor, në klasën e pestë, në Gjilan dhe 10 nxënës të shkollës “Abaz Ajeti”, në komunën e Gjilanit.

Pilotimi u realizua për këto arsye:

- Për të testuar kuptueshmërinë e termave dhe logjikën e fjalive të pyetësorëve.
- Për të matur kohën që duhet për të administruar këta pyetësorë.

Pas pilotimit, u rishikua mënyra e të shprehurit të pyetjeve dhe të pohimeve tek instrumentet, duke u bazuar në pyetjet që bënin mësuesit dhe nxënësit për kuptimin e tyre gjatë plotësimit, rishikime të cilat u morën në konsideratë për aplikimin e instrumentave në fazën përfundimtare.

Nga pjesëmarrësit u kërkua që për pyetjet e instrumenteve të jepnin përgjigje sa më të vërteta. Duhet të theksohet se gjatë procesit të plotësimit të instrumentit nga ana e pjesëmarrësve, nuk pati ndonjë shqetësim apo ngacmues të jashtëm, që mund të ndikonin në këtë proces. Gjithashtu, plotësimi i instrumentit nga ana e pjesëmarrësve u krye në mënyrë të pavarur, ku secili pjesëmarrës plotësoi në mënyrë individuale instrumentat.

Pas përfundimit të fazës së aplikimit të pyetësorëve, me gjithë kampionin e përzgjedhur, studiuesja falenderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre.

### **3.6.Procedura për mbledhjen e të dhënave sasiore të studimit**

Të dhënat sasiore për këtë studim janë mbledhur në periudhën Nëntor 2018 - Mars 2018. Me kërkesë e marrë nga Departamenti i Edukimit pranë Universitetit Europian të Tiranës, janë kontaktuar Drejtoritë Komuale të regjionit të Anamoravës, respektivisht në komunat Gjilan, Kamenicë dhe Viti, ku është paraqitur kërkesa për kryerjen e studimit në shkollat

filllore të këtij regjioni. U është bërë i ditur fusha e studimit, qëllimi i studimit, ruajtja e etikës gjatë studimit, me nxënësit dhe mësuesit.

Pas këtij hapi, janë kontaktuar drejtuesit e shkollave të përzgjedhura për studim. Gjithashtu edhe këtyre u është sqaruar qëllimi i studimit, ruajtja e etikës gjatë studimit, me nxënësit dhe mësuesit.

Hapi tjetër i ndërmarrë ka qenë kontaktimi me mësuesit dhe nxënësit. Nxënësit, për shkak të moshës së tyre minore, janë kontaktuar në praninë e psikologut të shkollës.

U është bërë e ditur subjekteve ruajtja e anonimatit të të dhënave të deklaruara nga këta në vullnet të lirë.

Të dhënat e marra nga pjesëmarrësit u mblodhën dhe u hodhën në *database* për t'u përpunuar më tej në programin statistikor SPSS.

### **3.7.Përzgjedhja dhe përshkrimi i kampionimit**

Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe për të testuar hipotezën e ngritur për këtë studim, për hulumtimin u ngritën 2 kampionë: një kampion me mësues që japin mësim në Arsimin Fillor të regjionit të Anamarovës dhe një kampion me nxënës të klasave të pesta (në komunën e Gjilanit, të Kamenicës dhe të Vitisë). Duke ju referuar popullatave të studimit, u përzgjedhën dy kandidate respondentësh, respektivisht, qoftë duke iu referuar qasjes kërkimore sasiore, qoftë duke iu referuar qasjes kërkimore cilësore.

Fillimisht u morën të dhëna për të ditur popullatën nga ku do të merrej kampioni. Të dhënat u morën edhe për mësuesit që japin mësim në shkollat fillore të tre komunave të lartpërmendura, edhe për numrin e nxënësve të klasave të pesta.

Të dhënat u siguruan në Drejtorinë Komunale Arsimore në komunën e Gjilanit, Kamenicës dhe Vitisë. Nga të dhënat e siguruar rezultoi se në regjionin e Anamoravës, në të tria komunat, japin mësim 140 mësues në klasat e pesta në shkollat fillore. Respektivisht, 74 mësues në komunën e Gjilanit, 40 mësues në komunën e Vitisë dhe 26 mësues në komunën e Kamenicës.

Gjithashtu, u siguruan të dhënat rreth numrit të përgjithshëm të nxënësve që mësojnë në klasën e pestë. Nga të dhënat e marra, rezultoi se në klasën e pestë, në vitin shkollor 2017 – 2018, mësonin 2375 nxënës.

Pasi u siguruan të dhënat rreth popullatës së mësuesve, u planifikua kampionimi me të cilin u morën të dhënat. Modeli i përzgjedhje së kampionimit të përdorur është modeli i shtresëzuar. Faza e parë e kampionimit përfshiu përzgjedhjen e shkollave ku do të kryhej studimi. Përzgjedhja e shkollave u bazua në përfaqësimin proporcional, bazuar në variablin shkolla urbane dhe shkolla rurale.

Faza e dytë e kampionimit të përdorur përfshiu përzgjedhje e mësuesve që jepnin mësim në klasat e pesta të Arsimit Fillor të regjionit të Anamoravës, në të tria komunat, qoftë për kampionin që u përdor për studimin sasior, qoftë për kampionin që u përdor për studimin cilësor. Edhe përzgjedhja e mësuesve ishte e qëllimshme, vetëm mësuesit e klasave të pesta,



duke ruajtur edhe për këtë përfaqësimin proporcional të tyre për të tria komunat, në mënyrë që përfaqësimi të ishte i shtrirë pothuaj në të gjithë popullatën e mësuesve që jepnin mësim në klasat e pesta të Arsimit Fillor të regjionit të Anamoravës.

Faza e tretë e kampionimit përfshiu përzgjedhje e nxënësve, qoftë për kampionin që u përdor për studimin sasior, qoftë për kampionin që u përdor për studimin cilësor. Përzgjedhja ishte e qëllimshme, pasi nxënësit u përzgjedhën vetëm nga klasat e pesta. Kjo pjesë e hulumtimit u shtri te nxënësit e klasave të pesta, pasi kjo është grupmosha më e madhe dhe pyetësorin mund ta kuptonin më lehtë, krahasuar me nxënësit e klasave më të ulëta. Një arsye tjetër e përzgjedhjes së qëllimshme të nxënësve të klasave të pesta ishte fakti se pasi nxënësi përfundon klasën e pestë, përfundon ciklin e Arsimit Fillor.

Mësuesit e Arsimit Fillor kanë marrë njohuri të përgjithshme, në studimet universitare, për të gjitha disiplinat që zhvillohen ë Arsimi Fillor dhe secili mësues jep mësim në të gjitha lëndët, përfshirë këtu edhe muzikën, një mundësi kjo shumë e mirë për të realizuar integrimin ndërlëndor ndërmjet muzikës dhe lëndëve të tjera dhe anasjelltas.

Kampioni kryesor i studimit ishte kampioni me mësuesit që jepnin mësim në klasat e pesta. Synimi i studimit ishte i tillë, që të shikohej rëndësia e integritit ndërlëndor ndërmjet muzikës dhe lëndëve të tjera, në orë të ndryshme mësimore, sa një integrim i tillë realizohej nga mësuesit, pasi studimet e ndryshme dëshmojnë ndikimin pozitiv të muzikës në gjendjen emocionale të njeriut.

Kampioni i marrë me nxënësit e klasave të pesta është një kampion në përqindje të vogël, krahasuar me popullatën e nxënësve, pasi nga nxënësit ka qenë synimi të merrej një perceptim se si e shihej nga ta kryerja e veprimtarive të ndryshme mësimore në prani të muzikës.

Pra, për këtë hulumtim, kampioni i mësuesve të klasave të pesta, me të cilët u zhvilluan anketat, përbëhej nga 59 % e popullatës. Nga këta, për sa i përket shkollës ku jepnin mësim, 40 % e numrit të përgjithshëm e mësuesve që jepnin mësim në zonat urbane, ndërsa 60 % e numrit të përgjithshëm të mësuesve që jepnin mësim në zonat rurale.

Për sa i përket gjinisë së mësuesve që morën pjesë në anketim, 71 % ishin femra, nga të cilat 34% në zonat rurale dhe 37% në zonat urbane, dhe 29 % ishin meshkuj, nga të cilët 4% në zonat urbane dhe 25% në zonat rurale.

Për sa i përket vjetërsisë në punë të mësuesve që morën pjesë në studim, 34 % i përkisnin grupit me nga 5 – 10 vite eksperiencë pune si mësues, 40 % i përkisnin grupit me nga 10– 15 vite eksperiencë pune si mësues dhe 26 % i përkisnin grupit me mbi 20 vite eksperiencë pune si mësues.

Kampioni i nxënësve u përzgjedh nga popullata prej 2375 nxënësish të klasave të pesta, të regjionit të Anamoravës. Kampioni i përdorur për studim, përbëhej nga 3 % e popullatës. Nga këta, 67 % mësonin në zonat urbane dhe 33 % mësonin në zonat rurale.

Në përbërje të këtij kampioni, 60 % e numrit të përgjithshëm ishin femra dhe 40 % ishin meshkuj.

Studimit iu shtuan intervistat gjysmë të strukturuar me mësues dhe nxënës. Kështu që përveç respondentëve me të cilët u zbatua qasja sasimore, në studim u përzgjedhën respondentë edhe për qasjen cilësore: (a) respondentë nxënës, me të cilët u zhvilluan intervista gjysmë të strukturuar, dhe (b) respondentë mësues, me të cilët u zhvilluan intervista gjysmë të strukturuar.

Duke ju referuar popullatave të studimit, u përzgjedhën dy kampione respondentësh, që i referohen qasjes kërkimore cilësore.

Kampioni i mësuesve (N= 10), me të cilët u zhvilluan intervista gjysmë të strukturuar, u përzgjedh në mënyrë të qëllimshme. Kështu u përzgjedhën mësuesit e Ciklit të Ulët, që jepnin mësim në klasat e pesta, në regjionin e Anamoravës, në Kosovë .

Kampioni i nxënësve (N= 10), me të cilët u zhvilluan intervista gjysmë të strukturuar u përzgjedh në mënyrë të qëllimshme.

### **3.8.Hartimi i pyetësorëve**

Për të hulumtuar rreth pyetjeve kërkimore “Si ndikon në të nxënët e nxënësve integrimi ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore, a e rrit produktivitetin e orës mësimore, në lëndë të ndryshme, aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit dhe sa realizohet integrimi i muzikës ë orën e mësimit në lëndë të ndryshme nga mësuesit e Ciklit Fillor në regjionin e Anamoravës?” dhe për të testuar hipotezë se “Integrimi ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore ndikon pozitivisht në gjendjen shpirtërore të nxënësve dhe rrit produktivitetin e orës së mësimit”,

është hartuar një pyetësor për mësuesit e Ciklit Fillor dhe një pyetësor për nxënës të klasave të pesta, dy grupet e përbashkëta të procesit të mësimdhënies – mësimnxënies në orën e mësimi.

➤ Hartimi i pyetësorit të zhvilluar me mësuesit

Ky pyetësor përmban katër sesione:

Në sesionin e parë, pyetësori i zhvilluar me mësuesit e Ciklit Fillor ka informacion lidhur me të dhënat demografike, si: gjininë, arsimimin, vjetërsinë në punë si mësimdhënës, si dhe shkollën ku pjesëmarrësit japin mësim (në zonat urban apo ë zonat rurale).

Në sesionin e dytë, pohimet janë organizuar rreth rëndësisë së zhvillimit të lëndës së Edukatës muzikore në shkollë, për krijimin e atmosferës së hareshme në klasë dhe ndikimin që kjo ka në zhvillimin emocional dhe social të nxënësve.

Sesioni i tretë të pyetësorit, përmban pyetje rreth rëndësisë së integritit ndërlëndor në orë të ndryshme mësimore të muzikës me lëndët e tjera.

Sesioni i katërt i pyetësorit, përmban pyetje me synimin për të hulumtuar se sa realizohet nga mësuesit e Arsimit Fillor integrimi ndërlëndor i Edukatës muzikore me lëndët e tjera, në orë të ndryshme mësimore.

➤ Hartimi i pyetësorit të zhvilluar me nxënësit

Ky pyetësor përmban dy sesione.

Sesioni i parë përmban të dhënat demografike, si: gjinia dhe shkolla ku pjesëmarrësit mësojnë (në zonat urban apo në zonat rurale).

Sesioni i dytë përmban pyetje rreth marrëdhënies që nxënësit kanë me muzikën, sa muzika i frymëzon ata në veprimtaritë mësimore gjatë orës së mësimi.

### **3.9. Etika e përdorur në studim**

Gjatë punës sonë hulumtuese është kujdesur që të ruhet etika e hulumtuesit.

Gjatë gjithë procesit të punës hulumtuese në terren, janë ndërmarrë disa hapa.

Për të zhvilluar anketimin me nxënësit, për shkak të moshës së tyre minorene, por edhe të mësuesve të shkollave fillore, pas marrjes së kërkesës nga UET, u mor leja nga Drejtoritë Arsimore Komunale të të tre komunave, Gjilanit, Kamenicës dhe Vitisë, si dhe nga drejtoritë e shkollave përkatëse, duke iu shpjeguar qëllimin e realizimit të studimit në vija të përgjithshme, si dhe ruajtjen e konfidencialitetit dhe anonimatit qoftë për nxënësit, ashtu edhe për mësuesit që morën pjesë në studim.

U sigurua nga Drejtoritë Komunale Rajonale të këtyre komunave të dhënat për popullatën e nxënësve të klasave të pesta, sipas secilës shkollë të këtyre komunave. Gjithashtu nga Drejtoritë Komunale Rajonale të këtyre komunave u sigurua të dhënat e duhura për studimin për mësuesit e Ciklit Fillor.

Për realizimin e studimit u respektuan çështjet etike të cilat lidhen me:

*a) Lejen e informuar të subjektit*

Subjektet, (kampioni i mësuesve të Arsimit Fillor dhe kampioni i nxënësve të klasave të pesta, në rajonin e Anamarovës) fillimisht u informuan për studimin, dhe pasi pranuan pjesëmarrjen në parim, u informuan në mënyrë të detajuar në lidhje me qëllimin, kushtet dhe metodën e studimit, që do të përdorej, si dhe ku konsistonte ndihma e tyre. Pjesëmarrësve ,që në fillim, i është bërë e qartë, natyra vullnetare e pjesëmarrjes në studim dhe se mund të tërhiqeshin nga studimi, nëse nuk kishin dëshirë të merrnin pjesë në të, pa administruar ende instrumentat me ta. Nuk kishte asnjë rast që nuk pranoi të ishte pjesë e studimit.

*b) Konfidencialiteti*

Personave që morën pjesë në studim, iu bë e ditur se të dhënat e mbledhura prej tyre do të përdorëshin vetëm për qëllime studimi dhe se do të respektohej parimi i anonimitetit dhe konfidencialitetit.

*c) Shmangia e keqpërdorimit të të dhënave*

Subjekteve të përfshirë në këtë studim iu bë i ditur qëllimi i vërtetë i studimit, pa i keqpërdorur të dhënat e marra prej tyre. Pjesëmarrësit u njohën me faktin se rezultatet që do të dilnin nga ky studim, do të përdorëshin vetëm për qëllime studimore.

Respektimi i këtyre parimeve etike, u bë një nga çështjet më të rëndësishme të këtij studimi në sigurimin e gjetjeve dhe asnjë e dhënë personale e marrë nga nxënësit dhe mësuesit nuk është publikuar. Të dhënat janë përdorur për qëllime studimi.

### **3.10.Vështirësitë dhe kufizimet e hulumtimit**

Synimi i studimit ka qenë të hulumtohet rreth ndërlidhjes së edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera brenda orës së mësimit në lëndë të ndryshme, në mënyrë që të bëhet integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera dhe ora e mësimit të jetë sa më nxitëse dhe motivuese për të nxënësit e nxënësve.

Në këtë studim është përpjekur të hulumtohet rreth këndvështrimit të mësuesve të Ciklit Fillor që japin mësim në klasat e pesta, mbi lidhjen ndërmjet muzikës dhe zhvillimit emocional dhe social të nxënësve. Gjithashtu, është përpjekur të hulumtohet rreth realizimit të integritetit ndërlëndor të edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera, nga këta mësues, me qëllim rritjen e produktivitetit të orës së mësimit.

Ky studim nuk merr përsipër të studiojë të gjithë faktorët që ndihmojnë në rritje e produktivitetit të orës së mësimit.

Pavarësisht se pyetjet ishin të strukturuar, në këtë studim një kufizim mund të jetë edhe niveli i besueshmërisë së përgjigjeve të të anketuarve, pasi në këtë studim u përdorën vetëm instrumente matës të natyrës vetëraportuese e kjo përbën një tjetër kufizim, ku supozohet se subjektet që kanë bërë këtë vetëraportim, të jenë përgjigjur me sinqeritet.

Një nga vështirësitë e hasura është pamundësia për të marrë në studim një gamë më të gjerë pjesëmarrësish. Meqenëse studimi është studim lokal, jo kombëtar, kampioni i mësuesve është i përbërë nga 58 % e popullatës dhe kampioni i nxënësve është i përbërë nga 3 % e popullatës. Kjo përqindje e ulët e pjesëmarrësve për kampionimin e nxënësve shpjegohet duke marrë në konsideratë fokusin e studimit, mund të përbëjë një nga kufizimet e punimit.

## **KAPITULLI IV : ANALIZA E TË DHËNAVE**

Rezultatet e gjetura përmes hulumtimit në terren janë organizuar sipas pjesëmarrësve dhe variablave të studimit.

### ***4.1. Analizat statistikore***



Në këtë kapitull të punimit, pasqyrohen rezultatet e gjetura nëpërmjet anketimit të mësuesve dhe nxënësve, për të parë ndikimin që ka muzika te nxënësit dhe rëndësinë e integritit të edukatës muzikore me lëndët e tjera në orën e mësimit, për krijimi e një mjedisi sa më pozitiv për nxënësit, në dobi të zhvillimit emocional, të zhvillimit social dhe konjitiv të tyre.

Në këtë kapitull marrin përgjigje pyetjet kërkimore të ngritura në fillim të studimit:

- Si ndikon në të nxënit e nxënësve integrimi ndër-lëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore ?
- A e rrit produktivitetin e orës mësimore, në lëndë të ndryshme, vendosja e muzikës në sfond aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit ?
- Si ndikon në gjendjen psikologjike të nxënësve muzika në orën e mësimit ?
- A motivohen nxënësit për të mësuar ose punuar në një mjedis me muzikë në sfond ?

Në këtë kapitull, gjithashtu, testohet hipoteza kërkimore e ngritur për realizimin e këtij studimi: Duke aplikuar elementet muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme, rritet produktiviteti i orës mësimore.

Gjithashtu, përmes analizës së të dhënave të marra përmes anketimit, në këtë kapitull do të shikohet edhe vërtetësia ose jo e hipotezës nul: Aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme nuk ka asnjë ndikim në produktivitetin e orës së mësimit.

Për të analizuar të dhënat e studimit, u përdor paketa statistikore e shkencave sociale (SPSS, 20 ). Për të testuar supozimet statistikore mbi shpërndarjen normale, u përdorën analizat descriptive. Për të testuar hipotezën dhe për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore, u përdorën analizat deskriptive dhe analiza korrelacionale.

#### **4.1.2. Analiza përshkruese e të dhënave**

Më poshtë është pasqyruar analiza descriptive e të dhënave të përfitura nga mësuesit dhe nxënësit e marrë në studim.


Instrumentat e hartuar dhe të përdorur për realizimin e këtij punimi, duke pasur parasysh hipotezën kryesore kërkimore dhe hipotezën nul, si dhe pyetjet kërkimore, kërkojnë mundësi për realizimin e analizave përshkruese të gjetjeve të përfituara. Statistikat deskriptive (përshkruese) japin një tablo të qartë dhe konkrete mbi rëndësinë e integritit ndërlëndor të edukatës muzikore me lëndët e tjera në shkollë. Për të testuar hipotezën e studimit, është realizuar dhe korrelacioni Pearson.

#### **4.2.1. Të dhënat përshkruese për mësuesit sipas variablit zonë urbane- zonë rurale**

Nga të dhënat e grafikut të mëposhtëm vihet re që mësuesit në zona urbane e realizojnë më shpesh integrimin ndërlëndor të edukatës muzikore me lëndët e tjera në krahasim me mësuesit në zona rurale. Kjo mund të vijë edhe për pasojë se në zonat rurale mësuesit nuk disponojnë bazën materiale të nevojshme për realizimin e këtij integrimi.

Më konkretisht 22 % e mësuesve në zona rurale e realizojnë ndonjëherë integrimin ndërlëndor me edukimin muzikor dhe 78 % e mësuesve në zona urbane e realizojnë shpesh integrimin ndërlëndor me edukimin muzikor.

**Graf. Statistika deskriptive mbi realizimin e integritit ndërlëndor zonë urbane – zonë rurale**




#### **4.2.2. Të dhënat përshkruese për mësuesit sipas variablit gjini femër-mashkull**

Në kampionin e përzgjedhur në studim vihet re se mësuesit e gjinisë mashkullore janë më të pakët në numër në krahasim me gjinë femërore. Kjo shpjegoet dhe me faktin se gjinia femërore është më e prirur drejt mësuesisë si profesion dhe se ky profesion njihet si “profesion femëror” .


Një gjetje interesante e studimit është se në zona rurale ka më tepër mësues të gjinisë mashkullore në krahasim me zonat urbane.

**Graf.Statistika deskriptive të mësuesve të gjinisë femërore zona urbane – rurale**



Më konkretisht nga grafiku i mësipërm rezulton se 82 % e mësuesve të gjinisë femërore në zona urbane e realizojnë integrimin ndërlëndor dhe 18 % e mësuesve të gjinisë femërore në zona rurale.

**Graf.Statistika deskriptive të mësuesve të gjinisë femërore zona urbane – rurale**




Më konkretisht nga grafiku i mësipërm rezultojnë se 18 % e mësuesve të gjinisë mashkullore në zona urbane e realizojnë integrimin ndërlëndor dhe 82 % e mësuesve të gjinisë mashkullore në zona rurale.

#### 4.2.3. Të dhënat përshkuese përmbljedhëse për mësuesit sipas variablit vjetërsi në punë

- Graf. Statistika deskriptive mbi realizimin e integrimit ndërlëndor zonë urbane – zonë rurale

## Realizojnë integrimin e edukimit muzikor me lëndët e tjera

- Mësues me 5-10 vite eksperience ne pune
- Mësues me 10-15 vite eksperience ne pune
- Mësues me mbi 20 vite eksperience ne pune



Më konkretisht nga grafiku i mësipërm rezulton Integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera realizohet nga 57 % e mësuesve me 5-10 vite, 33 % e mësuesve me 10-15 vite eksperiencë dhe vetëm 10 % e mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë. Pra nga statistikat përshkruese të përfutuara vihet re se mësuesit me 5-10 vite eksperiencë e realizojnë më shumë integrimin ndërlëndor të muzikës me lëndët e tjera. Kjo mund të shpjegohet me faktin se brezi I dekadës së fundit punon me metodat më bashkëkohore.

Më poshtë janë pasqyruar analizat deskriptive të aplikimit të pyetësorit si instrument i përdorur në studim me mësuesit, për të matur rëndësinë që ka përdorimi i muzikës në orën e mësimit në lëndë të ndryshme, si instrument efektiv i integrimin ndërlëndor të lëndëve të ndryshme.

Synimi i pyetësorit të përdorur për këtë studim ka qenë mbledhja e të dhënave paraprakisht të strukturuar, me përgjigje të renditura sipas shkallës Likert (gjithmonë; shpeshherë; ndonjëherë; asnjëherë).

- Statistika deskriptive për pohimin “Lënda e edukatës muzikore krijon atmosferë të hareshme”.

| Valid |            | Mësues me 5-10 vite eksperiencë në punë |         |               | Mësues me 10-20 vite eksperiencë në punë |         |               | Mësues me mbi 20 vite eksperiencë në punë |         |               |
|-------|------------|---|---------|---------------|--|---------|---------------|---|---------|---------------|
|       |            | Frequency                               | Percent | Valid Percent | Frequency                                | Percent | Valid Percent | Frequency                                 | Percent | Valid Percent |
|       | Gjithmonë  | 23                                      | 28.04 % | 28.04         | 22                                       | 26.82 % | 26.82         | 9   | 10.97 % | 10.97         |
|       | Shpesh     | 5                                       | 6.09 %  | 6.09          | 11                                       | 13.41 % | 13.41         | 12  | 14.63 % | 14.63         |
|       | Ndonjëherë | 0                                       | 0 %     | 0             | 0  | 0 %     | 0             | 0   | 0 %     | 0             |
|       | Asnjëherë  | 0                                       | 0 %     | 0             | 0  | 0 %     | 0             | 0   | 0 %     | 0             |
|       | Total      | 28                                      | 34.13 % | 34.13         | 33                                       | 40.23 % | 40.23         | 21  | 25.60 % | 25.60         |

Në tabelën e mësipërme janë pasqyruar gjetje interesante në lidhje me korrelacionin midis eksperiencës në punë të mësuesve dhe njohjes dhe vlerësimit të rëndësisë së lëndës së

Edukatës muzikore në krijimin e atmosferës pozitive në klasë, në orën e mësimit. Nga të dhënat, shihet se:

- 28.04 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “gjithmonë”;
- 26.82 % e kampionit të mësuesve me 10- 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “gjithmonë”;
- 10.97 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “gjithmonë”;
- 6.09 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “shpesh”;
- 13.41 % e kampionit të mësuesve me 10- 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “shpesh”;
- 14.63 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “shpesh”;
- 0 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.



|       |            | Mësues me 5-10 vite eksperiencë në punë |         |       |         | Mësues me 10-20 vite eksperiencë në punë |         |       |         | Mësues me mbi 20 vite eksperiencë në punë |         |       |         |
|-------|------------|---|---------|-------|---------|--|---------|-------|---------|---|---------|-------|---------|
|       |            | Frequency                               | Percent | Valid | Percent | Frequency                                | Percent | Valid | Percent | Frequency                                 | Percent | Valid | Percent |
| Valid | Gjithmonë  | 5                                       | 6.09 %  | 6.09  | 5       | 6.09 %                                   | 6.09    | 1     | 1.21 %  | 1.21                                      |         |       |         |
|       | Shpesh     | 20                                      | 24.39 % | 24.39 | 22      | 26.82 %                                  | 26.82   | 8     | 9.75 %  | 9.75                                      |         |       |         |
|       | Ndonjëherë | 3                                       | 3.65 %  | 3.65  | 6       | 7.31 %                                   | 7.31    | 12    | 14.63 % | 14.63                                     |         |       |         |
|       | Asnjëherë  | 0                                       | 0 %     | 0     | 0       | 0 %                                      | 0       | 0     | 0 %     | 0   |         |       |         |
|       | Total      | 28                                      | 34.14 % | 34.14 | 33      | 40.24 %                                  | 40.24   | 21    | 25.60 % | 25.60                                     |         |       |         |

- 0 % e kampionit të mësuesve me 10- 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”;

Në mënyrë të përmblodhur në Tabelën 2, në të cilë është pasqyruar frekuenca e përgjigjeve të ndryshme për pyetjen “Lënda e edukatës muzikore krijon atmosferë të hareshme”,

konstatohet se:

1. 0 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”;

2. 0 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “asnjëherë”;

3. 0 % e kampionit të mësuesve me 10-20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “asnjëherë”;

4. 0 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.

Këto konstatime tregojnë se lënda e edukatës muzikore vlerësohet gat ë gjithë mësuesit, pavarësisht eksperiencës së tyre si mësime dhënë.

- Statistika deskriptive për pohimin “Lënda e edukatës muzikore nxit kureshtjen e nxënësve”.

Nga analizimi deskriptiv i të dhënave të marra nga mësuesit në lidhje me korrelacionin ndërmjet edukatës muzikore dhe nxitjes së kreativitetit të nxënësve, konstatohen rezultate pozitive për sa i përket qëndrimeve të mësuesve për këtë

çështje. Kështu:

- 6.09 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “gjithmonë”;
- 6.09 % e kampionit të mësuesve me 10- 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “gjithmonë”;
- 1.21 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “gjithmonë”;

- 24.39 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “shpesh”;
- 26.82 % e kampionit të mësuesve me 10- 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “shpesh”;
- 9.75 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “shpesh”;

3.65 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”;

- 7.31 % e kampionit të mësuesve me 10- 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”;

- 14.63 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”;

- 0 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “asnjëherë”;

- 0 % e kampionit të mësuesve me 10-20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “asnjëherë”;

- 0 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “asnjëherë”;

➤ Statistika deskriptive për pohimin “Lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm. “

|  | Mësues me 5-10 vite eksperiencë në punë |         |       |         | Mësues me 10-20 vite eksperiencë në punë |         |       |         | Mësues me mbi 20 vite eksperiencë në punë |         |       |         |
|--|---|---------|-------|---------|--|---------|-------|---------|---|---------|-------|---------|
|  | Frequency                               | Percent | Valid | Percent | Frequency                                | Percent | Valid | Percent | Frequency                                 | Percent | Valid | Percent |
|  |   |         |       |         |  |         |       |         |   |         |       |         |

|       |            |    |            |       |    |            |       |    |            |       |
|-------|------------|----|------------|-------|----|------------|-------|----|------------|-------|
| Valid | Gjithmonë  | 5  | 6.09<br>%  | 6.09  | 5  | 6.09<br>%  | 6.09  | 0  | 0 %        | 0     |
|       | Shpesh     | 23 | 28.04<br>% | 28.04 | 26 | 31.70<br>% | 31.70 | 16 | 19.51<br>% | 19.51 |
|       | Ndonjëherë | 0  | 0 %        | 0     | 2  | 2.43<br>%  | 2.43  | 5  | 6.09<br>%  | 6.09  |
|       | Asnjëherë  | 0  | 0 %        | 0     | 0  | 0 %        | 0     | 0  | 0 %        | 0     |
|       | Total      | 28 | 34.14<br>% | 34.14 | 33 | 40.24<br>% | 40.24 | 21 | 25.60<br>% | 25.60 |

Nga tabela e statistikave deskriptive të mësipërme rezulton se :

- 6.09 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur se gjithmonë lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm;
- 6.09 e kampionit të mësuesve me 10- 20 vite eksperiencë janë përgjigjur se gjithmonë lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm;
- 0 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur se gjithmonë lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm
- 28.04 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur se shpesh lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm;
- 31.70 % e kampionit të mësuesve me 10- 20 vite eksperiencë janë përgjigjur se shpesh lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm;

- 19.51 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur se shpesh lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm;
  - 0 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur se ndonjëherë lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm;
  - 2.43 % e kampionit të mësuesve me 10- 20 vite eksperiencë janë përgjigjur se ndonjëherë lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm;
  - 6.09 % e kampionit të mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë janë përgjigjur ndonjëherë lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm;
  - 0 % e kampionit të mësuesve janë përgjigjur se asnjëherë lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm;
- Statistika deskriptive për pohimin “Lënda e edukatës muzikore zhvillon kreativitetin e nxënësve. “

| Valid |           | Mësues me 5-10 vite<br>Eksperiencë në punë |         |       |         | Mësues me<br>10-20<br>vite eksperiencë në<br>punë |         |       |         | Mësues me mbi 20<br>vite eksperiencë në<br>punë |         |       |         |
|-------|-----------|--|---------|-------|---------|---|---------|-------|---------|---|---------|-------|---------|
|       |           | Frequency                                  | Percent | Valid | Percent | Frequency   | Percent | Valid | Percent | Frequency                                       | Percent | Valid | Percent |
|       | Gjithmonë | 18   | 21.95   | 21.95 | 19      | 23.17   | 23.17   | 8     | 9.75    | 9.75  |         |       |         |
|       |           |  | %       |       |         | %   |         |       | %       |   |         |       |         |

|            |    |            |       |    |            |       |    |             |       |
|------------|----|------------|-------|----|------------|-------|----|-------------|-------|
| Shpesh     | 9  | 10.97<br>% | 10.97 | 10 | 12.95<br>% | 12.95 | 12 | 14.6<br>3 % | 14.63 |
| Ndonjëherë | 1  | 1.21<br>%  | 1.21  | 4  | 4.87<br>%  | 4.87  | 1  | 1.21<br>%   | 1.21  |
| Asnjëherë  | 0  | 0 %        | 0     | 0  | 0 %        | 0     | 0  | 0 %         | 0     |
| Total      | 28 | 34.14<br>% | 34.14 | 33 | 40.24<br>% | 40.24 | 21 | 25.6<br>0   | 25.60 |

- 21.95 % e kampionit të mësuesve me 5- 10 vite eksperiencë janë përgjigjur me alternativën “gjithmonë”;
Për të qartësuar marrëdhënien e integrimit të muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme – produktivitetit të orës mësimore, tek mësuesit dhe nxënësit e përfshirë në studim, u përdor analiza e korrelacionit Pearson r.



**Koeficientët e korelacionit Pearson, tregojnë se ka marrëdhënie pozitive të moderuar midis integritit të muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme – produktivitetit të orës mësimore, tek mësuesit (  $r=0.39$  për sa i përket Integrimi i muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme dhe  $r = 0.45$  produktiviteti i orës së mësimit ), për sa i përket dhe nxënësve të përfshirë në studim rezulton se koeficiente korelacionale  $r$  është e përfshirë në studim(  $r=0.36$  për sa i përket integritit të muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme dhe  $r = 0.41$  produktiviteti i orës së mësimit ).**

**Tab. Marrëdhënia midis integritit të muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme – produktivitetit të orës mësimore, tek mësuesit dhe nxënësit e përfshirë në studim.**

*Pearson correlaton table.*

|        | <b>Integrimi i muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme</b> | <b>Produktiviteti i orës së mësimit</b> |
|--------|--|---|
| Mësues | 0.39 <sup>**</sup>   | 0.45 <sup>**</sup>                      |
| Nxënës | 0.36 <sup>**</sup>   | 0.41 <sup>**</sup>                      |

*Shënim: \*\*  $p < 0,01$ .*

Edukimi muzikor i ofron mundësi nxënësit të zhvillojë ndjesinë për ritmin, harmoninë etj, si dhe të arrijë gjendjen fizike të nevojshme për aktivitetin muzikor. Këngët me tema për botën bimore dhe shtazore mundësojnë, nga njëra anë formësimin dhe zgjerimin e nocioneve të fëmijës për botën e nga ana tjetër zhvillohen aftësitë muzikore të tij. Shqiptimi i tingujve, fjalës dhe fjalisë ka mundësi të realizohet përmes këngës në grup, asaj

individuale etj, apo përmes rrëfimit të përrallave, tregimeve apo ngjarjeve nga jeta e përditshme e fëmijës. Vargjet me rimë janë të afërta me fushën e muzikës. Aktivitetet ritmike si lëvizja me ritëm, ecja sipas ritmit, harmonia e ligjërit dhe lëvizjes etj, ndihmojnë për t'u zhvilluar aftësia e dallimit të ritmit, melodisë dhe harmonisë së shqiptimit të drejtë të tingujve dhe rimës. Muzika instrumentale mund të integrohet përmes dramatizimit të teksteve letrare dhe jo letrare. Aktivitetet në fushën e muzikës gërshetohen edhe me artin figurativ. Nxënësit me kënaqësi vizatojnë dhe modelojnë lulet, shpendët, kafshët etj, të cilave u dedikohet kënga.

Integrimi ndërfaqësor, pra i edukimit muzikor dhe fushave të tjera edukative mundëson zhvillimin dhe edukimin më të natyrshëm e tërësorë të nxënësit.

#### **4.5. Analiza cilësore**

Rezultatet e analizës cilësore u gjeneruan nga të dhënat e përftuara nga zhvillimi i intervistave gjysmë të strukturuar me mësues dhe me nxënës.

Pyetjes: A e pëlqejnë nxënësit muzikën?, të gjithë mësuesit pohuan se nxënësit mezi e presin orën e muzikës, e cila i bën më të hareshëm, më të shoqërueshëm me njëri - tjetrin, më aktivë. Muzika i jep dinamikë procesit mësimor.

*Nuk ka orë muzike që nxënësit të mos e presin me qejf. Aq të përfshirë janë në këtë orë*

*mësimi, sa që mërzi të kur bie zilha e përfundimit të orës. (mësuese)*

Gjithashtu të gjithë nxënësit e intervistuar pohuan se e pëlqenin muzikën, e cila i bën të ndjehen shumë mirë.

Duke krahasuar të dhënat e përftuara nga respondentët mësues me të dhënat e përftuara nga respondentët nxënës, arrijmë në të njëjtin rezultat, se lënda e muzikës konsiderohet si lënda më e dashur për nxënësit për vetë ndikimin pozitiv që muzika ka në përmirësimin e gjendjes shpirtërore të njeriut.

Në lidhje me pyetjen: A vendosni në klasë, në sfond, muzikë për të krijuar atmosferë pozitive për nxënësit tuaj? Si ndihen nxënësit në situata të tilla?, mësuesit e intervistuar pohojnë se në raste të veçanta vendosin muzikë në sfond, për të krijuar gjendje shpirtërore pozitive për nxënësit. Nxënësit ndjehen më të relaksuar dhe më të shoqërueshëm me njëri - tjetrin në orët mësimore ku aplikohet vendosja e muzikës në sfond. Pjesa më e madhe e mësuesve të intervistuar u shprehën se më shumë raste muzikën e vendosin në sfond në orën e edukatës figurative dhe në atë të edukimit fizik.

*Ky integrim është shumë i përshtatshëm për fëmijët, se me kombinimin e pikturës dhe muzikës krijohet një atmosferë e këndshme për nxënësit. (mësuese)*

*Një vjershe të caktuar mundohemi që me ja përshtat dhe një muzikë duke e përcjellë gjatë recitimit dhe vërej që nxënësit ndjehen të motivuar, të gjithë shprehen lirisht për temën e vjershës. (mësuese)*

Gjithashtu nxënësit pohojnë se ndonjëherë mësuesit vendosin në klasë muzikë ose këndojnë së bashku këngë, edhe në orë të tjera mësimore, por, nga ana tjetër, ata u shprehën se do donin që kjo gjë të ndodhte më shpesh.

*Do të doja që çdo ditë të këndojmë, vallëzojmë ose të dëgjojmë muzikë. (nxënës)*

Duke krahasuar të dhënat e përftuara nga respondentët mësues me të dhënat e përftuara nga respondentët nxënës, arrijmë në përfundimin që, për të ndryshuar gjendjen shpirtërore të nxënësve, është e domosdoshme vendosja e muzikës në sfond në klasë, pasi jo gjithmonë realizohet.

Pyetjes: Sipas mendimit tuaj, a duhet të realizohet ndërlidhja mes lëndëve, pasi kurrikula e re parasheh që ndërlidhja e lëndëve të realizohet në orë të ndryshme mësimore?, mësuesit e

intervistuar janë të mendimit se është e nevojshme të realizohet në orë të ndryshme mësimore integrimi ndërlëndor ndërmjet lëndëve të ndryshme mësimore dhe muzikës.

*Për mendimin tim duhet patjetër të realizohet, pasi që kur lëndët gërshetohen mes veti ora mësimore bëhet më interesante, nxënësit bëhen me kreativ si dhe krijohet një atmosferë me e këndshme në klase. (mësues)*

*Mendoj që nëse lëndet ndërlidhen në këtë rast edukata muzikore me lende të tjera edhe ora mësimore do jete me atraktive dhe do ketë me shume laramani gjë që do jete dhe për vete nxënësin me interesante! (mësuese)*

*Mendoj që po pasi që tek ta vërej një gjallëri në procesin mësimor janë më të hareshëm etj.*

Nga ana tjetër, ata janë të mendimit se jo në të gjitha orët mësimore mund të realizohet integrimi ndërlëndor ndërmjet muzikës dhe lëndëve të ndryshme mësimore. Të gjithë mësuesit pohojnë se nuk e kanë realizuar ndonjëherë dhe e shohin të vështirë realizimin e integritit ndërmjet muzikës dhe matematikës, edukatës qytetare apo dhe shoqëria dhe mjedisi.

*Në orën e matematikës nuk e kam realizuar këtë integrim, përveç ndonjë rasti kur për të ndryshuar atmosferën në klasë, kemi kënduar së bashku me nxënësit fraza kënge, për t'i çlodhur sadopak. Nuk e di në qoftë se mund të realizohet në ndonjë orë matematike, siç e realizoj p.sh në orën e leximit kur para se të kaloj të flas për një figurë historike, vendos në sfond këngë që i kushtohen kësaj figure historike. (mësuese)*

Pyetjes: A mendoni se, në lëndë të ndryshme, nxënësit e përvetësojnë më mirë temën mësimore, kur për realizimin e kësaj temë ju fusni dhe elemente muzikore?, mësuesit e intervistuar janë të mendimit se integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera, ndikon pozitivisht në zhvillimin konjitiv të nxënësve, pasi mësuesit pohojnë se për ta bërë sa më tërheqëse një orë mësimore, në mënyrë që një temë historike, një figurë historike, atdhetare apo kulturore, sidomos në lëndën e historisë dhe në lëndën e gjuhës shqipe dhe

leximit letrar, për të përvetësuar materialin mësimor të saposhpjeguar, mësuesit kanë ilustruar materialin mësimor me këngë që trajton të njëjtën temë.

Nxënësit e intervistuar, në lidhje me pyetjen se a e kuptojnë më mirë mësimin kur mësuesi/ja vendosin muzikë në sfond, gjithashtu, pohojnë se kur në orën e mësimit kanë marrë një temë mësimore, shoqëruar edhe me muzikë, me të njëjtën temë, e kanë përvetësuar më mirë.

Duke krahasuar të dhënat e përfutuara nga respondentët mësues me të dhënat e përfutuara nga respondentët nxënës, arrijmë në të njëjtin rezultat, se muzika në orën e mësimit në lëndë të ndryshme rrit efektivitetin e orës së mësimit, pasi nxënësit e përvetësojnë më mirë materialin mësimor.

*Në lëndën e historisë, sidomos, kur kemi ndonjë mësim që ka të bëjë me ndonjë figurë markante të kohës ja tregomi përmes këngëve që janë të kompozuar pikërisht për këtë!*  
(mësuese)

Në lidhje me pyetjen: A mendoni se te nxënësit nxitet fantazia dhe krijimtaria në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera?, të gjithë mësuesit e intervistuar u përgjigjën se ndërlidhja mes muzikës dhe lëndëve të tjera në orë të ndryshme mësimore ndikon pozitivisht në nxitjen e fantazisë dhe të krijimtarisë së nxënësve, pasi muzika relakson gjendjen shpirtërore të nxënësve, largon lodhjen dhe emocionet negative të ditës të ata, nxit anën krijuese të tyre. Gati të gjithë mësuesit që e kishin aplikuar integrimin e muzikës në orën e leximit letrar dhe të edukimit figurativ, kanë pohuar se nxënësit kanë qenë më kreativë dhe se orët mësimore kanë dalë shumë tërheqëse.

*Në orën e edukatës figurative shpesh vë në sfond muzikë relaksuese, dhe vërej se nxënësit bëhen më kreativë, pikturojnë më me ndjenjë. Të njëjtën gjë kam konstatuar edhe në lëndën e leximit letrar, kur kam dhënë p.sh përshkrime të natyrës apo të krijojnë vargje për natyrën, kam vënë muzikë relaksuese, muzike të qetë.* (mësuese)

Pjesa më e madhe e nxënësve, gjithashtu pohojnë se në orët që janë shoqëruar me muzikë, kanë qenë më të entuziazmuar dhe të frymëzuar për të krijuar.

*Ndërkohë që dëgjoja muzikë, edhe shkruaja. Në ato momente sikur dëgjoja këngën e zogjve.*  
(nxënëse)

Duke krahasuar të dhënat e përfutuara nga respondentët mësues me të dhënat e përfutuara nga respondentët nxënës, arrijmë në të njëjtin rezultat, muzika ndihmon nxitjen te nxënësit të fantazisë dhe krijimtarisë së nxënësve.

Në lidhje me pyetjen: A mendoni se nxënësit janë më socialë dhe interaktivë në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera?, mësuesit pohojnë se muzika ndikon edhe për socializimin e nxënësve mes njëri - tjetrit në klasë, duke e bërë orën e mësimit më bashkëpunuese, më të larmishme, më dinamike. Sidomos në orët e mësimit kur nxënësit këndojnë së bashku këngë gazmore për t'u çlodhur apo këngë me tematikë të ndryshme në përshtatje edhe me tematikën e orës së mësimit.

*Tek nxënësit çdo risi për ata është e mire sidomos me një integrim të tillë ku ata do bashkëpunojnë mes veti dhe kështu arrijnë e të jene me të bashkuar.* (mësues)

Gjithashtu nxënësit pohojnë se nën tingujt e muzikës mblidhen grupe - grupe dhe këndojnë këngë apo vallëzojnë dhe krijimi i atmosferës së tillë në klasë i bën të ndjehen mirë.

*Hera - herës mblidhemi me njëri - tjetrin dhe këndojmë dhe vallëzojmë...* (nxënëse)

Duke krahasuar të dhënat e përfutuara nga respondentët mësues me të dhënat e përfutuara nga respondentët nxënës, arrijmë në të njëjtin rezultat, muzika ndihmon në përmirësimin e klimës pozitive në klasë, duke përmirësuar aftësitë socializuese të tyre mes njëri - tjetrit.

Në lidhje me pyetjen: A jeni trajnuar për integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera?, mësuesit u shprehën se janë bërë trajnime ndërlëndore, por në drejtim të integritit mes muzikës në orët e ndryshme të lëndëve të tjera mësimore nuk kanë marrë trajnime. Gjithashtu mësuesit shprehën domosdoshmërinë e trajnimeve ku në fokus të jetë ndërlidhja mes muzikës dhe lëndëve të tjera, aplikimi i elementëve muzikore edhe në orët mësimore të lëndëve, në të cilat duket e pamundur kjo ndërlidhje ndërlëndore.

*Trajnim adekuat nuk kemi pasur vetëm cka jam bazuar në literaturën ku kam hasur! Është e nevojshme që të të bëhen trajnime për këtë ndërlidhje mes lëndësh, se me trajnime të tilla do mundësohet një realizim akoma më i mirë, një orë mësimore më atraktive, nxënës më aktivë, hapësirë e mjaftueshme ku nxënësit të shprehin anën krijuese të tyre! (mësuese)*

Si konkluzion i përgjithshëm arrihet në përfundim se rezultatet e analizës cilësore, megjithëse janë jo përfaqësuese dhe nuk mund të përgjithësohen, mbështesin rezultatet e përfutuara me anë të analizës sasiore.

#### **4.6. Testimi i hipotezës dhe i pyetjeve kërkimore**

Testimi i hipotezës synon të shikohet nëse **duke aplikuar elementet muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme, rritet produktiviteti i orës mësimore apo nuk ka ndonjë ndikim në të** . Për testimin e hipotezës u ngritën këto pyetje kërkimore:

- A e rrit produktivitetin e orës mësimore, në lëndë të ndryshme, vendosja e muzikës në sfond dhe aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit?
- Si ndikon në të nxënit e nxënësve integrimi ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore?
- Si ndikon në gjendjen psikologjike të nxënësve muzika në orën e mësimit?
- A zbatohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera mësimore, në orë të ndryshme mësimore, në lëndë të ndryshme, nga mësuesit e arsimit fillor?
- A ka lidhje mes përdorimit të metodave integruese nga mësuesit e arsimit fillor dhe vjetërsisë së tyre në punë, si mësimdhënës?

- Në cilat shkolla (urbane apo rurale) aplikohet më shumë nga mësuesit ky integrim ndërlëndor?
- Në cilat lëndë realizohet më shumë integrimi ndërlëndor i muzikës në orë të ndryshme mësimore? Në cilat realizohet më pak ose nuk realizohet?

Në produktivitetin e orës së mësimit ndikojnë shumë faktorë, objektivë dhe subjektivë . Integrimi ndërlëndor gjithnjë e më tepër, dita – ditës, shihet se ndikon pozitivisht në nxënien cilësore të nxënësve.

Për qëllimet e studimit tonë, vëmendja është përqendruar në integrimin e edukatës muzikore me lëndët e tjera. Pra, për të vërtetuar hipotezën, vëmendja është përqendruar në dy variabla: integrimi i muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme dhe rritja e produktivitetit të orës së mësimit.

Nga të dhënat e përftuara nga analiza statistikore rezulton se vërtetohet hipoteza kryesore : Hipoteza kryesore: Duke aplikuar elementet muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme, rritet produktiviteti i orës mësimore. Dhe rrëzohet Hipoteza nul: Aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme nuk ka asnjë ndikim në produktivitetin e orës së mësimit. Nga rezultatet e hulumtimit është arritur në përfundimin se është e domosdoshme që në orën e mësimit, në Cikli Fillor, në lëndë të ndryshme, të aplikohen pjesë të ndryshme muzikore në varësi të temave mësimore, për të bërë jo vetëm ndërlidhjen ndërmjet njohurive ndërlëndore, por edhe për të krijuar për nxënësit një mjedis çlodhës, nxitës dhe motivues për të nxënë të tyre. Zbatimi i muzikës në klasë mund




të ndihmojë nxënësit që të jetë shumë të motivuar dhe kreativë , duke marrë pjesë gjallërisht në orën e mësimit, drejt rritjes së performancës së tyre shkollore.

Ky punim shkencor kërkon t’u përgjigjet këtyre pyetjeve kërkimore dhe nga analizat statistikore rezulton se:

Pyetja nr.1 kërkimore : A e rrit produktivitetin e orës mësimore, në lëndë të ndryshme, vendosja e muzikës në sfond dhe aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit?

Nga rezultatet e mëposhtme të grafikut rezulton se vendosja e muzikës në sfond dhe aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit rrit produktivitetin e orës mësimore.



Për pohimin “A mendoni se orët mësimore të lëndëve të ndryshme janë më efektive nëse bëhet ndërlidhja (integrimi) me edukatën muzikore? “ 24.39 % e mësuesve të përzgjedhur

në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh” 75.60 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.

Për pohimin “A mendoni se nxënësit janë më aktivë në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera? “, 12.19 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 75.60 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 12.19 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.


Për pohimin “A mendoni se në lëndë të ndryshme, nxënësit e përvetësojnë më mirë temën mësimore, kur për realizimin e kësaj temë ju fusni dhe elemente muzikore? “, 10.97 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 75.60 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 13.41 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.

Pyetja nr.2 kërkimore : Si ndikon në të nxënët e nxënësve integrimi ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore?

Nga rezultatet deskriptive rezulton se në të nxënët e nxënësve integrimi ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore.

➤ **Tab. Rezultatet descriptive totale te pyetësorit te aplikuar me nxënësit për secilin nga variablat**

- Për pohimin “A të ka ndihmuar dëgjimi i muzikës në kryerjen e ushtrimeve apo problemave të matematikës?”, 83.33% e nxënësve të përzgjedhur në studim është



përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 16.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.

- Për pohimin “Të pëlqen të dëgjosh muzikë kur krijon vjersha ose tregime?“, 23.33 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” 55 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh”, dhe


21.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.

- Për pohimin “Të pëlqen të dëgjosh muzikë kur pikturon?“, 100 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”.

Nga rezultatet e mësipërme rezulton se në të nxënët e nxënësve integrimi ndërëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe matematikës ka pak ndikim dhe më shumë muzika ndikon në artet figurative dhe lexim.

Pyetja nr.3 kërkimore : Si ndikon në gjendjen psikologjike të nxënësve muzika në orën e mësimi?

Nga rezultatet deskriptive të grafikut rezulton se muzika ka ndikim pozitiv në gjendjen



psikologjike të nxënësve në orën e mësimit.

Për pohimin “Lënda e edukatës muzikore krijon atmosferë të hareshme“, 65.85 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” dhe 34.14 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh”.

Për pohimin “Lënda e edukatës muzikore nxit kureshtjen e nxënësve“, 13.41 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 60.97 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 25.60 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.

Për pohimin “Lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm“, 12.19 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 79.26 %


e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 8.53 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.

Për pohimin “Lënda e edukatës muzikore zhvillon kreativitetin e nxënësve“, 54.87 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 37.80 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 7.31 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.

Për pohimin “Lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më socialë“, 42.68 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 37.80 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 2.43 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.

Pyetja nr.4 kërkimore : A zbatohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera mësimore, në orë të ndryshme mësimore, në lëndë të ndryshme, nga mësuesit e arsimit fillor?

Nga rezultatet deskriptive rezulton se integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera mësimore, në orë të ndryshme mësimore, në lëndë të ndryshme, nga mësuesit e arsimit fillor zbatohet nga një pjesë e mësuesve në orë të ndryshme mësimore. Por, siç vihet re edhe nga grafiku pasqyrues, integrimi ndërlëndor pak realizohet nga mësuesit, sidomos integrimi ndërmjet muzikës dhe lëndëve të tjera mësimore.



Për pohimin : “A e realizoni integrimin ndërlëndor në klasën tuaj? “ 4.87 % e mësuesve të përgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën Gjithmone, 29.26 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 65.85 % e kampionit është përgjigjur me alternativën Ndonjehere .

Për pohimin : “A e keni realizuar integrimin ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera? “ 1.21 % e mësuesve të përgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 51.21 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 47.56 % e kampionit është përgjigjur me alternativën Ndonjehere

Pyetja nr.5 kërkimore : A ka lidhje mes përdorimit të metodave integruese nga mësuesit e arsimit fillor dhe vjetërsisë së tyre në punë, si mësimdhënës?

- **Korrelacioni i metodave integruese nga mësuesit e arsimit fillor dhe vjetërsisë së tyre në punë**

Korrelacioni i lidhjes mes përdorimit të metodave integruese nga mësuesit e arsimit fillor dhe vjetërsisë së tyre në punë, si mësimdhënës

Nga rezultatet deskriptive rezulton se ka lidhje ndërmjet përdorimit të metodave integruese nga mësuesit e arsimit fillor dhe vjetërsisë së tyre në punë, si mësimdhënës.

Përdorimi i metodave integruese nga mësuesit e arsimit fillor ka një lidhje pozitive substanciale të një niveli të ulët me vjetërsinë e mësuesve në punë 5-10 vite eksperiencë ( $r = 0.08$ ,  $p < 0.05$ ), me vjetërsinë e mësuesve në punë 10-20 vite eksperiencë ( $r = 0.23$ ,  $p < 0.01$ ), dhe me vjetërsinë e mësuesve në punë me mbi 20 vite punë ( $r = 0.31$ ,  $p < 0.01$ ).

|  | <b>Përdorimi i metodave integruese nga mësuesit e arsimit fillor</b> |
|--|--|
| 1. Mesues me 5-10 vite eksperiencë në punë   | 0.08   |
| 2. Mesues me 10-20 vite eksperiencë në punë  | 0.23   |
| 3. Mesues me mbi 20 vite eksperiencë në punë | 0.31   |

*Shënim:* \*  $p < 0.05$ . \*\*  $p < 0.01$ . \*\*\*  $p < 0.001$

Pyetja nr.6 kërkimore: Në cilat shkolla urbane, rurale aplikohet më shumë nga mësuesit integrimi ndërlëndor ? Nga analiza e statistikave të përfuara rezulton se mësuesit në zona

urbane e realizojnë më shpesh integrimin ndërlëndor të edukatës muzikore me lëndët e tjera në krahasim me mësuesit në zona rurale. Kjo mund të vijë edhe për pasojë se në zonat rurale mësuesit nuk disponojnë bazën materiale të nevojshme për realizimin e këtij integrimi. Më konkretisht 22 % e mësuesve në zona rurale e realizojnë ndonjëherë integrimin ndërlëndor me edukimin muzikor dhe 78 % e mësuesve në zona urbane e realizojnë shpesh integrimin ndërlëndor me edukimin muzikor.

Pyetja kërkimore 7: Në cilat lëndë realizohet më shumë integrimi ndërlëndor i muzikës në orë të ndryshme mësimore? Në cilat realizohet më pak ose nuk realizohet?

Përsa i përket kësaj pyetjeje kërkimore jepet një tablo më e qartë në grafikun e mëposhtëm. Integrimi ndërlëndor i muzikës në orë të ndryshme mësimore realizohet më shumë , në disa më pak e në disa nuk realizohet.

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe gjuhës shqipe në orën e gjuhës shqipe? “, 14.63 % e mësuesve të përgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh”, 42.68 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 39.02 % e kampionit është përgjigjur me alternativën Asnjehere .

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe leximit në orën e leximit?“, 51.21 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 48.78 % e kampionit është përgjigjur me alternativën ‘ndonjëherë’.



Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe matematikës në orën e matematikës?”, 1.21 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur “ndonjëherë” dhe 98.78 % e kampionit është përgjigjur me alternativën Asnjëherë.

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe historisë në orën e historisë?”, 15.85 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh”, 54.87 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 29.26 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.


Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe pikturës në orën e edukatës figurative?”, 47.56 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh”, 48.78 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 3.65 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe lëvizjes në orën e edukatës fizike?”, 2.43 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternative “gjithmonë” , 51.21 % e kampionit është përgjigjur me alternative “shpesh” dhe 46.34 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe njohurive rreth shoqërisë në orën e edukatës qytetare? “, 73.17 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 26.82 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe dukurive natyrore në orën ‘Njeriu dhe natyra’?”, 13.41 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 86.58 % e kampionit është përgjigjur me alternativën

“asnjëherë”.



#### 4.7. Zbulimi i marrëdhënies midis elementeve muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme dhe produktivitetit të orës mësimore

Duke u bazuar në rezultatet e korrelacionit në tabelën e mësipërme, vihet re që ka një marrëdhënie pozitive të rëndësishme statistikore midis **elementeve muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme dhe produktivitetit të orës mësimore.**

Studimet kanë dëshmuar se muzika ka lidhje me shumë fusha të tjera, si: gjuha, letërsia, matematika, historia, piktura, etj., ndaj një nga prioritetet e sotme të arsimit të fëmijëve

në shkollë është ndërlidhja e edukatës muzikore me lëndët e tjera përmes integritit ndërlëndor në shkollë .

Kjo ndërlidhje është pasqyruar në tabelën e mëposhtme në të cilën jepet një tablo më e qartë e statistikave descriptive të edukimit muzikor me fushat e tjera të edukimit të perceptuar nga mësuesit e marrë në studim.

Pikërisht, tek integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndë te tjera në orën e mësimit qëndron rëndësia e këtij studimi, i cili synon të sjellë strategji të ndryshme efikase të integritit të muzikës në orën e mësimit në lëndë të ndryshme.

Zbatimi i muzikës në klasë mund të ndihmojë nxënësit që të jetë shumë të motivuar dhe kreativë , duke marrë pjesë gjallërisht në orën e mësimit, drejt rritjes së performancës së tyre shkollore.

*Tab.Statistika descriptive që paraqet integrimin e muzikës me lëndët e tjera*

|  | Gjithmonë |         | Shpesh   |         | Ndonjëherë |         | Asnjëherë |         |
|--|-----------|---------|----------|---------|------------|---------|-----------|---------|
|  | Frequenc  | Percent | Frequenc | Percent | Frequenc   | Percent | Frequenc  | Percent |
| 1.A medoni se nxënësit janë më socialë dhe interaktivë në orët mësimore ku realizohet integrimi? | 16        | 20.73 % | 66       | 80.48 % | 0          | 0 %     | 0         | 0%      |

|  |   |        |    |         |    |         |    |         |
|--|---|--------|----|---------|----|---------|----|---------|
| 2.A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe gjuhës shqipe në orën e gjuhës shqipe?                 | 0 | 0 %    | 12 | 14.63 % | 38 | 42.68 % | 32 | 39.02 % |
| 3.A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe leximit në orën e leximit?                             | 0 | 0%     | 42 | 51.21 % | 40 | 48.78 % | 0  | 0%      |
| 4.A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe matematikës në orën e matematikës?                     | 0 | 0%     | 0  | 0%      | 1  | 1.21 %  | 81 | 98.78 % |
| 5.A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe historisë në orën e historisë?                         | 0 | %      | 13 | 15.85 % | 45 | 54.87 % | 24 | 29.26 % |
| 6.A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe pikturës në orën e edukatës figurative?                | 0 | 0 %    | 39 | 47.56 % | 40 | 48.78 % | 3  | 3.65    |
| 7.A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe lëvizjes në orën e edukatës fizike?                    | 2 | 2.43 % | 42 | 51.21 % | 38 | 46.34 % | 0  | 0       |
| 8.A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe njohurive rreth shoqërisë në orën e edukatës qytetare? | 0 | 0 %    | 0  | 0 %     | 60 | 73.17 % | 22 | 26.82 % |
| 9.A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe dukurive natyrore në orën “Njeriu dhe natyra”?         | 0 | 0 %    | 0  | 0 %     | 11 | 13.41 % | 71 | 86.58 % |

Më konkretisht për pohimin : “A mendoni se nxënësit janë më socialë dhe interaktivë në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera? “ 20.73 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 80.48 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” .

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe gjuhës shqipe në orën e gjuhës shqipe? “, 14.63 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh”, 42.68 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 39.02 % e kampionit është përgjigjur me alternativën Asnjëherë .

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe leximit në orën e leximit? “, 51.21 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 48.78 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe matematikës në orën e matematikës? “, 1.21 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur “ndonjëherë” dhe 98.78 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe historisë në orën e historisë? “, 15.85 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh”, 54.87 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 29.26 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe pikturës në orën e edukatës figurative? “, 47.56 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur

me alternativën “shpesh”, 48.78 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 3.65 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë” .

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe lëvizjes në orën e edukatës fizike?”, 2.43 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternative “gjithmonë” , 51.21 % e kampionit është përgjigjur me alternative “shpesh” dhe 46.34 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” .

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe njohurive rreth shoqërisë në orën e edukatës qytetare? “, 73.17 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 26.82 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.

Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe dukurive natyrore në orën “Njeriu dhe natyra”?, 13.41 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 86.58 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.

Nga rezultatet e mësipërme të hulumtimit është arritur në përfundimin se është e domosdoshme që në orën e mësimit, në Ciklin Fillor, në lëndë të ndryshme, të aplikohen pjesë të ndryshme muzikore në varësi të temave mësimore, për të bërë jo vetëm ndërlidhjen ndërmjet njohurive ndërlëndore, por edhe për të krijuar për nxënësit një mjedis çlodhës, nxitës dhe motivues për të nxënëit e tyre.

➤ **Ndikimi pozitiv i muzikës në jetën e nxënësve**

Më poshtë është pasqyruar një tablo më e qartë e statistikave descriptive të edukimit muzikor me fushat e tjera të edukimit dhe ndikimit pozitiv të perceptuar nga nxënësit e marrë në studim.

**Tab. Statistika descriptive të ndikimit të muzikës në jetën e nxënësve:**

|  | Frequency |        | Percent |         | Frequency  |         | Percent   |       | Frequency |  | Percent |  |
|--|-----------|--------|---------|---------|------------|---------|-----------|-------|-----------|--|---------|--|
|  | Gjithmonë |        | Shpesh  |         | Ndonjëherë |         | Asnjëherë |       |           |  |         |  |
| Valid  |           |        |         |         |            |         |           |       |           |  |         |  |
| 1.Të pëlqen muzika?  | 60        | 100 %  | 0       | 0%      | 0          | 0%      | 0         | 0     | 0         |  | %       |  |
| 2.A ndjehesh mirë (gëzueshëm) në orën e edukatës muzikore?                                   | 49        | 81.6 % | 10      | 16.66 % | 1          | 1.21 %  | 0         | 0     | 0         |  | %       |  |
| 3.Të pëlqen të këndosh me shokët / shoqet në orën e muzikës?                                 | 47        | 78.3 % | 7       | 11.66 % | 6          | 10 %    | 0         | 0     | 0         |  | %       |  |
| 4.Kur bën detyrat ose studion, të pëlqen të dëgjosh edhe muzikë?                             | 44        | 73.3 % | 4       | 6.66 %  | 5          | 8.33 %  | 7         | 11.66 |           |  | %       |  |
| 5.A të ka ndihmuar dëgjimi i muzikës në kryerjen e ushtrimeve apo problemave të matematikës? | 0         | 0 %    | 0       | 0 %     | 50         | 83.33 % | 10        | 16.66 | 0         |  | %       |  |

|   |    |            |    |      |    |            |   |        |
|---|----|------------|----|------|----|------------|---|--------|
| 6.Të pëlqen të dëgjosh muzikë kur krijon vjersha ose tregime? | 14 | 23.3<br>3% | 33 | 55 % | 13 | 21.66<br>% | 0 | 0<br>% |
| 7.Të pëlqen të dëgjosh muzikë kur pikturon?                   | 60 | 100<br>%   | 0  | 0 %  | 0  | 0 %        | 0 | 0 %    |

- Për pohimin “Të pëlqen muzika?”, 100 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”.
- Për pohimin “A ndjehesh mirë (gëzueshëm) në orën e edukatës muzikore?”, 81.66 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” 16.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 1.21 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” .
- Për pohimin : Të pëlqen të këndosh me shokët / shoqet në orën e muzikës? 78.33 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” 11.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 10 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” .
- Për pohimin “Kur bën detyrat ose studion, të pëlqen të dëgjosh edhe muzikë?”, 73.33 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” 6.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh”, 8.33 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 11.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën Asnjëherë.
- Për pohimin:”A të ka ndihmuar dëgjimi i muzikës në kryerjen e ushtrimeve apo problemave të matematikës?, 83.33% e nxënësve të përzgjedhur në studim është



përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 16.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.

- Për pohimin “Të pëlqen të dëgjosh muzikë kur krijon vjersha ose tregime? “, 23.33 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” 55 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh”, dhe 21.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë “.
- Për pohimin “Të pëlqen të dëgjosh muzikë kur pikturon? “, 100 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”.

## **KAPITULLI V: DISKUTIMET E STUDIMIT**

### **5.1 Përmbledhje**

Fokusi kryesor i këtij studimi është të shikohet çështja e rëndësisë së integritit ndërlëndor të edukatës muzikore me lëndët e tjera, duke aplikuar muzikë , si një teknikë nxitëse në orën e mësimit, në lëndë të ndryshme. Në studim shtrohet domosdoshmëria e këtij integriti ndërlëndor, për të rritur produktivitetin e orës së mësimit. Ky studim synoi të vërtetojë hipotezën se aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme, rrit produktivitetin e orës mësimore. Kjo hipotezë u vërtetua përmes pyetjeve kërkimore të ngritura për realizimin e hulumtimit: Si ndikon në të nxënit e nxënësve integriti ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore? A rritet produktiviteti i orës së mësimit në lëndë të ndryshme, duke aplikuar integritin ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera? Ky studim u realizua përmes anketimit të mësuesve të Ciklit Fillor (konkretisht, mësues që japin mësim në klasat e pesta) dhe nxënës të klasave të pesta në religjionin e Anamarovës, në Kosovë .

### **5.2. Diskutimi i të dhënave deskriptive**

Fillimisht do të jepen diskutimet për të dhënat deskriptive të mësuesve dhe të nxënësve, ndërsa më pas do të diskutohet rreth pyetjeve kërkimore të ngritura në këtë studim për vërtetimin e hipotezës së studimit.

### **5.2. Diskutimi i të dhënave deskriptive**

Fillimisht do të jepen diskutimet për të dhënat deskriptive të mësuesve dhe të nxënësve, ndërsa më pas do të diskutohet rreth pyetjeve kërkimore të ngritura në këtë studim për vërtetimin e hipotezës së studimit.

### *5.2. 1. Diskutimi i të dhënave deskriptive të mësuesve*

Në produktivitetin e orës së mësimit ndikojnë shumë faktorë, objektivë dhe subjektivë . Integrimi ndërlëndor gjithnjë e më tepër, dita – ditës, shihet se ndikon pozitivisht në produktivitetin dhe performancën akademike të nxënësve. Edhe fokusi i studimit tonë këtu konsistoi ku u anketuan 82 mësues dhe u vlerësuan perceptimet e tyre në lidhje me integrimin ndërlëndër me edukatën muzikore.

Nga statistikën e analizave deskriptive rezultoi se një pjesë e mësuesve të përzgjedhur në studim mendojnë se nxënësit janë më socialë dhe interaktivë në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera. Gjetje interesante që vlen të kushtohet rëndësi në këtë rubrikë të diskutimit është se mësuesit e përzgjedhur në studim mendojnë se integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe gjuhës shqipe në orën e gjuhës shqipe sikurse dhe matematikës, historisë, pikturës, edukatës fizike, edukatës qytetare, diturisë se natyrës shpesh ndikon pozitivisht në produktivitetin e orës mësimore. Nga rezultatet e mësipërme të hulumtimit është arritur në përfundimin se është e domosdoshme që në orën e mësimit, në Ciklin Fillor, në lëndë të ndryshme, të aplikohen pjesë të ndryshme muzikore në varësi të temave mësimore, për të bërë jo vetëm ndërlidhjen ndërmjet njohurive ndërlëndore, por edhe për të krijuar për nxënësit një mjedis çlodhës, nxitës dhe motivues për të nxënësit e tyre. Pra, nga të rezultatet e studimit vihet re që mësuesit në zona urbane e

realizojnë më shpesh integrimin ndërlëndor të edukatës muzikore me lëndët e tjera në krahasim me mësuesit në zona rurale. Kjo mund të vijë edhe për pasojë se në zonat rurale mësuesit nuk disponojnë bazën materiale të nevojshme për realizimin e këtij integrimi. Më konkretisht 22 % e mësuesve në zona rurale e realizojnë ndonjëherë integrimin ndërlëndor me edukimin muzikor dhe 78 % e mësuesve në zona urbane e realizojnë shpesh integrimin ndërlëndor me edukimin muzikor. Në kampionin e përzgjedhur në studim vihet re se mësuesit e gjinisë mashkullore janë më të pakët në numër në krahasim me gjininë femërore. Kjo shpjegohet dhe me faktin se gjinia femërore është më e prirur drejt mësuesisë si profesion dhe se ky profesion njihet si “profesion femëror”. Një gjetje interesante e studimit është se në zona rurale ka më tepër mësues të gjinisë mashkullore në krahasim me zonat urbane. Nga statistikat përshkruese të përfuara vihet re se mësuesit me 5-10 vite eksperiencë e realizojnë më shumë integrimin ndërlëndor të muzikës me lëndët e tjera. Kjo mund të shpjegohet me faktin se brezi i dekadës së fundit punon me metodat më bashkëkohore.

### *5.2.2. Diskutimi i të dhënave deskriptive të nxënësve*

Nga studimet e gjetura dhe të parashtruara në pjesë “Shqyrtimi i literaturës”, shihet se muzika ndikon pozitivisht në zhvillimin konjitiv të nxënësve, duke stimuluar zhvillimin e trurit, duke ndikuar pozitivisht dhe në performancën e tyre në të nxënë. Muzika në shkollë ndikon në krijimin e një mjedisi të qetë dhe mbështetës për të mësuar. Ajo ndikon në gjendjen shpirtërore të nxënësve, duke reduktuar stresin. Përpos gjuhës, muzika aktivizon çdo nënsistem të trurit, duke përfshirë strukturat e motivimit dhe të emocionit. Muzikë i

bën nxënësit më inteligjentë, por autorët e një studimi të ri thonë se nuk ka fakte shkencore që edukimi i hershëm muzikor ka ndonjë ndikim në inteligjencën e fëmijëve. Vlen të theksohet se studimi evidentoi se mësimet e muzikës ndihmojnë në përmirësimin e notave të nxënësve ose në rritjen e aftësive të të mësuarit. Në fakt, mësuesit thonë se nxënësit mund të përfitojnë shumë nga mësimet e muzikës, si krenaria që vjen me të mësuarit se si të interpretosh një këngë të re apo tek roli i muzikës si burim krijimtarie. Ndaj muzika dhe edukimi muzikor mbetet një ndër aktivitetet më të pëlqyera për nxënësit pjesëmarrës në studimin tonë. 81.66 % e nxënësve të përfshirë në studim ndjehen të gëzuar gjatë edukatës muzikore, 78.33 % e nxënësve i pëlqen të këndojnë në orën e muzikës me bashkëmoshatarët. Këto të dhëna tregojnë se muzika ndikon në rritjen e socializmit të fëmijëve me bashkëmoshatarët në shkollë, në orën e mësimit. 73.33 % e nxënësve i pëlqen ti bëjnë detyrat me muzikë kjo tregon që muzika ndikon në rritjen e performancës akademike. Dhe 100 % e nxënësve shprehen se kur pikturojnë muzika i nxit imagjinatën dhe ndikon në aktivizimin e emocioneve të tyre pozitive. Nga rezultatet deskriptive vihet re që tek nxënësit në zona urbane muzika dhe integrimi ndërlëndor me edukimin muzikor ka një rol më të rëndësishëm në krahasim me nxënësit në zona rurale edhe pse të dy grupet e pëlqejnë muzikën. Duhet theksuar fakti se integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me matematikën nuk është shumë sinjifikativ për të dy grupet e nxënësve pasi vetë ky integrim ndërlëndor është i pakët.

### **5.3. Diskutimi mbi vërtetësinë e hipotezës**

Në këtë studim u ngrit hipoteza kryesore: Duke aplikuar elementet muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme, rritet produktiviteti i orës mësimore dhe hipoteza nul:

Aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit në lëndë të ndryshme nuk ka asnjë ndikim në produktivitetin e orës së mësimit. Për të qartësuar marrëdhënien e integritit të muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme – produktivitetit të orës mësimore, tek mësuesit dhe nxënësit e përfshirë në studim, u përdor analiza e korrelacionit Pearson r. Koeficientët e korelacionit Pearson, treguan se ka marrëdhënie pozitive të moderuar, midis integritit të muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme – produktivitetit të orës mësimore, tek mësuesit dhe nxënësit e përfshirë në studim. Nga të dhënat e përftuara nga analiza statistikore rezulton se vërtetohet hipoteza kryesore. 5.3.1. Diskutimi për pyetjet kërkimore të studimit Edukimi muzikor është fushë edukative e cila integrohet natyrshëm me fushat e tjera të kurrikulës. Integrimi ndërfushor bëhet gjatë gjithë procesit të edukimit. Integrimi ndërfushor bëhet gjatë gjithë procesit të edukimit të nxënësve në sistemin 9 - vjeçar. E veçanta e edukimit muzikor është se shtrihet në të gjitha aktivitetet e nxënësve, i nxit dhe i frymëzon ata për aktivitete të ndryshme. Aftësitë muzikore zhvillohen jo vetëm me aktivitetet muzikore, por edhe përmes aktiviteteve në fushat e tjera edukative, e duke i ndërlidhur me kontekstin jetësor të fëmijës. Aktivitetet e ndryshme të nxënësve në natyrë dhe mjedisin jetësor (social) të tij, i mundësojnë të njohin tinguj e zëra të ndryshëm të botës që na rrethon dhe zhvillojnë fizikun dhe shëndetin e tyre. Muzika instrumentale mund të integrohet përmes dramatizimit të teksteve letrare dhe jo letrare. Loja me kukulla e shoqëruar me muzikë adekuate mundëson përjetimin më të thellë të muzikës dhe lojës. Lojërat me grupe fëmijësh, gjatë të cilave fëmijët formojnë rrethin, lëvizin lartë – poshtë, pozicionohen para - pas, majtas - djathtas etj, të shoqëruar me muzikë, krijojnë shanse të favorshme që të edukohet jo vetëm muzikaliteti i fëmijës por, në atmosferë të këndshme, fëmija t'i njohë dhe kuptojë disa nocione matematike. Aktivitetet në fushën e muzikës gërshetohen edhe me artin figurativ. Nxënësit me kënaqësi vizatojnë dhe modelojnë lulet,

shpezët, shtazët etj, e të cilave u dedikohet kënga. Integrimi ndërfaqshor, pra i edukimit muzikor dhe fushave të tjera edukative mundëson zhvillimin dhe edukimin më të natyrshëm e tërësorë të parashkollorit, ndaj 100 % e kampionit të marrë në studim parapëlqenin që gjatë vizatimit të dëgjonin muzikë. Studimi ynë dëshmoi se integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera në orën e mësimit qëndron rëndësia e këtij studimi, i cili synon të sjellë strategji të ndryshme efektive të integrimit të muzikës në orën e mësimit në lëndë të ndryshme. Ky studim hulumtoi rreth pyetjet kërkimore të parashtruara në krye të studimit dhe u konstatua përmes përpunimit të të dhënave se: -Vendosja e muzikës në sfond dhe aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit rrit produktivitetin e orës mësimore. - Integrimi ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore rrit produktivitetin dhe performancën akademike tek nxënësit kryesisht në lëndët: Art Figurative, Gjuhë, Matematikë, Histori, Dituri Natyre.

### *5.3.1. Diskutimi për pyetjet kërkimore të studimit*

Edukimi muzikor është fushë edukative e cila integrohet natyrshëm me fushat e tjera të kurrikulës. Integrimi ndërfaqshor bëhet gjatë gjithë procesit të edukimit. Integrimi ndërfaqshor bëhet gjatë gjithë procesit të edukimit të nxënësve në sistemin 9 - vjeçar. E veçanta e edukimit muzikor është se shtrihet në të gjitha aktivitetet e nxënësve, i nxit dhe i frymëzon ata për aktivitete të ndryshme. Aftësitë muzikore zhvillohen jo vetëm me aktivitetet muzikore, por edhe përmes aktiviteteve në fushat e tjera edukative, e duke i ndërlidhur me kontekstin jetësor të fëmijës. Aktivitetet e ndryshme të nxënësve në natyrë dhe mjedisin jetësor (social) të tij, i mundësojnë të njohin tinguj e zëra të ndryshëm të botës

që na rrethon dhe zhvillojnë fizikun dhe shëndetin e tyre. Muzika instrumentale mund të integrohet përmes dramatizimit të teksteve letrare dhe jo letrare. Loja me kukulla e shoqëruar me muzikë adekuate mundëson përjetimin më të thellë të muzikës dhe lojës. Lojërat me grupe fëmijësh, gjatë të cilave fëmijët formojnë rrethin, lëvizin lartë – poshtë, pozicionohen para - pas, majtas - djathtas etj, të shoqëruar me muzikë, krijojnë shanse të favorshme që të edukohet jo vetëm muzikaliteti i fëmijës por, në atmosferë të këndshme, fëmija t'i njohë dhe kuptojë disa nocione matematike. Aktivitetet në fushën e muzikës gërshetohen edhe me artin figurativ. Nxënësit me kënaqësi vizatojnë dhe modelojnë lulet, shpezët, shtazët etj, e të cilave u dedikohet kënga. Integrimi ndërfaqshor, pra i edukimit muzikor dhe fushave të tjera edukative mundëson zhvillimin dhe edukimin më të natyrshëm e tërësorë të parashkollorit, ndaj 100 % e kampionit të marrë në studim parapëlqenin që gjatë vizatimit të dëgjonin muzikë.

Studimet kanë dëshmuar se muzika ka lidhje me shumë fusha të tjera, si: gjuha, letërsia, matematika, historia, piktura, etj., ndaj një nga prioritetet e sotme të arsimit të fëmijëve në shkollë është ndërlidhja e edukatës muzikore me lëndët e tjera përmes integritit ndërlëndor në shkollë .

Pikërisht, tek integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera në orën e mësimit qëndron rëndësia e këtij studimi, i cili synon të sjellë strategji të ndryshme efikase të integritit të muzikës në orën e mësimit në lëndë të ndryshme.

Ky studim hulumtoi rreth pyetjet kërkimore të parashtruara në krye të studimit dhe u konstatua përmes përpunimit të të dhënave se:



-Vendosja e muzikës në sfond dhe aplikimi i elementeve muzikore në orën e mësimit rrit produktivitetin e orës mësimore.

- Integrimi ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera mësimore rrit produktivitetin dhe performancën akademike tek nxënësit kryesisht në lëndët: Art Figurative, Gjuhë, Matematikë, Histori, Dituri Natyre.

- Kampioni i mësuesve të marrë në studim raporton se integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera mësimore zbatohet vetëm në lëndën e Artit Figurativ, Edukimit fizik,

Gjuhës, dhe Historisë, integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe Matematikës dhe Diturisë së Natyrës zbatohet ndonjëherë.

## **KAPITULLI VI : PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Në këtë kapitull pasqyrohen përfundimet e arritura nga studimi mbi rëndësinë që ka integrimi ndërlëndor i muzikës në produktivitetin e orës së mësimin në lëndë të ndryshme si gjuha, matematika, historia, etj. Gjithashtu, në këtë kapitull një çështje e rëndësishme e trajtuar janë dhe rekomandimet e dhena. Studimi thekson se aplikimi i integritit ndërlëndor të lëndëve të ndryshme me muzikën, për tema të ndryshme lëndore ka një rol të rëndësishëm në jeten psiko-sociale të nxënësve

## **6.1 Përfundime**

Gjithnjë e më tepër, në ditët e sotme, po synohet drejt integritit ndërlëndor, pasi mësimi i lëndëve mësimore të ndara nga njëra – tjetra çon në marrjen e njohurive të fragmentuara nga nxënësit. Dekadën e fundit studimet ndërkombëtare janë fokusuar në përfitimet që ka muzika në jeten psiko -sociale në mjediset shkollore dhe kanë dëshmuar se muzika ka lidhje me shumë fusha të tjera, si: gjuha, letërsia, matematika, historia, piktura, etj., Ndaj studimi ynë hulumton dhe e ve theksin në ndërlidhjen e edukatës muzikore me lëndët e tjera.

Në studimin tonë morën pjesë 60 nxënës nga të cilët 36 ishin të gjinisë fëmijërore dhe 24 ishin të gjinisë mashkullore. Gjithashtu në studim u përfshinë dhe 82 mësues, të cilët shprehën perceptimet në tyre në lidhje me integrimin lëndor të edukatës muzikore me lëndët e tjera.

Qëllimi i realizimit të këtij studimi ishte të studiojë ndikimin që ka integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera mësimore, përmes aplikimit të elementeve muzikore në lëndë të ndryshme gjatë orës së mësimi.

Studimi nxori në pah rëndësinë e përdorimit të muzikës brenda orës mësimore në lëndë të ndryshme në shkollë si gjuha, matematika, edukata qytetare etj, si dhe përfitimet që sjell muzika në shëndetin psikologjik të nxënësve në mjedisin shkollor por jo vetëm.

Studimi ynë vërtetoi hipotezën kryesore duke aplikuar elementet muzikore në orën e mësimi në lëndë të ndryshme, rritet produktiviteti i orës mësimore. Për të qartësuar marrëdhënien e integritit të muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme – produktivitetit të orës mësimore, tek mësuesit dhe nxënësit e përfshirë në studim, u përdor analiza e korrelacionit Pearson r. Koeficientet e korelacionit Pearson, tregojnë se ka marrëdhënie pozitive të moderuar, midis integritit të muzikës në orët mësimore të lëndëve të ndryshme – produktivitetit të orës mësimore, tek mësuesit dhe nxënësit e përfshirë në studim. Nëse i referohemi perceptimeve të mësuesve të marrë në studim nga analiza e të dhënave u përfutuan gjetjet e mëposhtme: - Për pohimin “Lënda e edukatës muzikore krijon atmosferë të hareshme“, 65.85 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” dhe 34.14 % e kampionit është përgjigjur me alternativën

“shpesh”. - Për pohimin : “Lënda e edukatës muzikore nxit kureshtjen e nxënësve. “ 13.41 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 60.97 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 25.60 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “Lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm“, 12.19 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është

përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 79.26 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 8.53 % e kampionit është përgjigjur me alternativën

“ndonjëherë”. - Për pohimin “Lënda e edukatës muzikore zhvillon kreativitetin e nxënësve”, 54.87 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 37.80 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 7.31 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “Lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më socialë”, 42.68 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 37.80 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 2.43 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “Lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më interaktivë”, 20.73 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” dhe 79.26 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh”. - Për pohimin “A shfaqin interes nxënësit për lëndën e edukatës muzikore?“, 80.48 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” dhe 19.51 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh”. - Për pohimin “A vendosni në klasë, në sfond, muzikë për të krijuar atmosferë pozitive për nxënësit tuaj?“, 43.90 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 56.09 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “Nëse po, a keni konstatuar përmirësim të gjendjes shpirtërore të nxënësve?“, 45.12 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 54.87 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”.

Për pohimin “Kurrikula e re parasheh që ndërlihdja e lëndëve të realizohet në orë të ndryshme mësimore. Sipas mendimit tuaj, a duhet të realizohet ndërlihdja mes lëndëve?“,

70.73 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 29.26 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor në klasën tuaj? “ 4.87 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 29.26 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 65.85 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “A mendoni se orët mësimore të lëndëve të ndryshme janë më efektive nëse bëhet ndërlidhja (integrimi) me edukatën muzikore? “ 24.39 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh” 75.60 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “A e keni realizuar integrimin ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera? “ 1.21 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 51.21 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 47.56 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “A mendoni se nxënësit janë më aktivë në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera? “ 12.19 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 75.60 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 12.19 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “A mendoni se, në lëndë të ndryshme, nxënësit e përvetësojnë më mirë temën mësimore, kur për realizimin e kësaj temë ju fusni dhe elemente muzikore? “, 10.97 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 75.60 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 13.41 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “A mendoni se te nxënësit nxitet fantazia dhe krijimtaria në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera? “

54.87

% e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 57.31 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” . - Për pohimin “A mendoni se nxënësit janë më socialë dhe interaktivë në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera?“, 20.73 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”, 80.48 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” . - Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe gjuhës shqipe në orën e gjuhës shqipe?“, 14.63 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh”, 42.68 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 39.02 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”. - Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe leximit në orën e leximit?, “ 51.21 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 48.78 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” . - Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe matematikës në orën e matematikës?, “1.21 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur “ndonjëherë” dhe 98.78 % e kampionit është përgjigjur me alternativën Asnjëherë. - Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe historisë në orën e historisë?, “ 15.85 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh”, 54.87 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 29.26 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”. - Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe pikturës në orën e edukatës figurative? “, 47.56 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “shpesh”, 48.78 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 3.65 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”. - Për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe lëvizjes në orën e edukatës fizike?”, 2.43 % e mësuesve të

përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternative “gjithmonë” , 51. 21 % e kampionit është përgjigjur me alternative “shpesh” dhe 46. 34 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Më konkretisht për pohimin :? “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe njohurive rreth shoqërisë në orën e edukatës qytetare? “, 73.17 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 26.82 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”. - Më konkretisht për pohimin “A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe dukurive natyrore në orën ‘Njeriu dhe natyra’”?, 13.41 % e mësuesve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 86.58 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”.Gjetjet e mësipërme të studimit tonë janë të rëndësishme statistikisht dhe përmes tyre konkludojmë se perceptimi i mësuesve në lidhje me integrimin ndërlëndor të edukatës muzikore me lëndët e tjera mësimore është efektiv dhe ka benefite në mjedisin shkollor duke ndikuar në zhvillimin emocional dhe konjitiv të nxënësve. Nëse i referohemi perceptimeve të nxënësve të marrë në studim, nga analiza e të dhënave u përfatuan gjetjet: - Për pohimin “Të pëlqen muzika?”, 100 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”. - Për pohimin “A ndjehesh mirë (gëzueshëm) në orën e edukatës muzikore?”, 81.66 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” 16.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 1.21 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “Të pëlqen të këndosh me shokët / shoqet në orën e muzikës?”, 78.33 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” 11.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh” dhe 10 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “Kur bën detyrat ose studion, të pëlqen të dëgjosh edhe muzikë?”, 73.33 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me



alternativën “gjithmonë” 6.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh”, 8.33 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 11.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”. - Për pohimin “A të ka ndihmuar dëgjimi i muzikës në kryerjen e ushtrimeve apo problemave të matematikës?”, 83.33% e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë” dhe 16.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “asnjëherë”. - Për pohimin “Të pëlqen të dëgjosh muzikë kur krijon vjersha ose tregime?”, 23.33 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë” 55 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “shpesh”, dhe 21.66 % e kampionit është përgjigjur me alternativën “ndonjëherë”. - Për pohimin “Të pëlqen të dëgjosh muzikë kur pikturon?”, 100 % e nxënësve të përzgjedhur në studim është përgjigjur me alternativën “gjithmonë”. Nga rezultatet deskriptive vihet re që tek nxënësit në zona urbane muzika dhe integrimi ndërlëndor me edukimin muzikor ka një rol më të rëndësishëm në krahasim me nxënësit në zona rurale edhe pse të dy grupet e pëlqejnë muzikën. Më konkretisht nga statistikat deskriptive rezulton se : 33 % e nxënësve në zona rurale e pëlqejnë muzikën dhe 67 % e nxënësve në zona urbane. Të njëjtat statistika rezultojnë edhe për sa i përket realizimit të artit figurativ piktures të integruar me muzikë në sfond. 31.66 % e nxënësve në zona rurale ndjehen të gëzuar në orën e edukatës muzikore. Gjithashtu, edhe 68.34 % e nxënësve në zona urbane. 26.66 % e nxënësve në zona rurale i pëlqen të këndojë me shokët shoqet. Gjithashtu edhe 56.66 % e nxënësve në zona urbane. 26.66 % e nxënësve në zona rurale i pëlqen ti realizojë detyrat me muzike. E njëjta gjë konstatohet dhe prej 46.66 % të nxënësve në zona urbane. Duhet theksuar fakti se integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me matematikën nuk është shumë sinjifikativ për të dy grupet e nxënësve pasi vetë ky integrim ndërlëndor është i pakët. Më konkretisht 25 % të nxënësve në zonë rurale e ka

ndihmuar muzika ndonjëherë në kryerjen e detyrave në matematikë dhe 53.33 % të nxënësve në zonë urbane. 28 % e nxënësve në zonë rurale i pëlqen të dëgjojnë muzikë kur krijojnë vjersha. Kjo gjë konstatohet edhe te 54 % e nxënësve në zonë urbane. Nga rezultatet e studimit vihet re që mësuesit në zona urbane e realizojnë më shpesh integrimin ndërlëndor të edukatës muzikore me lëndët e tjera në krahasim me mësuesit në zona rurale. Kjo mund të vijë edhe për pasojë se në zonat rurale mësuesit nuk disponojnë bazën materiale të nevojshme për realizimin e këtij integrimi. Më konkretisht 22 % e mësuesve në zona rurale e realizojnë ndonjëherë integrimin ndërlëndor me edukimin muzikor dhe 78 % e mësuesve në zona urbane e realizojnë shpesh integrimin ndërlëndor me edukimin muzikor. Në kampionin e përzgjedhur në studim vihet re se mësuesit e gjinisë mashkullore janë më të pakët në numër në krahasim me gjininë femërore. Kjo shpjegohet dhe me faktin se gjinia femërore është më e prirur drejt mësuesisë si profesion dhe se ky profesion njihet si “profesion femëror”. Një gjetje interesante e studimit është se në zona rurale ka më tepër mësues të gjinisë mashkullore në krahasim me zonat urbane. Më konkretisht nga grafiku i mësipërm rezulton se 82 % e mësuesve të gjinisë femërore në zona urbane e realizojnë integrimin ndërlëndor dhe 18 % e mësuesve të gjinisë femërore në zona rurale. Më konkretisht, nga grafiku i mësipërm rezulton se 18 % e mësuesve të gjinisë mashkullore në zona urbane e realizojnë integrimin ndërlëndor dhe 82 % e mësuesve të gjinisë mashkullore në zona rurale. Nga analizat deskriptive, rezulton se integrimi ndërlëndor i edukatës muzikore me lëndët e tjera realizohet nga 57 % e mësuesve me 5-10 vite, 33 % e mësuesve me 10-15 vite eksperiencë dhe vetëm 10 % e mësuesve me mbi 20 vite eksperiencë. Pra nga statistikat përshkruese të përfuara vihet re se mësuesit me 5-10 vite eksperiencë e realizojnë më shumë integrimin ndërlëndor të muzikës me lëndët e tjera. Kjo mund të shpjegohet me faktin se brezi i dekadës së fundit punon me metodat më bashkëkohore.

Studimi ynë synoi të sjellë strategji të ndryshme efikase të integritit të muzikës në orën e mësimit në lëndë të ndryshme.

## **6.2. Rekomandime**

Studimi ynë theksoi se aplikimi i integritit ndërlëndor të lëndëve të ndryshme me muzikën, për tema të ndryshme lëndore ka një rol të rëndësishëm në jetën dhe shëndetin psikologjik të nxënësve.

Rekomandimet e këtij studimi i drejtohen studiuesve të tjerë, hartuesve të politikave arsimore, universiteteve.

Vlera e arsimit është vlerë e përbashkët e të gjithë qytetarëve, prandaj që të nxirren konkluzione të sakta rekomandoj se, është e rëndësishme që të studiohet ndikimi i edukimit muzikor dhe efektet e tij pozitive në zhvillimin e nxënësve dhe produktivitetit në klasë në lëndë të ndryshme në një kampion më të gjerë studimi pasi kampioni ynë i studimit është i kufizuar vetëm 60 nxënës dhe 82 mësues. Në këtë mënyrë krijohen hapësira që të ndërmerren studime të mëtejshme dhe të rritet vëmendja për kryerjen e studimeve të ngjashme të mëtejshme më të detajuara.

- Nisur nga rezultatet e studimit, ku u vu re se integrimi ndërlëndor rrit produktivitetin e nxënësve në performancën akademike në klasë, rekomandohet se rëndësi merr përfshirja e kurrikulave të edukimit dhe formimit muzikor, në programet universitare të fakulteteve të

mësuesisë, pasi pavarësisht formimit të tyre akademik, studentët mësues të të gjitha degëve duhet të kenë edhe edukim dhe formim muzikor.

-Duke u nisur nga rezultatet e studimit tonë për hartuesit e politikave arsimore rekomandohet përfshirja e integritit ndërlëndor në kurrikulën e arsimit. Gjithashtu rekomandohet që hartuesit e politikave arsimore të përfshijnë dhe një paketë me trajnime për mësuesit për ti vënë në dukje përfitimet që ka integrimi ndërlëndor me edukatën muzikore në rritjen e produktivitetit dhe performancës akademike tek nxënësit. Ministria e Arsimit të ketë mekanizma monitorimi për vlerësimin e cilësisë së programeve të trajnimit që ofrojnë organizatat dhe agjencitë e ndryshme, me qëllim që trajnimi të mos konceptohet vetëm për pajisjen e mësuesve me certifikata kreditesh, por si domosdoshmëri për përmirësimin e cilësisë së punës së tyre në të ardhmen, punë e cila prek në mënyrë të drejtpërdrejtë jetën e nxënësve. -Rekomandohet që t'i jepet rëndësi edukimit muzikor në plan-programin shkollor, pasi edukimi muzikor si lëndë mësimore ka nevojë të mbështetet nga një sërë veprimtarish ekstrakurrikulare dhe kroskurrikulare, për t'i dhënë kësaj lënde kuptimin e vërtetë, që nxënësit të krijojnë përvoja duke u bërë arkitektë dhe aktorë të jetës së tyre.

### **6.3. Mundësi për studime të mëtejshme**

Në këtë studim u pa roli dhe kontributi i edukimit muzikor në rritjen e produktivitetit të nxënësve në orën mësimore në lëndë të ndryshme. Vlera e arsimit është vlerë e përbashkët e të gjithë qytetarëve, prandaj që të nxirren konkluzione të sakta, është e rëndësishme që të studiohet ndikimi i edukimit muzikor dhe efektet e tij pozitive në zhvillimin e nxënësve

dhe produktivitetit në klasë në lëndë të ndryshme në një kampion më të gjerë studimi pasi kampioni ynë i studimit është i kufizuar vetëm 60 nxënës dhe 82 mësues. Kjo krijon hapësira që të ndërmerren studime të mëtejshme dhe të rritet vëmendja për kryerjen e studimeve të ngjashme të mëtejshme më të detajuara.

## **Literatura**

### **Literatura parësore**

1. Baker R. A. (2011). The Relationship between Music and Visual Arts Formal Study and Academic Achievement on the Wighth-Grade Louisiana Educational Assessment Program (LEAP) Test. (Doctoral dissertation, Louisiana State University, 2011).
2. Behar, C. (2005). The effects of classical music on listening comprehension.

- Clearinghouse, 1-20. Retrieved October 6, 2006, from ERIC database (ERIC Item: ED438589)
3. Arts Education Partnership, *Music Matters: How Music Education Helps Students Learn, Achieve, and Succeed*, Washington, D.C., September 2011
  4. Bryant-Jones, M., Shimmins, K., & Vega, J. (2003). Increasing math achievement through use of music. *Clearinghouse*, 1-41. Retrieved October 6, 2006, from ERIC database (ERIC Item: ED478919)
  5. Byrge, L.O. Konlaan, B.K. and Johansson, S-E (1996) Attendance at cultural events, reading books or periodicals and making music or singing in a choir as determinants for survival: Swedish interview survey of living conditions, *British Medical Journal*, 313, 1577- 1580.
  6. Chesky, K. S., & Hipple, J. (1997, December). Performance Anxiety, Alcoholrelated Problems, and Social/ Emotional Difficulties of College Students: A Comparative Study Between Lowerdivision Music and Non-music Majors. *Medical Problems of Performing Artists*, 126-132.
  7. Clift, S. & Hancox, G. (2001) 'The perceived benefits of singing: Findings from preliminary surveys of a university college choral society'. *The Journal of the Royal Society for the Promotion of Health*, 121(4), 248-256.
  8. Caufield, R. (1999). Mozart effect: Sound beginnings. *Early Childhood Education*, 27(2), 119-121.

9. Dinsmore, T. S. (2003). Classroom Management. Clearinghouse, 1-30. Retrieved July 12, 2006, from ERIC database (ERIC Item: ED478771).
10. Eady, I., & Wilson, J. O. (2004, Winter). The influence of music on core learning. *Education*, 125(2), 243-248.
11. Forgeard, M., et al. (2008). Practicing a Musical Instrument in Childhood is Associated with Enhanced Verbal Ability and Nonverbal Reasoning. *PLoS ONE* 3(10): e3566.
12. Gardner, H, Dimensionet e mendjes, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2003
13. Gouzouasis, P., et al. (2007). The Predictive Relationship Between Achievement and Participation in Music and Achievement in Core Grade 12 Academic Subjects. *Journal of Research in Music Education*, 9(1), 81-92.
14. Gavora, P. Úvod do pedagogického výzkumu. Brno 2000
15. Gjini, F & Piluri, A. Hyrje në Psikologji, Shtypshkronja “Sejko”, 1998
16. Hajdaraga, L. Interesat mësimore të nxënësve, Tiranë, 1988
17. Hirt-Mannheimer, J. (1995) Music big for little folks. *Teaching Music*, 3(2), 38-39.
18. Ho, Y., et al. (2003). Music Training Improves Verbal but Not Visual Memory: Cross sectional and Longitudinal Explorations in Children. *Neuropsychology*, 17(3), 439-450.
19. Humpal, M.E. and Wolf, J. (2007) Music in the Inclusive Classroom, *Young Children*, 58(2), 103-107.

20. Hyde, K. L., et al. (2009). Musical Training Shapes Structural Brain Development.  
The Journal of Neuroscience, 29(10), 3019-3025.
21. Hysenbengas, A. Matematika dhe muzika, Tiranë, 1984
22. Hysi, F, Edukimi muzikor – pjesë integrale e studimeve interdisiplinore, Tiranë, 2002
23. Johansson, S.E., Konlaan, B.B. and Bygren, L.O. (2001) Sustaining habits of attending cultural events and maintenance of health: a longitudinal study, Health Promotion International, 16(3), 229-234.
24. Josip, J. Estetska Gimnastika - Osnovi. Zagreb 1952,
25. Klemi, S. Kur dëgjojmë muzikë, Tiranë, 1973
26. Karaj, Th. Psikologjia e zhvillimit, Tiranë 2005
27. Koppelman, D. & Imig, S. (1995). The effects of music on children's writing content. Clearinghouse, 1-21. Retrieved October 6, 2006, from ERIC database (ERIC Item: ED383002).
28. Kurrikula dhe shkolla, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2002
29. Kurrikula e Bazuar në Kompetenca, IZHA, Tiranë 2016
30. Lewis, E. (2002). The relationship of listening to classical music on first graders' ability to retain information. Clearinghouse, 1-30
31. Metoda të mësimdhënies, (Manual për mësuesit e rinj), Tiranë, 1999
32. Morrison, S. J. (1994). Music students and academic growth. Music Educators Journal, 33.
33. Murphey, T. Music & Songs. Oxford University Press, 1992



34. Musai, B, Metodologji e mësimdhënies, Tiranë 2014
35. Musai, B. Mësimdhënia dhe të nxënësit ndërveprues (për klasat 6-12), Tiranë, 2005
36. Musai, B. Metodologji e mësimdhënies, Tiranë, 2003
37. Neville, H., et al. (2008). Effects of Music Training on Brain and Cognitive Development in Under-privileged 3- to 5-year-old Children: Preliminary Results. In C. Asbury & B. Rich (Eds.), *Learning, Arts, and the Brain: The Dana Consortium Report on Arts and Cognition* (p.105-116). New York, NY: Dana Press. Patel, A.D. and Iverson, J.R. (2007) The linguistic benefits of musical abilities. *Trends in cognitive sciences*, 11, 369-372.
38. Patel, A.D. and Iverson, J.R. (2007) The linguistic benefits of musical abilities. *Trends in cognitive sciences*, 11, 369-372.
39. Pettijohn, T. *Pikologjia – Një hyrje koncize*, Tiranë, 1996
40. Register, D. (2001) The effects of an early intervention music curriculum on prereading/writing, *Journal of Music Therapy*, 38(3), 239-248.
41. Resnicow, J.E., Salovey, P., & Repp, B.H. (2004) Is recognition of emotion in music performance an aspect of emotional intelligence, *Music Perception*, 22(1), 145-158
42. Rosova, V. *The use of music in teaching English*, 2007
43. Schellenberg, E. G. (2006). Long-term positive associations between music lessons and IQ. *Journal of Educational Psychology*, 98(2), 457-468
44. Schlaug, G., et al. (2005). Effects of Music Training on Children's Brain and Cognitive Development. In S.D. Lipscomb, et al (Eds.), *Proceedings of the 8th*

International Conference on Music Perception & Cognition (fq.133-134).

Adelaide, Australia: Causal Productions.

45. Spahiu, S, Edukata muzikore 7, Prishtinë, 2009 , fq. 104
46. Schellenberg, E. G. (2006). Long-term positive associations between music lessons and IQ. *Journal of Educational Psychology*, 98(2), 457-468
47. Stacey, R., Brittain, K. & Kerr, S. (2002) Singing for health: an exploration of the issues, *Health Education*, 102(4), 156-162.
48. Standley, J.M. & Hughes, J.E. (1997) Evaluation of an early intervention music curriculum for enhancing prereading/writing skills, *Music Therapy Perspectives*, 15(2), 79-85
49. Strickland, S. J. (2001 /2002). Music and the brain in childhood development. *Childhood Education*. 78(2), 100-103
50. Strickland, S. J. (2001 /2002). Music and the brain in childhood development. *Childhood Education*. 78(2), 100-103
51. Sula, G. Të nxënësit: nga teoria në praktikë, Tiranë, 2012
52. Tallal, P. And Gaab, N. (2006) Dynamic auditory processing, musical experience and language development. *Trends in neurosciences*, 29, 382-370.
53. Tole, V , Muzika dhe letërsia, "Onufri", 1997
54. Zadeja, T & Kalemi, S. Metodika e mësimet të këngës dhe muzikës, Tiranë, 1988
55. Wetter, O. E, et.al. (2009). Does Musical Training Improve School Performance? *Instructional Science*, 37, 365- 374.

56. Whitwell, D. (1977) Music learning through performance. Texas: Texas Music Educators Association.
57. Woolfolk, A, Psikologji edukimi, Tiranë, 2011
58. Wolf, J. (1992) Let's sing it again: Creating music with young children. *Young children*, 47(2), 56-61.

### **Literatura dytësore**

1. Basil, M.D. (1994). Multiple resource theory I: Application to television viewing. *Communication Research*, 21, 177-207.
2. Berti, S., et al. (2006). Different Interference Effects in Musicians and a Control Group. *Experimental Psychology*, 53(2), 111-116. Catterall, J. S., et al. (1998).  
  
Involvement in the Arts and Human Development: General Involvement and Intensive Involvement in Music and Theatre Arts. In E.B. Fiske (Ed.), *Champions of Change* (pp. 1-18). Washington, DC: the Arts Education Partnership & the President's Committee on the Arts and the Humanities.
3. Broh, B.A. (2002) Linking extracurricular programming to academic achievement: ëho benefits and why? *Sociology of Education*, 75, 69-95.
4. Bourke, P.A., Duncan, J., and Nimmo-Smith, I. (1996). A general factor involved in dual-task performance decrement. *The Quarterly journal of Experimental Psychology*, 49, 525-545

5. Cevasco, A. (2008). The effect of mothers' singing on full-term and preterm infants and maternal emotional responses. *Journal of Music Therapy*, 45(3), 273-306.
6. College Board. (2010). 2010 Collegebound Seniors Total Group Profile Report. New York.
7. Costa, A. L., & Kallick, B. (2000). Describing the 16 Habits of Mind. Adapted from A. L. Costa & B. Kallick, *Habits of Mind: A Developmental Series*. Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development (ASCD).
8. Craft, A. (2001). An Analysis of Research and Literature on Creativity and Education. Report Prepared for the Qualifications and Curriculum Authority. Coventry, England.
9. Furnham, A., Trew, S., and Sneade, I. (1999). The distracting effects of vocal and instrumental music on the cognitive test performance of introverts and extroverts. *Personality and Individual Differences*, 27(2), 381-392.
10. Helmrich, B. H. (2010). Window of Opportunity? Adolescence, Music, and Algebra. *Journal of Adolescent Research*, 25(4), 557-577.
11. Ho, Y., et al. (1998, November 12). Music Training Improves Verbal Memory. *Nature*, 396, fq. 128

12. Hyppa, M.T. and Maki, J. (2001) Individual-level relationships between social capital and self-rated health in a bilingual community, *Preventative medicine*, 32, 148-155
13. Konlaan, B.B., Bygren, L.O. and Johansson, S-E. (2000) Visiting the cinema, concerts, museums or art exhibitions as determinant of survival: a Swedish fourteen-year cohort follow-up study, *Scandinavian Journal of Public Health*, 28(3), 174-8.
14. Lang, A. (2000). The limited capacity model of mediated message processing. *Journal of Communication*, 50, 46-70
15. Lichtenberg, J., et al. (2008). Ready to Innovate: Are Educators and Executives Aligned on the Creative Readiness of the U.S. Workforce? New York, NY: The Conference Board.
16. Lin, M.F., Hsu, M-C., Chang, H-J., Hsu, Y-Y., Chou, M-H., and Crawford, P. (2009). Pivotal moments and changes in the bonny method of guided imagery and music for patients with depression. *Journal of Clinical Nursing*, 19 (7-8), 1139-1148
17. Lillemyr, O.F. (1983) Achievement motivation as a factor in self-perception, *Norwegian Research Council for Science and the Humanities*, 245-248.
18. Rauscher, F. H., & Zupan M. A. (2000). Classroom Keyboard Instruction Improves Kindergarten Children's Spatial-Temporal Performance: A Field

- Experiment. *Early Childhood Research Quarterly* 15(2), 215-228
19. Scott, L. (1992). Attention and Perseverance Behaviors of Preschool Children Enrolled in Suzuki Violin Lessons and Other Activities. *Journal of Research in Music Education*, 40(3), 225-235.
  20. Strategic National Arts Alumni Project (SNAAP). (2010). Forks in the Road: The Many Paths of Arts Alumni: Strategic National Arts Alumni Project 2010 Findings. Bloomington, IN.
  21. Pallesen, K. J., et al. (2010). Cognitive Control in Auditory Working Memory Is Enhanced in Musicians. *PLoS ONE* 5(6): e11120.
  22. Revista "Muziča kultura", nr. 5, Zagreb, 1982, fq. 189
  23. U.S. Department of Education. (2008). Foundations for Success: The Final Report of the National Mathematics Advisory Panel. Washington, DC.
  24. Vaugh, K., & Winner, E. (2000). SAT Scores of Students Who Study the Arts: What We Can and Cannot Conclude about the Association. *Journal of Aesthetic Education* 34(3/4), 77-98
  25. [//arsimi.gov.al/files/userfiles/kurrikula/PROGRAMI\\_\\_ARTI\\_PAMOR\\_SHKALLA\\_3.pdf](http://arsimi.gov.al/files/userfiles/kurrikula/PROGRAMI__ARTI_PAMOR_SHKALLA_3.pdf)
  26. <http://www.abazajeti.com/index.php/kulture-muzikore.htm>
  27. [https://sq.wikipedia.org/wiki/Lidhja\\_e\\_Prizrenit](https://sq.wikipedia.org/wiki/Lidhja_e_Prizrenit)
  28. <http://www.luigiboccherini.org/figurativearts.html>
  29. <https://www.youtube.com/ëatch?v=Vd1IMQY9RVI>
  30. <https://www.youtube.com/ëatch?v=-a9A-qxCtYQ>
  31. [http://www.sa-kra.ch/bota\\_e\\_artit.htm](http://www.sa-kra.ch/bota_e_artit.htm)

32. <https://aldadodaj.ëordpress.com/2010/05/03/lidhja-e-muzikes-me-artin/>
33. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>
34. <http://mediaprint.al/uploads/books/muzika-KLASA-IV.pdf> Edukimi muzikor, klasa IV
35. <http://www.helendoron.al/lidhja-mes-gjuhes-dhe-muzikes/>
36. <https://aldadodaj.ëordpress.com/2010/05/03/lidhja-e-muzikes-me-artin/>
37. [https://www.google.com/search?q=abc+notes+song&bië=1242&bih=606&tbm=isch&imgil=30CioHmE957y-M%](https://www.google.com/search?q=abc+notes+song&bië=1242&bih=606&tbm=isch&imgil=30CioHmE957y-M%2F)
38. <http://www.kosovapress.com/sq/arkiva/lidhjet-e-muzikes-me-poezine-49567/?old=1>
39. <http://www.vasiltole.com/Albanian/MusicLiterature/MusicLit-AL.html>
40. <http://jacket2.org/article/poetry-music>
41. <http://ilirramadani.blogspot.al/2008/07/lidhjet-e-muziks-me-poezin.html>
42. <https://youtu.be/5Eaxcioiy2ëw>
43. [http://www.smithsonianeducation.org/publications/siycëinter\\_06.pdf](http://www.smithsonianeducation.org/publications/siycëinter_06.pdf)
44. [https://www.researchgate.net/profile/Qefsere\\_Doko\\_Gjonbalaj/publication/258848188\\_Si\\_të\\_rrisim\\_interesin\\_dhe\\_suksesin\\_e\\_studenteve\\_ne\\_lendet\\_matematike/links/00b7d5293d86dae3ba000000/si-te-rrisim-interesin-dhe-suksesin-e-studenteve-ne-lendetmatematike.pdf](https://www.researchgate.net/profile/Qefsere_Doko_Gjonbalaj/publication/258848188_Si_të_rrisim_interesin_dhe_suksesin_e_studenteve_ne_lendet_matematike/links/00b7d5293d86dae3ba000000/si-te-rrisim-interesin-dhe-suksesin-e-studenteve-ne-lendetmatematike.pdf)
45. <http://documents.tips/documents/lidhja-e-matematikes-me-lendet-e-tjera.html>
46. <http://illyriapress.com/lidhjet-e-muzikes-matematiken-dhe-fiziken/>

## SHTOJCA

### Pyetësi për mësuesit Të

nderuar mësues!

Ju faleminderit që jeni pjesë e këtij studimi. Përgjigjet tuaja janë tërësisht anonime dhe konfidenciale. Ju lutem, përgjigjuni duke shënuar një **X** në numrin përkatës për secilin pohim të mëposhtëm duke pasur parasysh shkallën e propozuar.

Gjinia:    **F**      **M**      Arsimimi:.....      Vjetërsia në punë.....

| Pohimet   | Gjithm | Shpe | Ndonjeh | Asnjeh |
|---|--------|------|---------|--------|
|   | onë    | sh   | erë     | rë     |
|   | 4      | 3    | 2       | 1      |
| 1- Lënda e edukatës muzikore krijon atmosferë të hareshme.      |        |      |         |        |
| 2- Lënda e edukatës muzikore nxit kureshtjen e nxënësve.        |        |      |         |        |
| 3- Lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më të shoqërueshëm. |        |      |         |        |
| 4- Lënda e edukatës muzikore zhvillon kreativitetin e nxënësve. |        |      |         |        |



|   |  |  |  |  |
|---|--|--|--|--|
| 5- Lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më socialë.   |  |  |  |  |
| 6- Lënda e edukatës muzikore i bën nxënësit më interaktivë.   |  |  |  |  |
| 7- A shfaqin interes nxënësit për lëndën e edukatës muzikore?   |  |  |  |  |
| 8- A vendosni në klasë, në sfond, muzikë për të krijuar atmosferë pozitive për nxënësit tuaj?   |  |  |  |  |
| 9- Nëse po, a keni konstatuar përmirësim të gjendjes shpirtërore të nxënësve?   |  |  |  |  |
| 10- Kurrikula e re parasheh që ndërlidhja e lëndëve të realizohet në orë të ndryshme mësimore. Sipas mendimit tuaj, a duhet të realizohet ndërlidhja mes lëndëve? |  |  |  |  |
| 11- A e realizoni integrimin ndërlëndor në klasën tuaj?   |  |  |  |  |
| 12- A mendoni se orët mësimore të lëndëve të ndryshme janë më efektive nëse bëhet ndërlidhja (integrimi) me edukatën muzikore?                                    |  |  |  |  |

|   |  |  |  |  |
|---|--|--|--|--|
| 13- A e keni realizuar integrimin ndërlëndor ndërmjet edukatës muzikore dhe lëndëve të tjera?   |  |  |  |  |
| 14- A mendoni se nxënësit janë më aktivë në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera?                          |  |  |  |  |
| 15- A mendoni se, në lëndë të ndryshme, nxënësit e përvetësojnë më mirë temën mësimore, kur për realizimin e kësaj temë ju fusni dhe elemente muzikore? |  |  |  |  |
| 16- A mendoni se te nxënësit nxitet fantazia dhe krijimtaria në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera?      |  |  |  |  |
| 17- A mendoni se nxënësit janë më socialë dhe interaktivë në orët mësimore ku realizohet integrimi ndërlëndor mes muzikës dhe lëndëve të tjera?         |  |  |  |  |
| 18- A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe gjuhës shqipe në orën e gjuhës shqipe?  |  |  |  |  |

|  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|
| 19- A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe leximit në orën e leximit?                             |  |  |  |  |
| 20- A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe matematikës në orën e matematikës?                     |  |  |  |  |
| 21- A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe historisë në orën e historisë?                         |  |  |  |  |
| 22- A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe pikturës në orën e edukatës figurative?                |  |  |  |  |
| 23- A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe lëvizjes në orën e edukatës fizike?                    |  |  |  |  |
| 24- A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe njohurive rreth shoqërisë në orën e edukatës qytetare? |  |  |  |  |
| 25- A e realizoni integrimin ndërlëndor mes muzikës dhe dukurive natyrore në orën “Njeriu dhe natyra”?         |  |  |  |  |

*Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në këtë studim.*

**Pyetësi për nxënësit Të**

dashur nxënës!

Ju faleminderit që jeni pjesë e këtij studimi. Përgjigjet tuaja janë tërësisht anonime dhe konfidenciale. Ju lutem, përgjigjuni duke shënuar një **X** në numrin përkatës për secilën pyetje të mëposhtme duke pasur parasysh shkallën e propozuar.

Gjinia:    **F**        **M**            Shkolla:.....

| Pohimet   | Gjithm | Shpe | Ndonjeh | Asnjeh |
|---|--------|------|---------|--------|
|   | onë    | sh   | erë     | rë     |
|   | 4      | 3    | 2       | 1      |
| 1. Të pëlqen muzika?  |        |      |         |        |
| 2. A ndjehesh mirë (gëzueshëm) në orën e edukatës muzikore?                                   |        |      |         |        |
| 3. Të pëlqen të këndosh me shokët / shoqet në orën e muzikës?                                 |        |      |         |        |
| 4. Kur bën detyrat ose studion, të pëlqen të dëgjosh edhe muzikë?                             |        |      |         |        |
| 5. A të ka ndihmuar dëgjimi i muzikës në kryerjen e ushtrimeve apo problemave të matematikës? |        |      |         |        |
| 6. Të pëlqen të dëgjosh muzikë kur krijon vjersha ose tregime?                                |        |      |         |        |

|   |  |  |  |  |
|---|--|--|--|--|
| 7. Të pëlqen të dëgjosh muzikë kur<br>pikturon? |  |  |  |  |
|---|--|--|--|--|

*Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në këtë studim.*